

Kolonel (rez) Dr. Çlirim TOCI

Arti i Diplomacisë Ushtarake dhe Mjedisi i ri i Sigurisë

Tiranë, Shqipëri

BOTIME



Titilli:

Arti i Diplomacisë Ushtarake dhe Mjedisi i ri i Sigurisë

Autor:

Kolonel (rez) Dr. Çlirim TOCI

Paraqitja grafike:

Elvis BEJTJA

Shtypi:

Shtypshkronja "PEGI"

© Autori

ISBN: 978-9928-233-13-4

*Për bashkëshorten Egla, vajzën Ajsela dhe
djalin Enes, burim frymëzimi dhe krijimtarie.*

PARATHËNIE

Zhvillimi dhe konsolidimi i diplomacisë ushtarake pas viteve 1990, **Z**u përqëndrua më shumë në parandalimin e konflikteve, rritjen e besimit dhe forcimin e bashkëpunimit midis vendeve dhe partnerëve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Shtetet e demokracive të lira shtuan përpjekjet në promovimin e vlerave demokratike dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Pas viteve 1990 pushoi së ekzistuari konflikti Lindje – Perendim dhe vendin e luftës së ftohtë filloi ta zinte mirëkuptimi dhe bashkëpunimi. Në këtë periudhë, vendet anëtare të NATO-s filluan të promovonin dhe angazhonin diplomacinë ushtarake në interes të reduktimit të rreziqeve dhe krijimit të urave të bashkëpunimit. Kjo filozofi krijoi dhe mundësoi përdorimin dhe zhvillimin e artit të diplomacisë ushtarake nga forcat e armatosura. Nëpërmjet kuptimit të rolit dhe artit të diplomacisë ushtarake pas luftës së ftohtë, ne do të kemi mundësi të njohemi me një numër shembujsh dhe aktivitetesh të zhvilluara në këtë kuadër.

Libri si fillim do të trajtoj dhe analizojë, objektin, qëllimin, problemet dhe metodologjinë e studimit të shoqëruar me shpjegimin e misionit të diplomacisë ushtarake dhe objektin konkret të saj. Lexuesi duke u njohur me problemet e mësipërme do të vazhdoj të informohet dhe njihet me zhvillimet e diplomacisë ushtarake, duke mos lënë pa komentuar fillesat dhe përkufizimin e diplomacisë si elementi bazë i krijimit dhe zhvillimit të diplomacisë ushtarake. Komentet rreth

lindjes dhe zhvillimit të diplomacisë ushtarake do të ndiqen me disa analiza rreth zhvillimeve të ndodhura pas viteve 1990 dhe rolin e saj në këtë periudhë.

Përdorimi i diplomacisë ushtarake si mjet në parandalimin e konflikteve, forcimin e bashkëpunimit, si në rastin NATO – Rusi apo SHBA – Kinë, do të prezantoi dhe analizoi rolin dhe rëndësinë e saj në forcimin e marrëdhënieve dhe rritjen e besimit midis ish kundërshtarëve. Diplomacia para 25-vitesh është përdorur si indikator në inkurajimin e aleatëve në luftë kundër armikut të përbashkët, mbrojtjen e integritetit territorial dhe sigurisë të vendeve anëtare. Ndryshimet e reja krijuan hapësira dhe mundësi në zhvillimin dhe përdorimin e diplomacisë ushtarake në forcimin e bashkëpunimit dhe krijimin e urave të miqësisë.

Në këtë këndvështrim, Forcat e Armatsora të Shqipërisë në dokumentin e Strategjisë së Sigurimit Kombëtarë, kanë përcaktuar zhvillimin dhe përdorimin e diplomacisë ushtarake në interes të forcimit të sigurisë dhe bashkëpunimit midis vendeve të rajonit të Ballkanit. Komentet dhe zhvillimet e mësipërme do të mundësojnë rekomandimin e formave dhe mënyrave në zhvillimin e diplomacisë ushtarake dhe nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare.

PËRMBAJTE

Parathënie	5
Hyrja	9
Misioni i Diplomacisë Ushtarake.....	13
Objekti i Diplomacisë Ushtarake.....	15
1 ZHVILLIMI I DIPLOMACISË USHTARAKE	18
1.1 Fillimet e diplomacisë ushtarake	18
1.2 Diplomacia ushtarake, pas viteve 1990.	27
1.3 Rëndësia dhe roli i diplomacisë ushtarake	34
1.3.1 Diplomacia parandaluese (Preventive Diplomacy)	37
1.3.2 Diplomacia shtrënguese (Coercive Diplomacy)	38
1.4 Përfudime	39
2. DIPLOMACIA USHTARAKE	41
2.1 Diplomacia Ushtarake si mjet në parandalimin e konflikteve	44
2.2 Bashkëpunimi ushtarak NATO – Rusi	52
2.3 Bashkëpunimi ushtarak SHBA – Kinë	61
2.4 Përfundime	69
3. DIPLOMACIA USHTARAKE NË FA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	72
3.1 Prioritetet strategjike të diplomacisë ushtarake	73
3.2 Diplomacia Ushtarake dhe Samitet e NATO-s	79

3.3	Objektivat dhe angazhimet e diplomacisë ushtarake	87
3.3.1	Objektivat	87
3.3.2	Angazhimet dhe arritjet kryesore Q.....	88
3.4	Institucioni i atasheut ushtarak	91
3.5	Bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh	94
3.6	Bashkëpunimi Rajonal	97
3.6.1	SEDM (Ministeriali i Mbrojtjes të Europës Jug-Lindore) ..	97
3.6.2	US – Adriatik Charter 3/5 (Karta e Adriatikut) ...	102
3.7	Edukimi dhe trajnimi jashtë vendit	103
3.8	Armë kontrolli, parandalimi i armëve të dëmtimit në masë, ndërtimi i mirëbesimit dhe sigurisë në rajon dhe më gjërë. ...	105
3.9	Partneriteti me NATO-n dhe kontributet e FA-ve.....	107
3.9.1	Partneriteti me NATO-n.....	108
3.9.2	Kontributi në Operacionet Paqeruajtëse (PSO)	109
3.10	Aktorët e Diplomacisë Ushtarake në procesin e Integritimit	111
3.11	Diplomacia ushtarake në kushtet e reja të sigurisë dhe mbrojtjes.....	113
3.12	Përfundime	117
	REKOMANDIME DHE PËRFUNDIME	118
	Rekomandime	119
	Përfundime	125
	LITERATURA	132
	SHPJEGIMI I SHKURTIMEVE	140
	LISTA E FIGURAVE	143
	LISTA E TABELAVE	144
	SHTOJCAT	145

HYRJA

Ndryshimet në fushën e sigurisë, politikës dhe ekonomisë janë promotore të zhvillimeve në vendet e demokracive të konsoliduara dhe demokracive në zhvillim. Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Europës Juglindore po i kushtojnë rëndësi dhe vëmendje bashkëpunimit, rritjes së besimit dhe sigurisë. Aktorët civilë dhe ushtarak po bëhen çdo ditë e më të përgjegjshëm për rolin dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës, promovimin e vlerave demokratike dhe respektimin e lirisë të njeriut. Respektimi dhe zbatimi i këtyre elementeve përfshin të gjithë aktorët të cilët merren me problemet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Ndryshimet e pas viteve 1990 mundësuan dhe krijuan një mjedis të ri bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Këto ndryshime hodhën hapat dhe bazën e lindjes së diplomacisë së re ushtarake. Nën frymën dhe filozofinë e diplomacisë ushtarake janë zhvilluar një numër programesh bashkëpunimi me qëllim forcimin e dialogut në fushën e mbrojtjes, rritjen e besimit dhe reduktimin e rreziqeve. Zhvillimet rajonale në fushën e sigurisë, kanë si qëllim reduktimin e veprimeve individuale të vendeve, në kundërshtim me interesat e grupit.

Diplomacia ushtarake është pjesë integrale e diplomacisë kombëtare të një vendi. Dokumenti i strategjisë të sigurimit kombëtar të Republikës së Shqipërisë thekson se: diplomacia ushtarake është instrument i rëndësishëm në krijimin e një mjedisi ndërkombëtarë të përshtatshëm në parandalimin e krizave dhe konflikteve, zgjidhjen e tyre me mjete paqësore dhe mundësimin e bashkëpunimit me fqinjët, partnerët

dhe institucionet ndërkombëtare.¹ Një tjetër përkufizim hasim në dokumentin e strategjisë kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar, në të cilën theksohet se misioni i “ri” (*diplomacia ushtarake*)² i mbrojtjes po ndikon në forcat e armatosura që të bëhet një ‘shërbim/biznes’ i nevojshëm.”³ Komentet dhe analizat e mësipërme shërbejnë si bazë në përcaktimin dhe prezantimin e qëllimit dhe objektit të librit, në prezantimin e rolit dhe ndikimit të diplomacisë ushtarake në mjedisin e ri të sigurisë në shekullin e 21-të. Kjo është mënyra më e mirë për të kuptuar hapat në të cilat kanë kaluar zhvillimet në diplomacinë ushtarake dhe mjedisin aktual të sigurisë. Gjatë trajtimit të këtij subjekti do të prezantohen dhe analizohen fakte konkrete, sillen argumenta dhe bëhen analiza të ndryshme me qëllim mbajtjen hapur të debatit dhe diskutimit rreth rolit dhe artit të diplomacisë ushtarake. Diplomacia ushtarake ka si qëllim/objekt, kulturën e mos-ballafaqimit (*culture of non-confrontation*), e cila përbëhet nga: (1) diplomacia ushtarake dhe (2) bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes.

Në kontekstin e diplomacisë ushtarake, eksperiencia Britanike paraqet një tablo më të qartë rreth qëllimit dhe rolit të saj:

*“Qëllimi i të gjitha aktiviteteve të Forcave të Armatosura, të cilat njihen në mënyrë kolektive si ‘diplomacia ushtarake’, ka për mision mësimin/ tregimin e Forcave të Armatosura, se si mund të veprojnë në mbështetje të proceseve të zhvillimit dhe të jenë të domosdoshme për qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike. Në këtë mënyrë, ne (Forcat e Armatosura) arrijmë qëllimin e dëshiruar në uljen e tensioneve dhe reduktimin e konflikteve”.*⁴

Me këtë rast, më poshtë lexuesi do të njihet me disa përshkrime në lidhje me termat diplomaci dhe diplomat. Ky hap do të bëjë të

1 Strategjia e Sigurimit dhe Politikës së Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, 2000. fp.21.

2 Shënim/sqarim i autorit

3 Strategjia e Sigurimit Kombëtare të UK, fp. 18

4 Ministry of Defense, United Kingdom “*Defence Diplomacy*”, 1999, London, UK.

munduar dhe do të prezantojë një ide se çfarë kuptojmë me termat diplomaci dhe diplomat në nivelin kombëtar.

Në shkrimet dhe komentet e ndryshme, diplomacia është përcaktuar, p.sh. sipas Reed J. Fendrick⁵ “*Instrument i Fuqisë Kombëtare*” ndërsa diplomati është përkufizuar si “*njeri i nderuar, dërguar jashtë vendit për të gënjyer për vendin e tij*”⁶. Ndërsa një tjetër autor, Bierce⁷ e përkufizon rolin e diplomacisë dhe diplomatit si “*Arti i të gënjyerit për një vend, të cilin ai përfaqëson*”.

Në kundërshtim me ta Gingrich⁸ e përkufizon rolin e diplomacisë dhe të diplomatit, *si element përbërës të Mediave dhe elitave intelektuale, Departamentit të Shtetit (si instrument), si dhe Shërbimeve të Jashtme (si element kulturor) të cilat në këtë rast qartazi favorizojnë procesin, edukatën/ mirësjelljen dhe pozicionimin e rolit të diplomatit dhe diplomacisë të një vendi*. Përkufizimet e mësipërme ngren paralelet e nevojshme dhe pikat e kontaktit midis filozofisë të diplomatit dhe diplomacisë në njërin anë dhe diplomacisë ushtarake, si filozofi e mirëkuptimit dhe zhvillimit të artit të bashkëpunimit dhe bashkëjetesës.

Diplomacia ushtarake dhe filozofia e saj e veprimit i ka rrënjët në diplomacin kombëtare. Roli dhe ndikimi i diplomacisë kombëtare është baza e suksesit dhe konsolidimit të diplomacisë ushtarake. Por si lindi nevoja e diplomacisë në jetën dhe zhvillimin e shtetit? Diplomacia lindi si domosdoshmëri në forcimin e marrëdhënieve midis qytet-shteteve në Greqinë e Lashtë. Më pas u shfaq si nevojë imediate në periudhën e Rilindjes Europiane dhe fitoi rëndësi në forcimin e marrëdhënieve midis qytet-shteteve të Italisë, së periudhës së Rilindjes dhe shteteve të

5 Reed J. Fendrick ‘Diplomacy as an Instrument of National Power’

6 Aprocryphal

7 Ambrose Bierce, The Devil’s Dictionary, available at www.alcyone.com/max/lit/devils/d.html, gjetur më 13 qershor 2007.

8 Newt Gingrich, “Rogue State Department,” Foreign Policy (July-August 2003) available at www.foreignpolicy.com/story/story.php?storyID=13742&PHPSESSID, gjetur më 13 qershor 2007.

krijuara pas periudhës së Reformimit të Evropës.⁹

Diplomacia është një formë drejtimi dhe bashkëpunimi e cila ka një histori të gjatë dhe daton nga koha e krijimit të shteteve politike (*traktati i Wastphalis 1648*). Me krijimin e këtyre shteteve, diplomacia është përdorur si mjet në forcimin dhe krijimin e marrëdhënieve midis vendeve. Në fillimet e saj diplomacia u përdor si element i shteteve ose individëve të veçantë, por me kalimin e viteve ajo u bë më komplekse, pasi identiteti politik u bë më i organizuar dhe më i kontrolluar.¹⁰

Krijimi dhe konsolidimi i shteteve si njësi politike dhe administrative krijoi mundësi dhe hapi rrugën në forcimin dhe konsolidimin e termit diplomaci. Në këtë këndvështrim, literatura perendimore dhe konkretisht, fjalori enciklopedik ‘Advanced Dictionary’ botim i vitit 1987, termin “*diplomacy*” e konsideron si element të domosdoshëm në menaxhimin e marrëdhënieve ndërmjet kombeve, negocimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe.¹¹ Ndërsa enciklopedia britanika e ka konsideruar diplomacinë si art në krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve pa krijuar konflikte.¹² Në këtë kontekst, objekti i diplomacisë është të çoj dhe zhvilloi më tej interesat e shtetit të diktuar nga pozicioni gjeografik, historik dhe ekonomik. Ndërsa në anën tjetër diplomacia ushtarake si pjesë përbërëse e diplomacisë kombëtare, përpiqet të siguroi integritetin teritoria dhe sigurinë e vendit si probleme parësore; dhe krijimin dhe mundësimin e një hapësire dhe zone veprimi të lirë për shtetin si domosdoshmëri jetike.¹³ Në lidhje me qëllimin dhe objektivat e përmendura më lart, diplomacia ushtarake kërkon të arrijë maksimumin e avantazheve për vendin pa përdorimin e forcës dhe mundësisht pa krijuar pakënaqësi. Këto pika zbërthehen

9 Po Aty

10 Po Aty

11 E.L. Thorndike dhe Clarence L. Barnhart ‘Scott, Foresman Advanced Dictionary’ Illinois, USA, fp.286.

12 <http://www.answers.com/topic/diplomacy>

13 Newt Gingrich, “Rogue State Department,” Foreign Policy

si objektiva themelorë në verpimtarinë dhe zhvillimin e diplomacisë ushtarake me qëllim parandalimin e konflikteve, forcimin e besimit, rritjen e sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Pë shembul, SHBA-ja dhe Britania e Madhe ishin vendet e parë të cilat miratuan dhe vendosën përdorimin e termit diplomaci ushtarake, pas rënies së murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Kjo filozofi shumë shpejt u mishërua dhe u bë pjesë e dokumentave të strategjisë të sigurimit të vendeve anëtare të NATO-s. Filozofia e bashkëpunimit dhe reduktimit të konflikteve nuk la pa përfshirë dhe Shqipërinë e pas-viteve 1990. Këto ndryshime përfshin formën dhe përmbajtjen e Forcave të Armatosura dhe konceptin e dokumentave kryesore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Misioni i Diplomacisë Ushtarake

Zhvillimet e pas viteve 1990 ndikuan në ndryshimin dhe përmbajtjen e veprimtarive dhe misionit të forcave të armatosura të vendeve perendimore dhe vendeve ish-komuniste. Në këtë këndvështrim eksperiencia Britanike e përkufizon misionin e diplomacisë ushtarake si më poshtë:

“Diplomacia ushtarake i ndihmon forcat e armatosura dhe institucionet e mbrojtjes, të jenë në gjendje të organizojnë një numër aktivitete, me qëllim largimin e frikës, ndërtimin dhe forcimin e besimit, si dhe asistimin në zhvillimet demokratike të Forcave të Armatosura. Këto forma veprimtarie, mundësojnë në përfitimin dhe afrimin e kontributeve tepër të rëndësishme të Forcave të Armatosura në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve”.¹⁴

Në anën tjetër, studiuesi Bullgar Valeri Rachev në fillim të viteve 2000, në shkrimin e tij ‘Diplomacia Ushtarake: Përvoja Bullgare’ do ta përkufizonte kuadrin e veprimtarisë të diplomacisë ushtarake: “si

14 Defence Diplomacy, MoD UK

*proces në krijimin e një vizioni sistematik në praktikimin e aktiviteteve të ndryshme në dekadën e fundit në dy drejtime: në parandalimin e krizave në Ballkan dhe përgatitjen e Bullgarisë për anëtarësim në NATO.*¹⁵

Përcaktimi i përvojës Britanike dhe përvoja e zotit Rachev, nuk do të ishte e plotë, nëse nuk do të përmendnim, përfundimet e arritura nga qendra e Studimeve Strategjike (CSS) në Zelandën e Re. Kjo qendër thekson se shkak, për të kuptuar më qartë diplomacinë ushtarake përfshin element si *'largimin e frikës, ndërtimin e besimit, ndihma në ndërtimin dhe zhvillimin demokratik të Forcave të Armatosura'*.¹⁶

Analizat dhe komentet rreth diplomacisë ushtarake të zhvilluar nga institucione dhe individë të ndryshëm, kanë hedhur bazat e ndërtimit të një kulture krejt ndryshe, të civilëve dhe individëve në uniformë, me qëllim largimin dhe shmangien e frikës së akumuluar në rajon, rritjen e besimit dhe forcimin e bashkëpunimit. Në këtë frymë, dokumenti i ri i strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë, ka theksuar se: *"zhvillimet botërore dhe rajonale në fillimet e mijëvjeçarit të ri kanë sjellë ndryshime të thella të mjedisit gjeostrategjik, duke përmirësuar ndjeshëm klimën e përgjithshme të marrëdhënieve ndërshtetërore, por në të njëjtën kohë, duke nxjerrë në pah sfidat e reja.*"¹⁷

Shqipëria është pjesë integrale e kontinentit European dhe rajonit të Ballkanit ose siç njihet në histori, Gadishulli Ilirik. Në këtë kontekst, Shqipëria ka prezantuar dhe reflektuar në dokumentin e strategjisë ushtarake se: *"diplomacia ushtarake do të bazohet dhe përqëndojë aktivitetin e saj në rritjen e bashkëpunimit rajonal, pjesëmarrjen aktive në organizatat si OKB-ja, NATO, BE dhe OSBE, stërvitjet e përbashkëta, konferencat dhe seminarët e ndryshme të cilat kanë si qëllim reduktimin e rreziqeve dhe rritjen e besimit.*"¹⁸

15 V. Rachev, fq. 57

16 J. Rolfe, fq. 1

17 Gazeta Ushtria, fq. 6

18 Gazeta ushtria, fq. 14

Përkufizimet dhe elementët e mësipërm reflektojnë rëndësinë dhe rolin e diplomacisë ushtarake, si element i rëndësishëm i kohës së paqes në reduktimin e rreziqeve, rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e besimit. Diplomacia ushtarake ka dhënë rezultate në një numër krizash dhe konfliktesh të armatosura. Rasti konkret është nënshkrimi i marrëveshjes (2008) midis Kolumbisë, Ekuadorit dhe Venezuelës, me qëllim parandalimin e konfliktit të armatosura dhe forcimin e besimit dhe rrespektimit të integritetit teritorial. Shembull tjetër në këtë fushë, është përdorimi dhe ndikimi i diplomacisë ushtarake (2009) në zhgjidhjen e krizës të shkaktuar në Çad, midis forcave qeveritare të presidentit Idriz Debi dhe forcave rebele të udhëhequra nga ish-ministri i mbrojtjes, me ndërmjetësimin e forcave Franceze të dislokuara në këtë vend. Moment tjetër për t'u theksuar është roli i Francës (2014) dhe konkretisht Forcave të Armatosura në vendosjen e paqes në Republikën e Afrikës Qëndrore, midis komuniteteve myslimane dhe krishtere.

Objekti i Diplomacisë Ushtarake

Diplomacia ushtarake ka marrë dhe po merr çdo ditë rëndësi të veçantë në proceset vendimarrëse dhe integruese të qeverive të vendeve aspirante në strukturat Euro-Atlantike. Në kontekstin e eksperiencave të vendeve anëtare të NATO-s “diplomacia ushtarake” është një nga tetë misionet ushtarake/mbrojtëse, ku ajo ka statusin dhe prioritetin e duhur.

Sipas revistës “*Defence Diplomacy*”¹⁹ botim i vitit 1999, misioni i diplomacisë ushtarake ka për objekt tre detyra specifike:

1. Armëkontrolli, përhapja e armëve të dëmtimit në masë, rritja e besimit dhe masave të sigurisë.

19 Defence Diplomacy, Ministry of Defence, United Kingdom, London, 1999.

2. Promovimi i paqes dhe stabilitetit në Europën Jug-Lindore, nëpërmjet aktiviteteve dypalëshe me vendet e rajonit dhe veçanërisht Rusinë.
3. Asistencë ushtarake dhe bashkëpunim me vendet të cilat përpiqen në forcimin e stabilitetit dhe sigurisë.

Ndërsa, dokumenti i Strategjisë Ushtarake (2007) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ka përcaktuar këto detyra në kohë paqe, në interes të zhvillimit dhe konsolidimit të elementëve të diplomacisë ushtarake:²⁰

1. Të monitoroj dhe vëzhgojë, me kapacitetet e veta dhe në bashkëpunim me NATO-n e partnerët, hapësirën tokësore, ajrore dhe detare, për paralajmërimin në kohë të kërcënimeve e rreziqeve dhe marrjen e masave për përballimin e tyre.
2. Të përgatitet dhe sigurojë mbështetjen e nevojshme të autoriteteve vendore dhe të popullsisë për përballimin e emergjencave civile të shkaktuara nga katastrofat natyrore ose nga dora e njeriut siç përcaktohet me ligj.
3. Të përgatitet dhe kontribuojë në operacionet e mbështetjes së paqes të drejtuara nga NATO, BE, OKB ose si pjesë e kualicioneve të ndryshme.
4. Të arrijë ndërveprueshmërinë dhe kapacitetet e nevojshme për t'u bërë pjesë e strukturave kolektive të sigurisë euro-atlantike.
5. Të përgatiten dhe sigurojnë mbështetjen e nevojshme të strukturave të tjera në luftën kundër terrorizmit.
6. Të planifikojnë masa në parandalimin e dëmtimit të mjedisit.

Objektivat e diplomacisë ushtarake të përcaktuara nga revista “Defence Diplomacy” dhe dokumenti i Strategjisë Ushtarake (2007) të Republikës së Shqipërisë, janë bërë sot kriteret themelore për ushtritë e vendeve anëtare të NATO-s dhe vendet partnere. Për shembull,

20 Gazeta Ushtria, fq. 11

vendet si Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, SHBA-ja, Turqia, Greqia, Italia etj, aplikojnë dhe zbatojnë objektivat e mësipërme, nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve, seminareve, konferencave, stërvitjeve të përbashkëta, vizitave etj.

Në këtë kuader, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë përfituar mundësi të shumta në trainimin e personelit ushtarak dhe civil nëpërmjet aplikimit dhe zbatimit të diplomacisë ushtarake nga vendet anëtare të NATO-s.

1 ZHVILLIMI I DIPLOMACISË USHTARAKE

1.1 Fillimet e diplomacisë ushtarake

Termi diplomaci ka lindur që në kohët e hershme ose e thënë ndryshe që nga koha e krijimit të qytetërimeve moderne dhe konkretisht tek Egjiptianët e Vjetër, Grekërit dhe Maqedonasit e Lashtë, Ilirët, Romakët, Perandoria Kineze etj. Diplomacia është zhvilluar dhe konsoliduar nga njëra periudhë në tjetrën, si instrument kryesor identifikues dhe koordinues midis individëve dhe shteteve, në planin ekonomik, politik dhe ushtarak.

Institucioni i diplomacisë sipas Mosley dhe Adcock “ bazohet plotësisht mbi shkëmbimet gojore dhe kontakteve midis individëve dhe organeve qeverisëse të çdo vendi.²¹ Për shembull, në Greqinë e lashtë individët dërgoheshin në të gjithë Greqinë për të mbështetur procesin e komunikimit. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar dy forma/ modele të diplomacisë të zhvilluara nga Athinasit: kerykes (lajmëtari) dhe presbeis (negociatori).²² Për shembull, Athinotët dhe Spartanët deklaruan luftë njëri tjetrit në Shekullin e 431 p.e.r., Thucidide në këtë kohë deklaronte se, nga ky moment i vetmi komunikim midis

21 F. Adcock dhe D. Mosley, fq. 152

22 Po Aty

dy shteteve, zhvillohej nëpërmjet lajmëtarëve (*kerykes*).²³ Kjo tregonte rëndësinë e lajmëtarëve në periudha të tilla konfliktesh midis dy vendeve. Në situata të tilla lajmëtarët (*kerykes*) kishin rol të rëndësishëm në përcaktimin e paramentrave të konflikteve dhe krijimin e mundësive për dialog dhe vendosjen e paqes. Në të shumtën e rasteve lajmëtarët përbëheshin nga ushtarakë të gradave dhe hierarkive të ndryshme, ku me vullnetin ose jo të shtetit që përfaqësonin, zhvillonin pa e ditur elementët e sotëm të diplomacisë ushtarake, e cila në atë kohë zhvillohej nëpërmjet diplomacisë kombëtare.

Ky term sa i lashtë dhe i vjetër ka ndihmuar në zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet grupimeve, perandorive, mbretërive dhe shteteve moderne nga lashtësia deri në ditët tona. Në këtë kontekst shtetet ose principatat e hershme, kishin ndërtuar dhe formuluar elementët e diplomacisë, si bazë për negocimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe problemeve midis tyre.

Lajmëtarët (*kerykes*), negociatorët (*presbeis*) dhe misionarët, ishin në përiudhën e perandorisë Romake dhe Bizantine, elementët kryesorë të diplomacisë. Për shembull negociatorët (*presbeis*) ishin pjesë e rëndësishme e makinës diplomatike të Athinës, në të shumtën e rasteve negociatat me fuqitë e huaja u ndërmorrën nga gjeneralët Athinotë. Gjeneralët në Greqinë e lashtë ishin të ngarkuar të merreshin me problemet politike dhe diplomatike të cilat lidheshin me “zhvillimin e negociatave dhe vendqëndrimet e forcave armike, shpërndarjen e plaçkës së luftës, robërit e luftës dhe popullsinë e qyteteve të pushtuara.”²⁴

Zhvillimet e elementëve të diplomacisë në periudhën e Greqisë së lashtë dhe Perandorinë Romake, patën ndikimin e tyre në krijimin e elementëve të diplomacisë kombëtare dhe ushtarake në rajonin e Ballkanit. Elementët dhe ndikimi i diplomacisë ushtarake nuk la

23 D. Hamel, fq. 40

24 F. Adcock dhe D. Mosley, fq. 153

jashtë ndikimit të saj dhe hapësirat mbarë shqiptare, ku studiuesit, kronikanët dhe udhëtarët e shumtë, konstatuan krijimin dhe zhvillimin e elementëve të diplomacisë kombëtare dhe ushtarake. Studiuesi dhe teologu i njohur Frances Faveyrial në veprën e tij *Histori e Shqipërisë* do ta konstatonte këtë që në shekullin e 12-t. "Piri Pasha me origjinë shqiptare, në vitin 1536 arriti të krijonte një *traktat tregëtie* midis Frances dhe Turqisë".²⁵ Ndërsa shkrimtari shqiptar Sabri Godo, në librin e tij *'Ali Pash Tepelena'*, do të arrinte në konkluzionin se Franca kishte hapur konsullata në Janina, Artë dhe Sajadhë, për të hyrë në kontakte me tregtinë e Ballkanit.²⁶ Periudha e sundimit të Ali Pashë Tepelenës ka hedhur dhe konsoliduar elementët e parë të diplomacisë ushtarake. Në këtë periudhë, Ali Pasha për të forcuar lidhjet dhe kontaktet me Gjeneralin Francez Xhentile në ishujt Jonian, i dhuroj këtij të fundit një çift kuajsh që nuk i gjendej shoqi dhe gjenerali i kishte dërguar dy nënoficerë të artilerisë, për shkollën e instruktorëve në Bonilë.²⁷

Në të njëjtën periudhë të zhvillimeve historike, në pjesën veriore të Shqipërisë, shtrihej vilajeti i Shkodrës. Në këtë vilajet, sundonte dinastia e Bushatllinjve, e cila zgjati rreth 100-vjet, deri me kapitullimin e Mastafa Pashës, vezirit të fundit.²⁸ 'Pashalleku i Shkodrës u bë bërthama e shtetit të ardhshëm shqiptar. Sundimi i Bushatllinjve ka një rëndësi të veçantë historike jo vetëm në kuadrin lokal, por dhe në atë kombëtar.²⁹

Studimet, komentet dhe analizat e studjuesit Faveyrial, zonjës Dushi dhe shkrimtarit Godo nuk ishin të vetmet studime, që fisnin mbi zhvillimin dhe konsolidimin e elementëve shtetformues dhe

25 Jean Claud Faveyrial, fq.314

26 Sabri Godo, fq. 85

27 Po Aty

28 Anila Dushi, www.orientalizmi.wordpress.com

29 Stavri Naçi, 1964

diplomacisë kombëtare dhe ushtarakë në veçanti, në trevat shqiptare nën perandorin Osmane. ”Marredheniet tregtare ndermjet shqiperise (*ose trojeve shqiptare*)³⁰ me Luigjin e XIII mbret i Francës datojnë që nga shekulli i XII. Ne kishim në atë kohë – thote një tjetër studiues francez Lavale – nënkonsuj në tetë qytete të Epirit dhe të ishujve Jonian, konsuj në Durrës dhe Artë, dhe më së fundmi, një konsull të përgjithshëm në Janinë (*Historia e Perandorisë Otomane, fq. 327*)³¹. Ndërsa studiuesi Bernard Lewis, në librin e tij *‘lindja e Turqisë moderne*, thekson se Britania e Madhe në periudhën e Perandorisë Osmane, kishte ngritur konsullatën e saj në Manastir.³²

Elementët e diplomacisë kombëtare dhe ushtarake të konstatuara nga kronikanët dhe udhëtarët në periudhën e mesjetës, ishin zhvilluar dhe konsoliduar në bazë të zhvillimeve të ndodhura gjatë periudhës së sundimit të Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), nga viti 1440 deri në vitin 1464. Skënderbeu gjatë sundimit të tij 25-vjeçar, hodhi bazat dhe krijoi elementët fillestarë të diplomacisë kombëtare dhe ushtarake. Për shembull, krijimi dhe shtimi i kontakteve me Vendikun, Vatikanin, Mbretërinë e Malit të Zi dhe Serbinë, vërtetojnë zhvillimin dhe konsolidimin e diplomacisë Shqiptare në periudhën e mesjetës.

Gjatë sundimit të Skënderbeut bien në sy dy momente të rëndësishme të cilat ndihmuan në formimin dhe konsolidimin e diplomacisë të shtetit të Arbërit. Momenti i parë është krijimi i marrëdhënieve me mbretin e Napolit në luftrat kundër principatave dhe shteteve të tjera të gadishullit Apenin. Ndërsa momenti i dytë është martesë e motrës së Skënderbeut, Mamicës me një nga princat e Mbretërisë së Malit të Zi.

Diplomacia e Skënderbeut dhe elementët e mëvonshëm të saj kanë ndihmuar në krijimin e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet kombeve, fqinjëve dhe fuqive të ndryshme. Roli dhe rëndësia

30 Sqarim i autorit

31 Jean Claud Faveyrial, fq.316

32 B. Lewis, fq. 250.

e bashkëpunimit ushtarak p.sh e Skënderbeut me Mbretërinë e Napolit, lidhjet miqësore me mbretërinë e Malit të Zi dhe përdorimi i ndërmjetësuesve në rastet e zhvillimit të konflikteve, ishin elementët më dallues të kohës, të cilat merreshin me reduktimin e mosmarrëveshjeve, krijimin e dialogut dhe forcimin e bashkëpunimit.

Elementët e diplomacisë kombëtare dhe diplomacisë ushtarake me kalimin e viteve dhe konsolidimin e shtetit si element themelor, fituan qytetarinë dhe rritën ndikimin e tyre në fushën e bashkëpunimit ekonomik, politik dhe ushtarak, në vendet e zhvilluara të kohës si, Vatikani, Venediku, Ragusa, Franca, Anglia etj. Gjatë kësaj periudhe vlen të përmendet roli ndërmjetësues i Francës në konfliktin e lindur midis Pashait të Egjiptit, shqiptarit Muhamed Ali dhe Portës së lartë. Emisarët e dërguar nga Napolon Bonaparti, zgjidhën konfliktin disa vjeçar ndërmjet Pashallëkut të Egjiptit dhe Portës së Lartë.³³ Në këto raste, roli i ndërmjetësuesve dhe lajmëtarëve, mundësoi forcimin dhe konsolidimin e elementëve të diplomacisë ushtarake në shekullin e 18-të, të inicuar nga Napoloni, perandor i Francës.

Shekulli i 18 identifikoi dhe vërtetoi kalimin nga emisarët, si element i diplomacisë së "*lëvizshme*", me përfaqësues në tërren. Kontaktet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomatike midis shteteve filluan të konkretizoheshin nëpërmjet insitucionit të ambasadorit (*proxineas*).³⁴ Kimon një politikan i njohur Athinot në gjysmën e parë të shekullit të 5-të p.e.r., ishte ambasadori (*proxineas*) i Spartës.³⁵ Ky element u përdor për të zgjidhur mosmarrëveshjet në fushën ushtarake dhe atë politike. Përdorimi i formave si '*direct oral exchange*'³⁶ (*shkëmbime direkte me gojë*) ndihmuan në zgjidhjen e shumë mosmarrëveshjeve. Për shembull, rasti i Pukëvilin në Janinë, Konsullatës Austro-Hungareze në Shkodër dhe

33 M. Sabry, fq. 121

34 Plutarch, fq. 13

35 Po Aty, fq. 14

36 Po Aty, fq. 18

konsullatës Angleze në Manastir, tregojnë formimin dhe konsolidimin e përfaqësuesve dhe përfaqësive në terren, por në anën tjetër hodhën bazat e kontakteve midis elementeve dhe aktorëve të shtetit në fushën e diplomacisë kombëtare dhe ushtarake.

Përfaqësitë diplomatike filluan të shfaqeshin, si element përfaqësues, në fundin e shekullit të 18 dhe fillimin e shekullit të 19. Hapja dhe krijimi i përfaqësive diplomatike rriti dhe konsolidoi rolin e diplomacisë në terren. Ky rol filloi të bëhej gjithnjë e më i rëndësishëm me fillimin e shekullit të 20. Vende të ndryshme si Anglia, Franca, Italia, Rusia, SHBA-ja, Turqia etj, kaluan nga përdorimi i ndërlidhësve dhe emisarëve, në një stad tjetër zhvillimi në fushën dhe sferën e diplomacisë, përfaqësimin me individë dhe institucione në terren. Shteti filloi të zhvillonte dhe konsolidonte elementin e diplomacisë kombëtare dhe ushtarake, në krijimin dhe zhvillimin e urave të bashkëpunimit. Elementët e diplomacisë të zhvilluara në këtë kohë u emërtuan konsuj ose Ministër Shteti.

Konsujt dhe ministrat e shtetit u përdorën në krijimin e pikave të kontaktit dhe forcimin e bashkëpunimit midis shteteve. Në shumë raste këta elementë zgjidhën dhe reduktuan në maksimum efektet e konflikteve dhe hodhën bazat e besimit midis palëve të përfshira në mosmarrëveshje ose konflikte.

Zhvillimet e ndodhura në fundin e shekullit të 19 dhe fillimet e shekullit të 20, krijuan hapësira dhe mundësi rilindasve shqiptar të shpallin pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Krijimi i Shqipërisë shtet i pavarur, hodhi hapat e para të formimit dhe konsolidimit të diplomacisë kombëtare. Përfaqësuesit e rilindjes shqiptare zhvilluan dhe ndërmorrën një numër aktivitete në njohjen dhe ndërgjegjësimin e opinionit botëror në lidhje me çështjen Shqiptare. Vizita e Isa Boletinit dhe Ismail Qemalit në Konferencën e Londrës³⁷ dhe vizita të tjera në vendet dhe fuqitë e asaj kohe, hodhën hapat dhe krijuan elementët

37 Historia e Shqipërisë, fq. 97

fillestar të diplomacisë ushtarake në Shqipërinë e pas periudhës së Perandorisë Osmane.

Elementët fillestarë të qeverisë së Ismail Qemalit do të hidhnin më vonë bazat dhe themelet e diplomacisë së vërtetë kombëtare dhe asaj ushtarake. Lëvizjet e rilindasve në Rumani, Turqi dhe SHBA ndërgjegjësuat opinionin botëror dhe shqiptar mbi të drejtën shekullore dhe legjitime të shtet formimit nga Shqiptarët. Në këto fushata, u përfshinë rilindasit më të shquar të kësaj periudhe si, Ismail Qemali, Abdyl Frashëri, Isa Boletini, Asim Vokshi, Faik Konica, Fan Noli, Hasan Tahsini, Hasan Prishtina, Pashko Vasa e shumë e shumë të tjerë, të cilët përfaqësonin në vetvete elementët më të spikatur të kombit Shqiptar në fushën e shkencës, politikës, ushtrisë, ekonomisë etj. Këto elementë janë bazat e para të krijimit dhe konsolidimit të elementëve dhe aktorëve të diplomacisë kombëtare dhe asaj ushtarake, në forcimin e elementëve shtet-formues dhe zhvillimin e marrëdhënieve me vendet e tjera.

Bazat e diplomacisë kombëtare dhe ushtarake të krijuara nga qeveria e Ismail Qemalit u konsoliduan më tej me krijimin e qeverisë së Zogut në vitin 1922. Qeveria e Mbretit Zog hodhi bazat e diplomacisë moderne. Në këtë periudhë, u krijua për herë të parë Ministria e Puneve të Jashtme dhe u hapën një numër ambasadash, në Itali, Greqi, Bullgari, Turqi, SHBA, France etj. Nga viti 1924 deri më 09 Prill 1939, Shqipëria zhvilloi dhe prezantoi përpara partnerëve një diplomaci moderne dhe profesioniste.

Në periudhën 1939-44, Shqipëria u gjënd nën pushtimin e fashistëve Italian dhe Nazistëve Gjerman, si rezultat elementët e diplomacisë shqiptare pushuan së funksionuari. Me mbarimin e luftës dhe çlirimin e Shqipërisë, filloj një erë e re, era e Shqipërisë Komuniste. Shqipëria nën drejtimin e komunistëve arriti të krijonte dhe konsolidonte më tej elementët e diplomacisë nëpërmjet rikrijimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, hapjen e ambasadave dhe konsullatave. Gjatë kësaj periudhe,

diplomacia shqiptare u influencua nga filozofia komuniste marksiste-leniniste në zhvillimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve me shtetet e boshtit revolucionar; në fushat politike, ekonomike, kulturore dhe ushtarake.

Shqipëria nga viti 1946 deri në vitin 1990 kishte marrëdhënie dhe shkëmbime kulturore me të gjitha vendet e ish-blokut komunist. Vendi ynë ishte anëtar i organizatave ekonomike (*KNER – Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke*), ushtarake (*Traktati i Varshavës*), politike (*Anëtare e Internatcionales Komuniste*) dhe organizatave kulturore.

Në periudhën 1945-1990, u zhvilluan një numër elementësh të diplomacisë kombëtare, përfshirë edhe diplomacinë ushtarake në veçanti. Shqipëria si pjesëtare e Traktatit të Varshavës, kishte shkëmbime të rregullta në fushën ushtarake me të gjitha vendet e traktatit. Shqipëria, për arsye të mosmarrëveshjeve politike u largua ushtarakisht nga traktati i Varshavës në vitin 1960 dhe politikisht në vitin 1968. Gjatë kësaj periudhe, vlen të përmenden marrëdhëniet ushtarake me Republikën Popullore të Kinës dhe Vietnamit.

Marrëdhëniet në fushën ushtarake dhe sigurisë, gjatë viteve 1945-1990, bazoheshin në:

1. Vizita të ndërsjellta
2. Dërgime studentësh dhe trajnime
3. Blerje të teknologjisë ushtarake
4. Vizita familjarizuese
5. Asistencë teknike, ndihma materiale, këshilltare etj

Në këtë periudhë, marrëdhëniet kishin si qëllim forcimin e mbrojtjes së vendit, modernizimin e ushtrisë, edukimin e ushtarakëve dhe shkëmbimin e përvojës me vendet e tjera ish-komuniste. Termi diplomaci ushtarake nuk njihet në këtë kohë, megjithëse ajo zhvillohej nëpërmjet formave të tjera si bashkëpunimi, marrëdhëniet dypalëshe dhe shumpalëshe. Diplomacia ushtarake e “*vjetër*” përdorej nga vendet

ish-komuniste, si nxitëse në luftën dhe përballimin e kundërshtarit. Filozofia e diplomacisë së “*vjetër*” ushtarake ishte rritja e tensioneve midis kampeve, forcimin e aleancave midis vendeve të blloqeve ushtarake dhe sigurimi i integritetit dhe unitetit të vendeve anëtare. Ndryshimet politike dhe dështimi i sistemit socialist krijuan hapësira dhe mundësi në ndryshimin dhe riformatimin e filozofisë të diplomacisë të “*vejtër*” ushtarake në lidhje me marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ndërmjet Perendimit dhe Lindjes.

Vendet e bllokut komunist në fillimin e vitit 1988, filluan të realizonin ndryshimet e para në lidhje me sistemin politik të drejtimit. Fjalimet dhe platformat e mbajtura nga Z. Mihail Gorbaçov, ish-Sekretari i Përgjithshëm i PK të BS (1988), si Glasnost ‘*openness – hapja*’ dhe Perestrojka ‘*restructuring – rristurimi*’, hodhën hapat e para në shpërbërjen e perandorisë së lindjes. Ndryshimet e para demokratike filluan në vendet e Balltikut³⁸ (*Shih Hartën në shtojcën No. 1*), me pas këto ndryshime u ndoqën nga protestat në Poloni (1989), nën drejtimin e sindikalistit Les Valesa (Lech WALESA), krijues dhe drejtues i Solidarnosit (*Solidarność*); Rumani (1989) me rrëzimin e rregjimit të Çausheikut (Nicolae Ceaușescu) dhe në Shqipëri (1991) me ndryshimin e rregjimit komunist dhe kalimin në një sistem të ri demokratik.

Rënia e murit të Berlinit dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, krijuan mundësi dhe hapësira në krijimin dhe zhvillimin e diplomacisë ushtarake, prezantimin e vlerave demokratike, forcimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe trajnimeve.

38 Vendet e Balltikut (Lithuania, Latvia dhe Estonia)

1.2 Diplomacia ushtarake, pas viteve 1990.

Strategjia e sigurimit kombëtar të Republikës së Shqipërisë, duke parë realitetin e ri të pas viteve 1990, e vuri theksin në kontributin që Forcat e Armatosura mund të japin nëpërmjet diplomacisë ushtarake, në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse, të cilat ndihmojnë në forcimin e bashkëpunimit dhe besimit reciprok midis partnerëve.³⁹ Në këtë kontekst, nuk mungojnë shembujt konkret ku Shqipëria ka dhënë kontributin e saj në forcimin e dialogut dhe rritjen e sigurisë në rajon dhe më gjërë. Nënshkrimi i marrëveshjes së PFP (1994); pjesëmarrja me trupa në operacionet paqeruajtës në BiH (1994 – *UN/NATO/EU Mission Althea*); Iraq (2003-*Operation Iraqi Freedom, US Lead Coalition*); marrja e ftesës për anëtarësim në NATO në samitin e Bukureshtit dhe anëtarësimi i plotë në NATO (prill 2009), Afganistan (2001-2014 *International Security Assistance Force 'ISAF', NATO Mission*); Çad dhe Republika e Afrikës Qëndrore (2007 – *Rajoni i Darfur/EUFOR TCHAD/RCA*) & (2008 – *MINURCAT:the UN mission in the Central African Republic and Chad*) dhe Afganistan (2015 – *non-combat mission 'Resolute Support'*), dhe nënshkrimi i një numër marrëveshjes dy dhe shumë palëshe, hodhën bazat dhe konsoliduan më tej elementët e diplomacisë ushtarake pas viteve 1990.

Dokumenti i strategjise përcakton qartazi ndikimin dhe rëndësinë e diplomacisë ushtarake në ndërtimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe reduktimin e rreziqeve. Për shembull, Forcat e Armatosura të Britanisë së Madhe kanë theksuar se; të gjitha vendet mund të kontribuojnë në stabilitetin dhe forcimin e sigurisë në botë. Kjo mund të arrihet nëpërmjet përcaktimit të ri të misionit të FA dhe misionit të diplomacisë ushtarake.⁴⁰

39 SSK. Rep. Shqiperise, fq. 9

40 Alice Hills, "Defense Diplomacy and Security Sector Reform"; Contemporary Security Policy, Vol. 21, No. 1 April 2000, a Frank Cass Journal ISSN 1352-3260.

Diplomacia ushtarake si pjesë kryesore e diplomacisë kombëtare në shumë raste, është bërë temë e debateve, midis skeptikëve të fushave të ndryshme dhe diplomatëve të karjerës, në lidhje me rolin dhe rëndësinë e saj në krijimin e urave të bashkëpunimit dhe forcimin e sigurisë në rajon dhe më gjërë. Për shembull, diplomatë të ndryshëm nga vendet e lindjes, si (*Bullgaria, Rumania, Shqipëria, Ukraina, Rusia etj*) nuk besonin dhe nuk pranonin rolin dhe efektet e diplomacisë ushtarake.⁴¹ Ata në shumë raste akuzonin ushtarakët për marrje kompetencash dhe propogandonin se ushtria dhe njerëzit nën uniformë nuk mund të bëjnë diplomaci, por ata janë në gjendje të zbatojnë vetëm urdhërat e politikanëve dhe të mbrojnë integritetin teritorial të vendit. Ata arrinin deri aty sa theksonin, se ushtarakët nuk kanë arsimin dhe kulturën e nevojshme, për të zhvilluar parimet dhe konceptet e diplomacisë ushtarake. Në kundërshtim me frymën e këtyre politikanëve dhe drejtuesve nga vendet ish-komuniste, ish sekretaria amerikane e shtetit Kondoleza Rice (2005 – 2008) në shumë fjalime të saj e ka vënë theksin, në ‘transformimin e diplomacisë’, ajo theksonte se SHBA-të ‘duhet të punojnë më shumë me partnerët në të gjithë botën, në dërtimin e demokracive të qëndrueshme, konsolidimin e formave të qeverisjes, në plotësimin e nevojave të bashkëkombasve dhe përfshirjen e tyre aktive dhe të përgjegjshme në arenën ndërkombëtare.’⁴²

Nën frymën dhe komentet e ish sekretares amerikane Kondoleza Rice dhe në ndryshim nga shumë skeptikë të lindjes ish-komuniste, faqa zyrtare e Ministrisë të Punëve të Jashtme (MPJ) të Republikës së Shqipërisë, publikon një qëndrim krejt ndryshe të vendit tonë dhe e ka përcaktuar si prioritetet ‘mbrojtjen dhe transformimin e Forcave të Armatosura’⁴³ në rrugën e integritimit në strukturat Euro-Atlantike.

41 V. Kozyulin, PIR Center, www.pircenter.org ‘Defense Diplomacy and New century Ahead’

42 <http://www.globalpolicy.org/socecon/develop/oda/2006/04aidtobias.pdf>

43 www.mfa.gov.al/english/misioni, The Mission of the Ministry of Foreign Affairs, gjetur më 28 mars 07.

MPJ e konsideron diplomacinë ushtarake si element kryesor në politikën e jashtme të vendit me ndikim thelbësor në forcimin e aleancave strategjike dhe bashkëpunimit të Shqipërisë me të gjitha vendet, sigurimin e stabilitetit global dhe zbatimin e reformave në fushën politike dhe ushtarake, me qëllim sigurimin e integritetit territorial⁴⁴. Shembulli i këtij bashkëpunimi institucional (MPJ + MM), ishte krijimi i komisioneve të përbashkëta të integritetit në fushën e mbrojtjes, në lidhje me dokumenta të tillë strategjik si MAP-i dhe PARP-i. Ky bashkëpunim ishte përcaktuar qartazi në dokumentin e Strategjisë Ushtarake, në lidhje me rolin e diplomacisë ushtarake dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse në integrimin e vendit në strukturat Euro-Atlantike.⁴⁵ Ndërsa, përvoja Britanike e bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e mbrojtjes dhe integritetit prezanton se; diplomacia ushtarake paraqitet si element i domosdoshme për një politikë të jashtme të qartë e përqëndruar në rekomandimet e politikave ushtarake, dhe prezantuar në Dokumentin e Rishikuar të Strategjisë së Mbrojtjes⁴⁶.

Referencat dhe komentet e mësipërme, na mundësojnë të njohim dhe vlerësojmë domosdoshmërinë e zhvillimit të diplomacisë ushtarake. Terma të tilla, me fillimin e viteve 1990, u bënë pjesë kryesore e aktiviteteve të ushtrive të vendeve perendimore. Vendet si; SHBA, Britania e Madhe, Turqia, Franca, Austria, Gjermani etj, filluan ta bënin diplomacinë ushtarake pjesë të tyre dhe ta reflektonin në dokumentat e sigurisë, planet e bashkëpunimit, dhënien e asistencës teknike, arsimore dhe më gjërë.

Diplomacia ushtarake si pjesë përbërëse e Ministrisë të Mbrojtjes i kaloi përmasat e një elementi tipik ushtarak. Aktivitete të tilla

44 Po aty

45 Gazeta Ushtria, SU, fq. 7

46 Alice Hills "Defense Diplomacy and Security Sector Reform"; Contemporary Security Policy, Vol. 21, No. 1 April 2000, a Frank Cass Journal ISSN 1352-3260.

filluan të bëhen pjesë e politikës së jashtme. Pjesëmarrja jonë në BiH, Afganistan, Irak, Gjeorgji, Çad dhe Republikën e Afrikës Qëndrore, stërvitje të përbashkëta dhe trajnime të ndryshme, rritën rolin e diplomacisë ushtarake, forcuan ndikimin e saj dhe hodhën bazat e krijimit të *'konceptit të ushtarit diplomat në terren'*. Për shembull, komandanti i Komandës Amerikane të Pacifikut në vitin 1994, duke parë rolin dhe rëndësinë e diplomacisë ushtarake, e perkufizonte dhe identifikonte konceptin e ushtarit diplomat në terren duke theksuar se: atë që bën ushtaraku në terren, nuk mund ta bëj ambasadori i një vendi në kryeqytet.⁴⁷

Për shembull, SHBA pas viteve 1990, filluan zbatimin e programit IMET në arsimimin e ushtarakëve dhe civilëve nga vendet e Europës Lindore dhe Jug-lidore. Efektiviteti dhe efikasiteti i programit IMET u shtri dhe në kontinente të tjera, si kontinenti Aziatik, Oqeania, Amerika Latine etj. Programi IMET u mundësoi ushtarakëve dhe civilëve të këtyre vendeve, *"dikur armiq të betuar"*, të ulen në të njëjtat auditore, të shkëmbejnë informacione dhe eksperiencë për situata të ndryshme luftarake dhe emergjencat natyrore. Në këtë kuadër, forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet programit IMET, kanë përfituar një numër të konsiderueshëm bursash në arsimimin e ushtarakëve dhe civilëve.

Zbatimi i elementëve si; arsimimi, studimi dhe trajnimi, mundësojnë njohjen me kolegë nga rajone dhe vende të dryshme, mentalitete dhe kultura të ndryshme, gjuhë dhe eksperiencë të reja. Këto mundësi duhen shfrytëzuar në krijimin e urave lidhëse midis forcave të armatosura.

Trainimet e organizuara nga Qendra Marshall, Shkolla e NATO-s Oberamergau, Qëndrat e PfP-s në BiH, Ukrainë, Turqi dhe Greqi, marrëdhëniet dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e arsmimit, zhvillojnë dhe konsolidojnë më tej artin e diplomacisë ushtarake. Ky art në shumë raste bën mrekulli. Atë që nuk e bën dot politika

47 Karl K. Schonberg, fq. 70

dhe forca e armëve e bën diplomacia dhe konkretisht diplomacia ushtarake. Ju mundëson “*armique*” të dikurshëm të studiojnë në një auditor, të jetojnë dhe argëtohen në një ambient, me pak fjalë u mundëson të njihen, ta kuptojnë dhe përkrahin njëri-tjetri, se rruga e vetme është bashkëpunimi. Ky bashkëpunim kalon nëpërmjet asaj që ne e përmendim me dhjetra herë diplomacia ushtarake.

Diplomacia ushtarake e pas viteve 1990 është zhvilluar edhe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dy palëshe dhe shumëpalëshe në fushën e mbrojtjes. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh. Ato grupohen në tre nëngrupe: (1) marrëveshjet e nënshkruara me vendet e rajonit; (2) vendet e NATO-s dhe (3) me vendet partnere. Qëllimi i kësaj pjese, nuk është analizimi dhe roli i marrëveshjeve, pasi ato do të trajtohen dhe komentohen në kapitullin pasardhës.

Ndërsa elementë si, stërvitjet e përbashkëta krijojnë mundësi në rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit dhe kordinimit midis ish armiqve. Ndryshimet demokratike kanë krijuar mundësi pjesëmarrjeje në një numër të madh stërvitjesh, brënda dhe jashtë vendit, me përfaqësues, ekspertë dhe trupa ushtarake. Stërvitjet “*Biza 95*” ose “*Corner Stone 00*”, “*Cooperation Demand*” ose “*JCET – 2015*” zhvilluar në Shqipëri, janë shembuj konkret në prezantimin dhe zbatimin e elementëve të diplomacisë ushtarake, si bashkëpunimi, shkëmbimin i përvojës dhe rritja e frymës së mirëkuptimit.

Seminaret e ndryshme u mundësojnë vendeve pjesëmarrëse shkëmbimin e njohurive, ideve dhe përvojave, krijimin e lidhjeve të reja “miqësore” midis kolegësh. Seminaret e zhvilluara në Maqedoni (2004) dhe Shqipëri (2005) nga Qendra për Studimet Strategjike e Gjenevës, Zvicër, kurse/seminare trajnimit për oficerët e shtabeve të forcave të OKB, zhvilluar nga Swidint, Suedi, Qendra Marshal, Garmishpartenkirshen, Gjermani etj, mundësojnë njohjen e kolegëve nga vende dhe rajone të ndryshme dhe janë një mundësi

e mirë për të mësuar dhe testuar njohuritë dhe eksperiencat e mëparshme.

Trajnimet dhe arsimimet e ndryshme krijojnë hapësira dhe mundësi në zhvillimin dhe konsolidimin e artit të luftimit, zhvillimit të forcës, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pjesëmarrjes në operacionet paqeruajtëse dhe luftimit me trupa. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, e kanë bërë pjesë të filozofisë së tyre trajnimin dhe arsimimin e personelit ushtarak dhe civil në vendet më të zhvilluara të NATO-s dhe partnere. Ne nuk duhet të harrojmë se kjo është rruga e vetme, për të arritur suksesin. Admirali Stavridis (komandanti i komandës supreme të NATO/SHAPE 2012-2014) ka thënë: Ne do të kemi sukses dhe do ta mundim armikun. Ta arrijmë këtë objektiv, ne na duhet të lexojmë, mendojmë dhe shkruajmë.

Aktivitetet dhe ngjarje në fushat e arsimit, trajnimit dhe stervitjes, krijojnë dhe mundësojnë zhvillimin dhe konsolidimin e elementëve kryesorë të diplomacisë ushtarake. Dokumenti i Rishikuar i Strategjisë të Mbrojtjes (SDR) i shumë vendeve anëtare të NATO-s, e ka trajtuar dhe paraqitur diplomacinë ushtarake më shumë se aktivitetet e përmendura më lart. 'Diplomacia Ushtarake u mundëson FA-ve të realizojnë një numër aktiviteteve të ndërmarrë nga Ministria e Mbrojtjes në largimin e kërcënimeve, ndërtimin dhe forcimin e besimit dhe asistimin në zhvillimet ushtarake, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve'.⁴⁸ Ndërsa Valeri Rachev në studimin e tij, diplomacinë ushtarake e përcakton, si element kryesorë në forcimin e bashkëpunimit dhe reduktimin e rreziqeve në rajon.⁴⁹

48 'Strategic Defense Review: Modern Forces for The Modern World: Fact Sheets, Defense Diplomacy' (London: Stationary Office, 1998), it is 'disarmament of mind'.

49 V. Rachev, fq. 59

Analizimi i ngjarjeve dhe zhvillimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, nuk kanë si qëllim komentimin dhe shpjegimin se diplomacia ushtarake është element i ri i lindur pas viteve 1990. Në mbështetje të idesë se diplomacia ushtarake nuk është diçka e re, Alice Hills (2000) ka komentuar dhe ka arritur në konkluzion se “diplomacia ushtarake nuk është një aktivitet i ri për ne”. Forcat e Armatosura të Shqipërisë, para viteve 90-t, kanë marrë pjesë dhe kontribuar në aktivitete të tilla, të cilat sot ne i konsiderojmë pjesë të diplomacisë ushtarake. Shqipëria si pjesë e traktatit të Varshavës ishte aktive me pjesëmarrjet në stërvitje të përbashkëta, shkëmbime delegacionesh, dërgime studentësh, pjesëmarrje në konferenca dhe seminare të ndryshme.

Rënia e murit të Berlinit dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik solli erën e ndryshimeve demokratikë në Shqipëri, duke përfshirë të gjitha sferat e shoqërisë dhe Forcat e Armatosura. Vizitat e para të Ministrit të Mbrojtjes në Turqi, Greqi dhe Itali hapën rrugën e bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Këto ngjarje hodhën hapat e para të fillimit të një procesi të gjatë transformimi dhe konsolidimi, në organizimin, trajnimin dhe paisjen e FA të Shqipërisë.

Vendet me demokraci të konsoliduar dhe ato me demokraci në zhvillim, po i kushtojnë më shumë vëmendje zhvillimit dhe konsolidimit të diplomacisë ushtarake në interes të forcimit të sigurisë, integritetit dhe bashkëpunimit. Por nuk ndodh kështu me disa “*skeptikë*” dhe “*medioanalistë*”, nga ish-vendet komuniste si, Polonia, Rumania, Bullgaria, Shqipëria, Rusia, Kazakistani, Turkmenistani etj, të cilën japin alarmin se Ministrinë e Mbrojtjes po marrin kompetencat e Ministrive të Punëve të Jashtme. Në anën tjetër “*zyrtarë*” dhe “*politikologë*”, në debatet televizive të organizuar nga TV në Kazakistan ose në Sllovaki, trumbetojnë mbivendosjen e detyrave dhe funksioneve në fushën e diplomacisë.⁵⁰ Diplomacia ushtarake dhe ajo kombëtare, kanë rolin e tyre të veçantë dhe shumë të rëndësishëm në jetën demokratike të një

50 V. Kozyulin, www.pircenter.org

vendi. Të dyja së bashku mbulojnë dhe ndihmojnë njëra tjetrën në fushën e integritetit dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës.

U del për detyrë specialistëve dhe profesionistëve të merren me konsolidimin dhe analizimin e termit diplomaci ushtarake. Ky analizim kërkon më shumë vëmendje dhe qartësim nga institucionet kompetente me qëllim shmangien e keqkuptimeve, xhelozive profesionale, mbivendosjen e kompetencave dhe debateve ndër-institucionale. Ushtarakët dhe civilët janë pjesë e një trupi të vetëm, të cilët punojnë dhe afrojnë kontributin e tyre në interes të integritimeve Euro-Atlantike.

1.3 Rëndësia dhe roli i diplomacisë ushtarake

Angazhimet aktuale të FA dhe karakteristikat e faktorëve gjeopolitikë dhe gjeostrategjikë kanë krijuar një ambjent pozitiv në konsolidimin e elementëve dhe instrumentave të politikës së jashtme dhe interesave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ndryshimet në fushën e sigurisë dhe politikës kanë mundësuar dhe krijuar kushtet e duhura për transformimin e rolit dhe objektit të përdorimit të forcave të armatosura në kushtet e reja të sigurisë. Komponenti ushtarak është instrument i politikës së jashtme, në të gjitha situatat të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe rritjen e bashkëpunimit. Clausewitz do të theksonte në veprën tij 'Mbi Luftën/On War', se forcat e armatosura janë instrument në duart e politikës.⁵¹ Zgjerimi i menuesë së objektivave ndërkombëtare mund të kërkojnë angazhimin e Forcave të Armatosura, duke zhvilluar dhe angazhuar '*simptomat*' fundamentale të politikës dhe diplomacisë ushtarake. Roli i diplomacisë ushtarakë, sipas këndvështrimin Britanik bazohet në: parandalimi e konflikteve, rritjen e sigurisë, besimit dhe bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.⁵² Kjo '*filozofi*' vlen, jo vetëm

51 Klauzevic, 1994.

52 www.mod.gov.uk

për vendet e zhvilluara por edhe për rajonin e Ballkanit. Nën frymën e kësaj filozofie, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë e vënë theksin dhe vlerësojnë rëndësinë, rolin, objektin dhe misionin e diplomacisë ushtarake të bazuar në:

1. Forcimin dhe rritjen e frymës së bashkëpunimit ndërmjet vendeve të rajonit dhe më gjërë.
2. Organizimin e stërvitjeve, konferencave, workshopeve.
3. Aktivitetet në kuadrin e mbrojtjes, vizitat e ndërsjellta, shkëmbim përvoja, lektorësh dhe studentësh, krijojnë mundësi ushtarakëve dhe personelit civil të njihen, kuptojnë dhe veprojnë së bashku në interes të paqes, stabilitetit dhe integritetit të vendeve të rajonit të Ballkanit në strukturat Euro-Atlantike.

Ballafaqimi dhe analizimi i eksperiencave të vendeve anëtare të NATO-s dhe përvoja jonë 25 vjeçare, krijojnë mundësi në konsolidimin, zhvillimin dhe aplikimin e diplomacisë ushtarake në interes të integritetit, stabilitetit dhe rritjes së besimit. Në këtë kontekst, strategët ushtarak Gjerman Frederick the Great (*Kind of Prussia from 1740 until 1786*) dhe Carl von Clausewitz, kanë theksuar avancimin e elementëve dhe rolit të përshtatjes të ushtarakëve dhe aktiviteteve të diplomacisë ushtarake, si pikë integruese në shërbim të arsenalit të fuqisë kombëtare⁵³.

Klasikët dhe strategët ushtarakë të shekullit të 19, kanë komentuar dhe analizuar në shkrimet e tyre, për rolin dhe rëndësinë e ushtarakëve në arritjen e objektivave në fushën e politikës së jashtme, si element shumë dimensional dhe i rëndësishëm në krahasim me luftën e vërtetë⁵⁴.

Në përfundim, roli dhe rëndësia e diplomacisë ushtarake është; të

53 Philips, T.R. *Roots of Strategy: The 5 Greatest Military Classics of All Times*, ed. J.R. Phillips (Mechanicsburg: Stackpole Book, 1985), 339.

54 Po aty

ndihmojë vendin dhe Forcat e Armatosura në rrugën e konsolidimit në strukturat Euro-Atlantike. Në lidhje me rëndësinë dhe rolin e pazëvendësueshëm të diplomacisë ushtarake, Carl von Clausewitz ka identifikuar nevojën për lidera me uniformë, të cilët duhet të jenë ushtarakë dhe burra shteti.

Udhëheqësit ushtarak/komandantët, duhet të kuptojnë objektivat politike të vendit, dhe të zbatojnë fuqinë e nevojshme për të arritur këto objektiva⁵⁵. Komandantët/ushtarakët janë në gjëndje të koordinojnë dhe kombinojnë rolin e diplomacisë ushtarake në interes të objektivave kombëtare. Në këtë linjë, strategu Kinez Sun Tzu përpara 2500-vjetësh do të argumentonte se komandantët/ushtarakët e lartë janë të aftë të arrijen objektivin më të gjitha mjetet e influencës/ndikimit, përfshirë mjetet e 'dhunës' dhe 'dialogut'.


Analizat dhe përkufizimet na drejtojnë dhe udhëzojnë në mënyrë të qartë për rolin dhe objektin e "Diplomacisë Ushtarake" në forcimin e paqes dhe stabilitetit. Komentet dhe shpjegimet e Clausewitz, Sun Tzu dhe Frederic the Greate e kanë ndihmuar autorin Indian Sacharn ta përkufizojë diplomacinë ushtarake, art ose praktik të drejtimit në marrëdhëniet ndërkombëtare.⁵⁶

Arti dhe praktika e diplomacisë ushtarake përcaktuar nga Sacharn do ta bazonte dhe kanalizonte eksperiencën Indiane në dy komponentë bazë; diplomacia parandaluese dhe diplomacia shtrënguese⁵⁷. (*Shih fig No. 1*)

55 Clausewitz, Carl von. On War, Notes of 10 July 1827 ed. Michael Howard and Peter Paret, trans. Michal Hoëard and Peter Paret (Princeton: Princeton University Press, 1974), fq.69. Commander-in-Chief refers to the military commander rather than the President, as is the case in United States Government terminology.

56 S. Sacharn, fq. 3

57 Miehs, Cristian Mihail, "Topical Military Diplomacy" at <http://www.presamil.ro/VA/2001/3-4/leng.htm>.



1.3.1 Diplomacia parandaluese (Preventive Diplomacy)

Komponenti ushtarak nëpërmjet diplomacisë parandaluese ka si qëllim arritjen e një klime konfidenciale të rëndësishme në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Ekspertë dhe analistë të shumtë, këtë rol/objekt të diplomacisë parandaluese e kanë quajtur “*diplomacia ushtarake e kohës së paqes*”. Vendet të cilat ndodhen në konflikte të armatosura ose në konflikte të natyrave të tjera, është e rëndësishme, përcaktimi dhe identifikimi i interesave të përbashkëta dhe fushave të bashkëpunimit, veçanërisht në fushën e mbrojtjes. Roli i diplomacisë ushtarake në kohë paqe është të gjejë ritmet e duhura të zhvillimeve ushtarake ndërmjet dy ose më shumë vendeve dhe aktorëve.

Termi diplomaci dhe përdorimi i forcës janë dy opsione të kundërta, si pjesë përbërëse e spektrit të vendimarrjes politike, njëri element është përdorur në atë rast kur elementi tjetër ka dështuar, por është e rëndësishme të theksojmë se të dyja duhet të mbështesin njëra-tjetrën.⁵⁸ Kjo na bën në mënyrë transparente në krijimin e balancës midis politikës së jashtme (*diplomacisë kombëtare*), interesave të sigurisë (*ku përfshihet diplomacia ushtarake*) dhe forcimin e marrëdhënieve ushtarake nëpërmjet elementëve të politikës së jashtme, siç janë arsimimi në fushën e mbrojtjes, transferimi i teknologjisë ushtarake,

58 S. Sacharn, fq. 2

dialogu në fushën e sigurisë dhe forcimin e mirëbesimit. Diplomacia ushtarake, sipas Sacharn, nuk zhvillon diplomacinë e shtetit, por fushat dhe marrëdhëniet ushtarake janë të influencuara nga rrjedha e përgjithëshme e marrëdhënieve.⁵⁹ Qeveria publikon në terma të përgjithshëm elementët përbërës të politikës së jashtme dhe diplomacia ushtarake është pjesë e rëndësishme e kësaj politike.

1.3.2 Diplomacia shtrënguese (Coercive Diplomacy)

Diplomacia shtrënguese mund të përdoret kur të gjithë komponentët e diplomacisë parandaluese janë konsumuar⁶⁰. Ky moment përcakton vijën ndarëse imagjinare ndërmjet diplomacisë dhe luftës. Suksesi i diplomacisë shtrënguese lidhet me tregimin/prezantimin e aftësive ushtarake në vënd të përdorimit të tyre⁶¹. Fuqia dhe potenciali ushtarak, përbën thelbin e diplomacisë shtrënguese.

Një numër autorësh kanë studiuar dhe analizuar efektet e 'diplomacisë shtrënguese' dhe 'imponimin e veprimeve' të sponsorizuar nga Instituti për Paqen i SHBA-s;⁶² studimet në fushën e diplomacisë shtrënguese të përgatitura nga Daniel Byman, Matthew Waxman, Stephen Hosmer, dhe të tjerë,⁶³ kërkimet në fushën e ndërhyrjeve ushtarake në Qendrën Henry L. Stimson dhe Ardhmja e Mbrojtjes Ndërkombëtare;⁶⁴ studimet e Ivo Daalder dhe Michael O'Hanlon për politikën diplomatike dhe ushtarake të ndjekuara nga OKB dhe NATO në Kosovë.⁶⁵

59 Po Aty

60 Po Aty

61 Gupta, Narendra, It Pays to be Coercive. The Indian Express. February 4, 2002. Back.

62 Donald C.F. Daniel dhe Bradd C. Hayes (2003)

63 Daniel Bayman dhe Matthew Waxman (2002)

64 Barry M. Blechman dhe Tamara Cofman, fq. 9-38

65 Ivo H. Daalder dhe Michael E. O'Hanlon (2000)

Pjesa me e madhe e studimeve të reja të Alexander George dhe Thomas Schelling – janë vlerësime të ballancuara të kushteve në të cilat diplomacia shtrënguese ka gjasa të triumfojë ose dështojë. Ata theksojnë rëndësinë e kuptimit të plotë të *'shkopit'* në marrëveshjet diplomatike me kundërshtarët në rifocimin e apelit të *'karrotës'* si shtytje pozitive, në vend të përdorimit të forcës.⁶⁶

Për shembull, vendet e zhvilluara perendimore në lidhje me situatën në Korenë e Veriut, demostrojnë në politikën e tyre të *"forcës"* zbatimin e vendimeve të Këshillit të Sigurimit dhe *"kërcënimit"* e përdorimit të forcës. Ky shembull, mund të konsiderohet si element i diplomacisë shtrënguese në parandalimin e konflikteve dhe kërcënimit e përdorimit të armëve të dëmtimit në masë. Për shembull, heqjet e sanksioneve ndaj Irani është një tjetër shembull, ku diplomacia shtrënguese ka dhënë rezultatet e saj. Në vend të përdorimit të forcës, komuniteti ndërkombëtarë përdori sanksionet, si element shtrëngues në plotësimin e kriterëve/kushteve të mos-zhvillimit të programit të armëve bërthamore. Kjo dha efektet e saj në uljen e tensionit dhe krijimin e mundësive për zhvillim brënda vendit dhe bashkëpunim me partnerët dhe aktorët ndërkombëtarë.

1.4 Përfudime

Ndryshimet demokratike të pas viteve 1990 hodhën bazat e zhvillimit dhe konsolidimit të diplomacisë ushtarake. Ky term sot është përfshirë në të gjitha dokumentat e Sigurisë të vendeve të NATO-s dhe partnere. Diplomacia ushtarake zhvillohet gjëresisht në arritjen e objektivave ushtarakë dhe politike me qëllim arritjen e paqes, krijimin e besimit reciprok, zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, rritjen e sigurisë dhe stabilitetit midis vendeve.

66 Seyom Brawn, fq. 146

Ky term - diplomacia ushtarake – po merr rrol parësor në politikën e jashtme dhe fushën e mbrojtjes. Atë që arrin të realizoj diplomacia ushtarak, në disa rastë nuk është në gjendje ta realizojë forca e armëve. Diplomacia ushtarake është gjuha e mirëkuptimit, bashkëbisedimit, rritjes së besimit, sigurisë dhe ndihmës reciproke. Kjo gjuhë në shumë raste ka dhënë rezultat në uljen e tensioneve dhe hedhjen e bazave të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Si përfundim, le ta mbyllim duke e vënë theksin tek thënia: *Fjala zbut malin, pushka ngreh djallin.*

2. DIPLOMACIA USHTARAKE

Ndryshimet e ndodhura pas viteve 1990, hapën rrugën dhe krijuan mundësi Forcave të Armatosura të bashkëpunonin më shumë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Vendet anëtare të NATO-s dhe Europës Jug-lindore, ku përfshihet dhe Shqipërinë, u bënë pjesë e një numëri aktiviteteve të përbashkëta në fushat si; trajnimi, asistenca teknike dhe stërvitja.

Në vitin 1994, NATO publikoi një program të ri bashkëpunimi titulluar “Programi i partneritetit për Paqe” (*Partnership for Peace*), me qëllim rritjen e bashkëpunimit me vendet ish-komuniste nga Europa Jug-lindore. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë ishte një nga vendet e para, e cila nënshkroi dhe pranoi të bëhej pjesë e programit në vitin 1994.

Shpërbërja e BS dhe rënia e perdes së hekurt midis Perendimit dhe Lindjes, hapi një epokë të re bashkëpunimi në të gjitha fushat, duke përfshirë fushën ekonomike, shkencën, kulturën, arsimimin, shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen. Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ka marrë një shtrirje të gjërë në ndihmë të reduktimit të kërcënimeve, rritjes së sigurisë dhe forcimit të dialogut midis kombeve. Iniciativa të tilla bashkëpunimi si; NATO dhe Rusia, NATO dhe Ukraina, NATO dhe Gjeorgjia (2008) dhe Dialogu i Vendeve të Mesdheut⁶⁷ (*shih hartën në shtojcën No.2*), kanë krijuar një klimë të re besimi dhe bashkëpunimi.

67 Vendet e Dialogut të Mesdheut (Mediterranean Dialogue Countries) janë Jordania, Izraeli, Egjipti, Tunizia, Algjeria, Maroku dhe Mauritania.

Në Azi, për shembull vlen të theksohet bashkëpunimi ushtarak midis SHBA-s, Kinës, Indisë dhe Pakistanit. Dialogu në fushën e mbrojtjes është zhvilluar dhe vazhdon të zhvillohet edhe nëpërmjet iniciativës së ASEAN-it dhe vendeve anëtare të Forumit të Shangait⁶⁸ (Shih hartën në shtojcë No.3). Samiti i Stambollit në vitin 2004, hodhi bazat e krijimit të një tjetër bashkëpunimi në kontinentin Aziatik dhe këtë radhë midis NATO-s dhe vendeve të Gjirit Persik, njohur si Iniciativa e Bashkëpunimit të Stambollit (Istanbul Cooperation Initiative)⁶⁹ (Shih hartën në shtojcën No.4).

Në Afrikë, vendet e NATO-s, BE-s dhe SHBA-t, janë përfshirë në një numër projektesh në ristrukturimin e Forcave të Armatosura, rritjen e kapaciteteve pjesëmarrëse në operacionet paqeruajtëse nëpërmjet bashkëpunimit me Bashkimin Afrikan (African Union), në mbështetje të organizatave si; Bashkësia e Zhvillimit të Vendeve të Afrikës së Jugut (SADC) në rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, dhe arsimimit. Bashkëpunimet e shumta dypalëshe me vendet e Afrikës, pjesmarrja në stërvitje, adoptimi ose njohja me procedurat e planizimit në fushën e mbrojtjes, hapja/ngritja e zyrës së NATO's në Adis Abeba (Ethiopi) dhe nënshkrimi i marrëveshjes (SOFA) midis NATO's dhe AU, janë hapa të cilat tregojnë për bashkëpunimin e NATO-s, me vendet dhe institucionet na kontinenti Afrikan. Gjithashtu vlen të përmenden bashkëpunimet dypalëshe, për shembull, midis Mbretërisë së Bashkuar me Siera Leone dhe Mozambikut, Francës dhe Çadin etj.

Ndryshimet demokratike, largimi i rrezikut të konfrontimit Lindje-Perendim, globalizimi në fushën e ekonomisë i kanë krijuar terren diplomacisë ushtarake të luaj rol vendimtar në parandalimin e konflikteve, rritjen e bashkëpunimit, besimit, sigurisë në kundërshtim me rolin tradicional të Forcave të Armatosura i përcaktuar si përdorimi

68 Vendet anëtare të forumit të Shangait; Kina, Federata Ruse, Kirgizistani, Kazakistani dhe Pakistani.

69 Istanbul Cooperation Initiative (Arabia Saudite, Kuvajti, Katari, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahreini).

i forcës – me qëllim ruajtjen e integritetit territorial, mbrojtjen e vendit dhe sulmimin e forcave armike.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë pas vitit 1990 me ndryshimet e reja demokratike shtuan dhe rritën bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes me NATO-n dhe vendet partnere (PfP). Në këtë kuadër, Shqipëria ka nënshkruar një numër dokumentash, marrëveshesh dy dhe shumë palëshe. Shqipëria ishte anëtare e MAP-it, PARP-it, aktualisht është anëtare e Ministerialit të Europës Juglindore (SEDM/MPFSEE) dhe SEEBRIG. Eksperiencat dhe përvojat e mëparshme e ndihmuan Shqipërinë në samitin e Bukureshtit, 2-3 Prill 2008, të merrte ftesën për anëtarësim në NATO dhe në vitin 2009, të bëhet pjesë e aleancës.

Zbatimi dhe trajtimi i diplomacisë ushtarake, në këtë kapitull, do të zhvillohet dhe analizohet nëpërmjet dy momenteve kryesore:

Se pari, lexuesi do të njihet me analizimin dhe trajtimin e diplomacisë ushtarake, si mjet parandalues në rastet e konflikteve të armatosura.

Se dyti, kapitulli do të shqyrtojë dhe analizojë bashkëpunimin ushtarak në fushën e mbrojtjes dhe zbatimit të elementëve të diplomacisë ushtarake në marrëdhëniet NATO – Rusi dhe SHBA – Kinë (*rasti i dytë do të shërbejë për studimin dhe analizimin e filozofisë dhe artit të diplomacisë ushtarake, përdorur nga SHBA-ja në marrëdhëniet me Kinën*).

Studimi i rasteve dhe ndikimit të diplomacisë ushtarake në parandalimin e konflikteve dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë do të bëjë sqarimin e ndryshimit midis diplomacisë së vjetër ushtarake, fokusuar tek kundërshtarët potencial dhe diplomacia e re ushtarake e përfshirë më shumë në bashkëpunimin me ish armiqtë/kundërshtarë, mbështetjen e dhënë demokracive të reja, respektimi i të drejtave të njeriut dhe rritjen e besimit dhe mirëkuptimit.

Koncepti dhe filozofia e rolit të diplomacisë ushtarake, sipas pikpamjes amerikane, është përfshirja e saj më shumë si element ndihmues në krijimin e stabilitetit tek vendet me demokraci të pakonsoliduar, promovimin e demokracive të reja dhe reduktimin e konflikteve dhe tensioneve në rajon dhe më gjërë.⁷⁰

2.1 Diplomacia Ushtarake si mjet në parandalimin e konflikteve

Rënia e murit të Berlinit dhe shpërbërja e BS krijuan hapësira në ndryshimin dhe riformatimin e rolit të diplomacisë ushtarake. Sot ky term njihet si diplomacia ushtarake e pas luftës së ftohtë.

Kapitulli do të analizoi dhe komentoi rolin e diplomacisë ushtarake, si mjet në parandalimin e konflikteve, duke përdorur shembuj nga bashkëpunimi ushtarak midis vendeve anëtare të NATO dhe Rusisë, SHBA-se dhe Kinës, si dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me vendet anëtare të Aleancës dhe ato partnere.

Fillimet e viteve 1990 mundësuan dhe krijuan një mjedis të ri bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe asistencës, midis vendeve të NATO-s dhe ish-vendeve anëtare të bllokut ushtarak të Varshavës.

Diplomacia ushtarake lindi si element në afrimin dhe forcimin e marrëdhënieve dhe rolit të ushtarakëve në krijimin e një mjedisi sigurie të besueshëm midis aleatëve dhe partnerëve të rinj. Ky koncept hodhi bazat e para të një bashkëpunimi bazuar totalisht mbi principet e reciprocitetit, besimit, bashkëpunimit dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm në parandalimin e konflikteve. Për shëmbull, SHBA-ja dhe aleatatët e saj e kanë përdorur diplomacinë ushtarake, si komponent në përmirësimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve politike

70 Po Aty

me Rusinë dhe Kinën.⁷¹ Ndërsa Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë e kanë përdorur rolin e diplomacisë ushtarake, si element në rritjen e bashkëpunimit në rajon, uljen e tensioneve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet dialogut dhe bashkëpunimit. Iniciativa të tilla si US – Adriatic Charter 5, njohur si A5 ose Ministeriali i Mbrojtjes i Europës Jug-lindore (SEDM) dhe Brigada e Europës Jug-lindore (SEEBRIG/MPFSEE), janë disa nga elementët e shumtë të përdorur në rritjen e bashkëpunimit dhe reduktimin e konflikteve në rajon.

Ndërsa, diplomacia ushtarake sipas Cottey dhe Forster (2004) është instrument bazë dhe parandalues në ndërtimin, bashkëpunimin dhe reduktimin e rreziqeve dhe konflikteve të përfshira në një numër fushash:

1. Diplomacia ushtarake është e përfshirë në fushën e bashkëpunimit ushtarak, në rritjen dhe forcimin e simboleve si, zgjerimi i bashkëpunimit, rritja e besimit dhe angazhimit në kalimin dhe shmangien e ndryshimeve që zakonisht ndodhin midis partnerëve dhe vendeve të veçanta në rajon. Për shembull, miratimi i marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, ndikon në rritjen e besimit reciprok dhe reduktimin e rreziqeve.
2. Diplomacia ushtarake mund të orientohet dhe përdoret në analizimin dhe shpjegimin e fushave të bashkëpunimit me interes të përbashkët. Elementë të tillë të bashkëpunimi si SEDM dhe MPFSEE në Ballkan, NATO dhe Rusi, NATO dhe Ukraina, NATO dhe Dialogu i Vendeve të Mesdheut, Iniciativa e Stambollit (2004), janë shembuj domethënës në rritjen e vetëdijes në lidhje me elementët dhe pikat me interes të përbashkët në fushën e bashkëpunimit ushtarak. Në këtë kontekst, ish Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lordi

71 A. Cottey dhe A. Forster, fp. 5.

Xhorxh Robertson, si arkitekt i diplomacisë ushtrake në Forcat e Armatosura të Britanisë së Madhe, gjatë kohës si Sekretar i Mbrojtjes në vitin 1998 në dokumentin e Strategjisë të Mbrojtjes e ka përcaktuar këtë proces si “*çarmatosje e mendjes*”.⁷² Ndërsa John Leech në librin e tij ‘*Konfliktet Asimetrike: Luftë pa vdekje*’ thekson se diplomacia është skalioni i parë i mbrojtjes dhe mësymjes/ndërhyrjes. Diplomacia është dialog, dhe në fjalët e Thorvald Stoltenber (bashkëkryetari i Komitetit të Drejtimit të Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe ish-Ministri i Jashtëm i Norvegjisë) në mësimet e nxjerra nga Bosnja ka theksuar se: ‘Ne duhet të shmangim situatat ku procesi i negociatave ka ndaluar se ekzistuari dhe dialogu i vërtetë nuk egziston’.⁷³

3. Diplomacia ushtarake mund të përdoret si element mbështetës në konkretizimin e reformave në fushën e mbrojtjes afruar vendeve partnere. Për shembull, asistencën teknike dhe arsimore që ka dhënë dhe jep SHBA nëpërmjet programit arsimor IMET për ushtarakët dhe civilët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë; Turqia nëpërmjet asistencës teknike dhe trajnimeve për trupat komando; Gjermania në ristrukturimin dhe modernizimin e KDS (*para vitit 2010*); Italia në afrimin e asistencës teknike dhe konsultimeve në ngritjen dhe konsolidimin e BrRSH (*2008 – sot forcat tokësore*) dhe Kursit të Lartë në Fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes (*SCSDS 2007 – 2010*).
4. Asistenca ushtarake mund të përdoret gjithashtu edhe për nxitjen e bashkëpunimit midis partnerëve në fusha të tjera në nivel taktik, operacional dhe strategjik. Këtu do të dëshiroja të përmendja dhe theksoja asistencën e dhënë nga Gjermania në pjesëmarrjen e trupave Shqiptare në operacionet e ndryshme

72 Strategjia i Sigurimit e Mbrotesise se Bashkuar, fq. 12

73 J. Leench, fq.47-48

paqeruajtëse në Bosnje – Hercegovinë (1994). Bashkëpunimi me Turqinë, Italinë dhe SHBA-ve, në operacionin paqeruajtës në Afganistan (*ISAF + Resolution Support - 2002-2016*) dhe prezenca jonë në Irak (2003-2012), mundësuar nga mbështetja Amerikane në mbrojtje të paqes dhe krijimit të një mjedisi të përshtatshëm në zbatimin e ligjit dhe sigurisë në Mosul. Këto eksperiencat dhe bashkëpunime pasqyrohen dhe shpjegohen qartë nga ish Sekretari Amerikan George Sultz i cili thotë se diplomacia dhe ushtarakët si pjesë e qeverisë kanë filluar të punojnë shumë ngusht më njëri tjetrin që nga koha e shpërbërjes së BS.⁷⁴

Eksperiencat e vendeve perendimore shpesh kanë provuar se bashkëpunimi ushtarak në shumë raste nuk është i vetmi element i cili krijon mundësi bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperiencash por krijon dhe “një numër dilemash dhe problemesh”.⁷⁵ Në shumë raste pas bashkëpunimit ushtarak kanë lindur pyetje të rëndësishme dhe njëkohesisht janë ngritur shumë pikpyetje, se a është në gjëndje diplomacia ushtarake të luaj rolin e saj si element kyç në parandalimin e konflikteve dhe rritjen e besimit midis partnerëve dhe ish armiqve. Në shumë raste konfliktet e ndodhura kanë krijuar tensione ushtarake dhe politike. Këto tensione kanë zbehur rolin e diplomacisë ushtarake dhe nxjerrë ne plan të parë rolin e politikës dhe elementëve ekstremist. Kjo ka ndodhur për arsye të diferencave politike që mund të ndodhin midis dy ose më shumë vendeve/aktorëve. Këto divergjenca kanë minuar mënyrat dhe format e bashkëpunimit, si në fushën e mbrojtjes edhe në fushat e tjera. Me pak fjalë, problemet dhe pikpamjet e ndryshme kanë zvogëluar kontaktet dhe rritur tensionin, mosbesimin, konfliktin dhe ka sjellë dhe njëherë në memorijen tonë momentet e konflikteve gjatë luftës së ftohtë.

74 Cituar nga D.S. Reveron, fq. 74

75 Po Aty

Për shembull marrëdhëniet e Perendimit/NATO me Rusinë nuk janë në nivelet e duhura. Ato kanë pasur ngritje-uljet e tyre që nga viti 1990 e deri në ditët tona. Kjo ka ardhur për arsye të diferencave politike, nivelit ekonomik, interesave rajonale dhe strategjike dhe zhvillimit të demokracisë në vend. Qëndrimi për shembull kritik i Rusesë ndaj anëtarësimit të vendeve të Balltikut në NATO dhe BE, çështja e zhvillimit të programit bërthamorë të Iranit, aneksimi i gadishullit të Krimesë (shkurt 2014) dhe konflikti në lindje të Ukrainës dhe lufta civile në Siri (2012 & ...), tregon dhe ilustron më së miri ndryshimet midis Rusesë dhe Perëndimit. Element dhe shembull tjetër janë ndryshimet e shfaqura midis Perendimi, udhëhequr nga SHBA me Rusinë dhe Serbinë në lidhje me çështjen e Kosovës, ftesa për anëtarësim dhënë Malit të Zi në NATO (2016) dhe mbështetja politike dhe ekonomike dhënë nga Rusia, republikës Serbcka në Bosnje dhe Hercegovinë. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për presionin dhe bllokadën e bërë nga Rusia, e ndjekur nga aleatja e saj shekullore Serbia, në pengimin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës, shtet i pavarur. Ky element në vetvete nuk sjell gjë tjetër por rrit tensionin, krijon premisa për destabilitet dhe pengimin e zhvillimit të reformave dhe integritit rajonal në strukturat Euro-Atlantike.

Zgjidhja e situatave dhe mosmarrëveshjeve midis shteteve u nevojiten, siç komenton strategu Kinez Sun Tzu, lojtarë të mirë të cilët dinë ta luajnë dhe zhvillojnë diplomacinë⁷⁶. Individët e përfshirë duhet të jenë jo vetëm diplomatë por edhe strateg në drejtimin dhe kontrollin e situatave të cilat gjenerojnë konflikt. Këtyre individëve sipas Sun Tzu, u rekomandohet të jenë udhëheqës të shquar ushtarak të cilët nuk duhet të jenë vetëm strateg të zotë por edhe diplomatë të zotë.⁷⁷ Këto dy përkufizime/thënie formulojnë dy paralele të cilat janë pika referimi dhe orientimi për aktorët civilë dhe ushtarakë të një vendi, në ndërtimin dhe zbatimin e marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes apo

76 Sun Tzu, Cituar nga S. Szykman, fq. 1

77 Po Aty, fq.1

në fusha të tjera. Situata apo konflikte të tilla, ndërmjet një grupi i cili bazon konceptin e ndërtimit të shtetit mbi shtetin e së drejtës dhe një grupi tjetër i cili e bazon konceptin e ndërtimit të shtetit mbi kultin e individit, nuk lënë hapësira për dialog por krijojnë premisa dhe mundësi për konflikt dhe pasiguri. Kjo “*teoremë antagoniste*” na drejton dhe sjell ndërmend analizat dhe komentet që strategu i madh gjerman Clausewit në librin e tij *Arti i Luftes* thekson, se njerëzit e egër janë gjithmonë të influencuar/ndikuar nga pasioni, ndërsa njerëzit e qytetëruar janë gjithmonë të influencuar/ndikuar nga mendja.⁷⁸ Shqëritë e civilizuar ku ne bëjme pjesë nuk besojnë se shekulli i 21 do të jetë shekulli i luftimeve dhe konflikteve por shekulli i diplomacisë ushtarake dhe dialogut. Sisteme të tilla totalitare, si rregjimi komunist në Korenë e Veriut apo Kubë, në Rusi apo Turqi, nuk do të jenë në gjendje të destabilizojnë ose konfliktuajnë rajonin ose globin në tërësi.

Një tjetër dilemë në fushën e zbatimit të diplomacisë ushtarake është se vendet e ndryshme janë të pa qarta se në çnivël dhe sa do të përfshihet bashkëpunimi ushtarak në lidhje me probleme të ndryshme, si mënyrat e veprimit në forcat e armatosura ose ndërmarrja e reformave të ndryshme.⁷⁹ Bashkëveprimi dhe bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes duhet të përfshihet në terma afatgjatë bashkëpunimi me partnerët dhe jo në terma afatshkurtër. Ky element duhet të mbështetet dhe hartohet mbi objektiva të qarta dhe transparente.

Diplomacia ushtarake duhet të përdoret si element strategjik në përfshirjen e një vendi në procesin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. Cottey dhe Forster në librin e tyre “*Riformulimi i Diplomacisë Ushtarake: Role të reja për bashkëpunimin ushtarak dhe asistencën*” kanë theksuar se shtrirja e diplomacisë përfshin dhe bën politikën e mbrojtjes dhe aktivitetin e saj më transparente dhe a duhet ky proces të

78 Calusewitz, “Military Theory”, BDCOL Estonia, 17 nëntor 2005.

79 A. Cottey dhe A. Forster, fq. 18.

mbështetet dhe të ketë si qëllim zhvillimin e bashkëpunimin reciprok?⁸⁰ Në këtë kontekst diplomacia ushtarake mund të ndihmojë në arritjen e objektivave të percaktuara në dokumentat e Strategjise Kombëtare dhe Ushtarake të cilat kanë të bëjnë me bashkëpunimin, shkëmbimin e përvojave, reduktimin e tensioneve, krijimin e një mjedisi më të sigurtë etj. Kjo arrihet kur edhe vendet partnere e kanë të qartë dhe janë transparent në përcaktimin dhe publikimin e objektivave të tyre. Nëse ky proces nuk është ndërtuar në baza transparence dhe reciprociteti, mund të mos krijoj dhe mundësoi një klimë besimi apo reciprociteti. Sot në botë kemi shumë raste ku vendet kanë akuzuar njëra tjetrën, pasi njëra palë e ka përdorur këtë bashkëpunim për qëllime spiunazhi opo qëllime të tjera. Këtu vlen të përmendet bashkëpunimi SHBA – Kinë. Në kuadrin e bashkëpunimit dhe transparencës pala Kineze është akuzuar nga pala amerikane se e ka përdorur bashkëpunimin për qëllime spiunazhi. “Diplomacia ushtarake si mjet i angazhimeve strategjike me armiq të potencial pashmangshmërisht përfshin krijimin e një balance midis afrimit të sigurisë dhe transparencës në njërën anë dhe ndërtimin e një procesi reciprok në anën tjetër.”⁸¹

Një tjetër dilemë në zbatimin e diplomacisë ushtarake është se sa do të ndikojë në përmirësimin e mënyrës së sjelljes ose funksionimit të shtetit të së drejtës në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, diplomacia ushtarake duhet të veprojë në mënyrë efektive edhe në ato vende të cilat nuk kanë arritur të konsolidoj shtetin e së drejtës dhe nuk kanë zbatimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut në shkallën e duhur. Diplomacia ushtarake siç u theksua dhe më lart duhet të përqëndrohet në termat afatgjatë të bashkëpunimit dhe efektet që kjo mund të sjellë. Tentativat e Ministrisë të Mbrojtjes të Shqipërisë (2007), për të krijuar pikat e kontaktit me Serbinë në termat afatshkurtëra, në këtë rast diplomacia ushtarake ka dështuar. Kjo nga vetë fakti dhe momenti nëpër të cilat po kalon rajoni, përcaktimi i

80 Po Aty

81 Po Aty

statusit final të Kosovës (2008) dhe njohja ndërkombëtare e saj si shteti i pavarur. Në shumë raste palët e kanë parë njëra tjetrën si kundërshtarë dhe pa interes në krijimin e pikave të kontaktit dhe fillimin e zbatimit të diplomacisë ushtarake. Por në këtë tunel të errët nuk ka vetëm errësi por ka edhe rreze drite. Kryesimi i Sekretariatit të SEDM nga Shqipëria për periudhën 2005-2007, tregoi dhe një herë që vendi ynë i ka të mirëpërcaktuara dhe mirëorganizuara objektivat strategjike afatgjata të lidhura me rolin dhe efektet e diplomacisë ushtarake. Shqipëria propozoi përfshirjen në këtë proces jo vetëm të Serbisë por edhe të Malit të Zi dhe Bosnje – Hercegovin. Sot ky format nga A3, njihet si A5. Përfshirja dhe jo-përfshirja mund dhe duhet të krijojnë hapërisa dhe rrugë në përmirësimin dhe rritjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Në anën tjetër, eksperiencia Amerikane në fushën e bashkëpunimit me demokracitë e pakonsolidura si Yzbekistani, Kazakistani, Kërgëzistani dhe Taxhikistani, kanë prodhuar më shumë stabilitet në rajonin e Azisë Qëndrore sesa konflikte dhe mosmarrëveshje. Diplomacia ushtarake në këto vende ka kontribuar në rritjen e dialogut dhe besimit midis vendeve dhe SHBA. Bashkëpunimi në luftën kundër rregjimit taleban dhe ekstremistëve në Afganistan tregon për sukseset e diplomacisë ushtarake në zbatimin e filozofisë të përfshirjes në vend të filozofisë së përjashtimit.

Një tjetër dilemë është se sa larg dhe sa shumë duhet të përfshihet dhe influencojë diplomacia ushtarake në parandalimin e konflikteve rajonale, parandalimin e trafikimit të armëve të lehta dhe armëve të dëmtimit në masë, si dhe forcimin dhe krijimin e planeve të bashkëpunimit dypalësh. Në këtë kontekst diplomacia ushtarake mund të bëjë më shumë, për shembull në parandalimin e trafikimit të armëve. Kontrollat e organizuara nga përfaqësuesit ushtarak nën ombrellën e OSBE-s janë një element pozitiv në kontrollin e vendeve dhe rritjen e transparencës në fushën e mbrojtjes, si dhe mundësimin e parandalimit të konflikteve dhe krijimin e urave të bashkëpunimit. FA të Shqipërisë në vitin 2004 zhvilluan një inspektim në fushën e

armë-kontrollit në Republikën Federale Gjermane, nën formatin e marrëveshjeve dhe bashkëpunimit të OSBE-s. Në ekipin e kryesuar nga Shqipëria, u ftuan dhe morrën pjesë si pjesë e Forcave të Armatosura në këtë inspektim, dy përfaqësues, një nga Serbia dhe një nga Maqedonia. Shembull tjetër është inspektimi i organizuar nga Danimarka për armë-kontrollin. Ekipi përbëhej nga pjesëtarë të forcave Daneze, Shqiptare dhe Boshnjake. Shembujt e mësipërm theksojnë efikasitetin e rolit të diplomacisë ushtarake, jo vetëm në fushën e mbrojtjes dhe armë-kontrollit, por edhe në rritjen e bashkëpunimit dhe besimit reciprok midis ish-kundërshtarëve.

Analizat, komentet dhe dilemat rreth diplomacisë ushtarake do të na mundësojnë të njihemi më poshtë me format dhe mënyrat e bashkëpunimit midis NATO-s dhe Rusisë dhe SHBA-s me Kinën, nëpërmjet zbatimit dhe zhvillimit të diplomacisë ushtarake në terren.

2.2 Bashkëpunimi ushtarak NATO – Rusi

Me fillimin e viteve 1990, vendet Perendimore e kanë përdorur diplomacinë ushtarake si pjesë të rëndësishme në ndërtimin e marrëdhënieve me ish-vendet komuniste. Qëllimi kryesor i përdorimit të diplomacisë ushtarake për vendet e Perendimit ka qënë parandalimi i konflikteve me BS dhe vendet e bllokut të lindjes. Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes midis vendeve Perendimore dhe BS i ka fillimet me nënshkrimin e marrëveshjes në Ndërtimin e një Mjedisi Sigurie Konfidencial dhe të Sigurtë (CSBMs) në vitin 1970, duke e intensifikuar këtë marrëveshje gjatë kohës së Gorbaçovit në vitin 1980 dhe duke e rritur intensitetin e bashkëpunimit pas shpërbërjes së BS.⁸²

Bashkëpunimi ushtarak me vendet e ish-BS-s u ndërtua në baza shumpalëshe me NATO-s dhe në baza individuale. Rusia u përfshi në

82 F. Carlucci, fq. 52

marrëdhëniet dypalëshe me NATO-s, pas vitit 1990. Kontakti i parë u krijua në vitin 1993-94, Rusia u bë pjesë e programit për partneritet për paqen (PfP) në vitin 1994-95 dhe pjesë e krijimit të Marrëdhënieve NATO – Rusi në fushën e bashkëpunimit dhe sigurisë, e cila u nënshkrua në vitin 1997.⁸³ Në vitin 1995, Rusia miratoi dërgimin dhe kontribojë me trupa në Bosnje – Hercegovinë në misionin SFOR dhe më vonë me pjesëmarrjen në vitin 1999 në misionin e drejtuar nga NATO në Kosovë (KFOR). Të dy këto angazhime vazhduan deri në vitin 2003-04, kjo për arsye të mbështetjes financiare, mungesës së trajnimit dhe paisjeve sipas standarteve të NATO/PfP. Gjatë konfliktit të Kosovës dhe sulmeve ajrore të NATO, marrëdhëniet NATO – Rusi u përkeqësuan, për arsye të kundërshtisë të Rusesë në sulmet ndaj ish-Jugosllavisë (*Serbisë*). Por këto marrëdhënie nuk qëndruan në këtë gjëndje për një kohë të gjatë. Me rastin e ngjarjeve të sulmeve terroriste të 11 Shtatorit 2001, kundër Amerikës, marrëdhëniet ndërmjet Rusesë – Amerikës dhe NATO-s patën zhvillime të konsiderueshme në fushën e bashkëpunimit dhe luftës kundër terrorizimit ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, në vitin 2002 u krijua këshilli NATO –Rusi. Ky hap u konsiderua si start i mirë për fillimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë midis NATO-s dhe Rusesë. Kjo nuk ishte e vetmja iniciativë bashkëpunimi. Edhe vende të tjera anëtare dhe jo anëtare të NATO-s, kanë intensifikuar bashkëpunimin me Rusinë, si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Izraeli, Turqia, Bullgaria dhe vende të tjera, bazuar mbi plane bashkëpunimi dypalëshe.

Në lidhje me Diplomacinë Ushtarake të vendeve Perendimore (NATO-s) kundrejt Rusesë ka pasur një numër zhvillimesh dhe aktiviteteve:⁸⁴

83 D.L.Clarke, www.nato.int/docu/basicxtxt/fnd/act-a.htm.

84 A. Cottey dhe A. Forster, fq. 21-22.

- Janë organizuar takime të rregullta ndërmjet përfaqësuesve të lartë lidhur me diskutimin e problemeve dypalëshe dhe aktiviteteve specifike.
- Diskutime për politikën e mbrojtjes dhe ristrukturimin e forcës.
- Bashkëpunim ushtarak në nivele të ulëta, si shkëmbime vizitash të ushtarakëve, njësive dhe anijeve.
- Pjesmarrja e oficerëve Rusë në kurset e trajnimit organizuar nga NATO.
- Pjesëmarrja aktive e Rosisë në stërvitjet shumëkombëshe në lidhje me operacionet humanitare, fatkeqësitë natyrore, operacionet paqeruajtëse dhe operacionet jo luftarake.
- Pjesmarrja e Rosisë nga viti 1995 – 2003 në operacionin paqeruajtës në Bosnje – Hercegovinë (SFOR) dhe në operacionin paqeruajtës në Kosovë (KFOR), 1999-2004, kanë rritur në mënyrë të ndjeshme shkëmbimin e përvojave dhe eksperiencave.
- Mbështetja që ka dhënë NATO në lidhje me tërheqjen e trupave nga Europa Lindore dhe Azia Qëndrore, si dhe trainimin dhe ri-integrimin e oficerëve të liruar.
- Mbështetja e vazhdueshme që ka dhënë NATO në sigurimin dhe reduktimin e armëve nukleare, kimike dhe bërthamore nëpërmjet programeve në kuadrin e Aleancës, programeve dy palëshe si programi i bashkëpunimit dhe asistencës me SHBA (US Nunn – Lugar).



Ministri i Jashtëm i Rusisë Lavrov “M” dhe ish-Sekretari i NATO –s Andres Fogh Rasmussen⁸⁵

Pas një periudhe 17-vjeçare bashkëpunimi, marrëdhëniet midis NATO-s dhe Rusisë ka njohur ngritje-zbritje. Rusia siç u përmend dhe më lart u bë anëtare e iniciativës së PfP, në vitin 1995. Gjatë sulmeve ajrore të NATO-s në Kosovë, udhëheqja Ruse i ndërpreu të gjitha bashkëpunimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me NATO-s. Gjatë kësaj periudhe, zyrtarë të ndryshëm të NATO-s kanë shprehur zhgënjimin e tyre për mungesën e dëshirës së Rusisë në përdorimin e mundësive si PfP-ja dhe Këshilli NATO-Rusi, për të krijuar më shumë mundësi kontakti dhe diskutimi në lidhje me problemet në fushën e mbrojtjes.⁸⁶ Vëzhgues të ndryshëm kanë konstatuar se drejtues të lartë Rus, civilë dhe ushtarakë të cilët drejtojnë dhe kontrollojnë Ministrinë e Mbrojtjes, në përgjithësi kanë treguar mungesë dëshire më qëllim

85 <https://jamestown.org/program/nato-russia-relations-post-crimea/accessed>
gjetur më 22 nëntor 2016

86 Diskutime në NATO

mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis NATO-s dhe Rusisë.⁸⁷

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes midis NATO-s dhe Rusisë nuk e ka zvogëluar ose shmangur mosmarrëveshjet midis Aleancës dhe Rusisë në lidhje me anëtarësimin e vendeve të Balltikut (Lituani – Letoni – Estoni) dhe vendeve të Ballkanit Lindor (Bullgari – Rumani) dhe njohja e Kosovës shtet i pavarur. Gjatë gjithë aktivitetëve, nga viti 1990 e deri në vitin 2016, Rusia ka kërcënuar NATO-n dhe vendet Perendimore me kthimin e të ashtëquajturës “*Lufta e Ftohtë*”. Diskutimet e fundit zhvilluara nga Presidenti Amerikan, janë një sfidë për vendet e Perendimit, në lidhje me ngritjen e disa qendrave anti-raketore në territorin e Republikës Çeke, Polonisë dhe Hungarisë, si dhe vendosjen e bazave ushtarake në Rumani dhe Bullgari. Rritja e prezencës ushtarake në Poloni, Lituani, Letoni dhe Estoni. Aneksimi i gadishullit të Krimesë nga Rusia (2014). Konflikti në Ukrainën lindore dhe lufta civile në Siri, kanë ndikuar në procesin e vendimarrjes të NATO, në mbrojtje të integritetit territorial të vendeve anëtare. Këto vendime u konkretizuan në samitin e NATO-s në Varshavë (2016). Sfidat e ndërmarra nga vendet e Perendimit, janë trajtuar dhe konsideruar nga Rusia, si probleme dhe kërcënim për marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Sipas presidentit Rus Putin, perendimi i ka kaluar vijat e gjelbërta dhe hyrë në zonën e influencës së Rusisë. Në anën tjetër, zhvillimet e fundit në Rusi, si testimi i raketave balistike ndërkontinentale, ngritja e avionëve bombardues të përdorur gjatë luftës së ftohtë, shkelja e hapësirës ajrore të Norvegjisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe vendeve të Balltikut, mund të krijojnë premisa për konflikte midis Aleancës dhe Rusisë. Pavarësisht problemeve të përmendura, bashkëpunimi midis Aleancës dhe Rusisë ka vazhduar. Në rastet kur bashkëpunimi është ndërprerë midis NATO-s dhe Rusisë, ky bashkëpunim ka vazhduar me anëtarë të tjerë të aleancës, si me Gjermaninë, Francën, Bullgarinë, Turqinë etj.

87 P. Ulrich, fq. 165-66



Stërvitje e përbashkët NATO – Rusi⁸⁸

Elementët e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes kanë qënë të suksesshme në pjesëmarrjen e Rusisë në operacionet paqeruajtëse, si në SFOR, KFOR, stërvitjet shumkombëshe në raste fatkeqësish natyrore, tërmete, asistencë për tranferimin e trupave nga Europa Lindore dhe Azia Qëndrore, trainimi dhe ri-integrimi i ish ushtrakeve në jetën civile, takimet e ndryshme në nivel të lartë etj. Njëpërmjet programeve të asistencës dhe ri-integrimit në shoqërinë civile, Gjermania, Britania e Madhe dhe SHBA kanë mbështetur Rusinë të përfundojë tërheqjen nga vendet e Europës Jug-lindore, Azia Qëndrore dhe Vendet e Balltikut. Njëpërmjet programit të Senatorëve ameriakanë Nunn dhe Lugar, SHBA-ja ka ndihmuar në mbledhjen, konservimin, ruajtjen dhe asgjesimin e mbetjeve dhe armëve nukleare në territorin e ish-BS. Pas sulmeve terroriste në Qendrën Ndërkombëtare të Biznesit në New York, bashkëpunimi me SHBA-n dhe vendet e Aleancës ishte më i mirë se kurrë. Rusia bashkëpunoj me aleatët Perendimorë gjatë sulmeve të

88 https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_124190.htm 'NATO opens Trident Juncture exercise to International Observers, gjetur më 08 gusht 2018.

NATO-s në Afganistan. Një nga mësimet bazë të nxjerrura nga ky bashkëpunim është adresimi i problemeve esenciale dhe inkurajimi i interesave të përbashkëta, krijoi dhe krijon baza të shëndosha për një bashkëpunim më afatgjatë. Këto iniciativa, si lufta kundër talebanëve në Afganistan, sjellin dhe krijojnë premisa për ndërtimin e një ambjenti sigurie konfidencial.

Nga koha e rënies së Murit të Berlinit ndikimi i diplomacisë ushtarake në marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë ka qënë në nivelet minimale të saj. Institucionet e Rusisë janë ndërtuar dhe vazhdojnë të ndërtohen mbi parimet e ish-Bs. Elementë të KGB dhe institucioneve të saj, janë aktualisht duke drejtuar vendin dhe orientuar interesat politike, ekonomike dhe ushtarake. Konflikti dhe ballafaqimi i Perëndimit (NATO + BE) dhe Rusisë për problemet si rasti i përcaktimit të Statusit Përfundimtar dhe njohja e Kosovës shtet i pavarur, situata në lidhje me programin e zhvillimit bërthamor të Iranit, aneksimi i Krimesë (2014), pjesëmarrja në luftime në lindje të Ukrainës (rajoni Donbashi) dhe mosmarrëveshjet në konfliktin në Siri, kanë çuar në shumë raste Përfundimin dhe Rusinë në konflikte dhe bllokime të procesit. Nga ana e saj, NATO nuk e konsideron Rusinë si armike të interesave të saj. Po të shohim dokumentin e strategjisë kombëtare të Rusisë dhe doktrinën ushtarake të miratuar në vitin 2000 të cilat janë të bazuara në supozimet e konflikteve midis Perëndimit të udhëhequr nga SHBA dhe Rusisë si vend i cili mbështet idenë e një bote shumëpolare.⁸⁹ Ndërsa marrëdhëniet civilo-ushtarake janë shumë larg standarteve që përcakton Aleanca.⁹⁰ Forcat e Armatosura të Rusisë janë të përfshira në zhvillimet e brendëshme. Shumë ushtarakë janë pjesëtarë dhe anëtarë të parlamenti (*Duma*). Njihen shume raste ku ushtarakët janë përdorur nga qeveria aktuale si elementë kompromentues në zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Drejtues dhe lider të lartë ushtarak njihen si mbështetës të Putinit. Shumë nga këta elementë janë dhe

89 I. Traynor, the Guardian.

90 A.A. Belkin dhe J.H. Brusstar, fq, 215-32

shprehin hapur pikpamjet e tyre kundër Perendimit dhe NATO-s. Një analist dhe vëzhgues i Rosisë, ka konkluduar se lidhja ushtarake Rus, është i përqëndruar të ndërtojë një siguri kombëtare kundër NATO-s sesa për vendin e tyre.⁹¹

Sulmet terroriste të 11 Shtatorit 2001 në SHBA rezultuan në përmirësimin e marrëdhënieve NATO – Rusi dhe sidomos me SHBA-n. Në këtë kontekst, mendohet se ish-presidenti Putin (1999-2008) kishte ndërmarrë disa hapa dhe vendime strategjike në lidhje me përmirësimin e marrëdhënieve Rusi – Perendim (NATO + BE). Këto hapa rezultuan në përmirësimin e dialogut midis NATO dhe Rosisë në mbështetjen e sulmeve kundër Talebanëve në Afganistan, tërheqjen e sistemit kundër rraketor në vendet e Balltikut, lejimin e anëtarësimit të Bullgarisë, Rumanisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Lithuanisë, Letonisë dhe Estonisë në NATO, si dhe riaktivizimin e Këshillit të Bashkëpunimit NATO-Rusi. Gjatë luftës së Gjirit, Rusia megjithëse kundërshtonte një ndërhyrje ushtarake nuk u shfaq aktive në veprimtaritë e saj.

Ndryshimet e ndodhura pas sulmeve të 11 Shtatorit hodhën baza të mira për forcimin e bashkëpunimit ushtarak. Nëpërmjet Këshillit NATO-Rusi, u miratuan një numër politikash institucionale dhe angazhimesh në luftën kundër terrorizmit. Kjo u zhvillua në kuadrin e forcimit të marrëdhënieve dhe sigurisë reciproke. Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit sot ka ndryshuar format nga ai i para ngjarjeve të vitit 2001. Marrëdhëniet NATO – Rusi në fushën e armëve kimike dhe nukleare ka marrë formë të re dhe është bazuar në formatin e bashkëpunimit të modelit të diplomacisë ushtarake. Ky bashkëpunim ka filluar të bazohet dhe konsolidohet mbi parimet e *'transparencës dhe parashikimit'* në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe strategjitë e zhvillimit të armëve nukleare. Ish-nënsekretari amerikan për politikën e mbrojtjes, Douglas Feith, theksonte se SHAB-a ka si qëllim të zhvilloi më shumë marrëdhëniet e bashkëpunimit në lidhje me shkëmbimin rregullisht të

91 D. Trenin, fq.21

informacionit, siç bëhet me rastet e shkëmbimit të informacionit me aleatët tanë.⁹² Kjo do të krijonte ngritjen e sistemeve të transparencës midis Perëndimit dhe Rusisë. Këto sisteme kërkojnë zhvillimin dhe konsolidimin e elementëve përbërës të diplomacisë ushtarake dhe demokracisë në vend. Konsolidimi i tyre hap rrugën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit. Zvogëlon rreziqet dhe rrit sigurinë rajonale dhe globale. Në shumë raste sisteme të tilla ndërtohen ose konsolidohen nga elita politike dhe ushtarake të cilat kanë vizion dhe dëshirë për paqe, siguri dhe mirëkuptim. Sistemet të cilat e bazojnë aktivitetin dhe veprimtarinë e tyre mbi elementët jo demokraticë janë të prirura të krijojnë pasiguri, probleme dhe konflikte midis shteteve. Në këtë kontekst, Rusia në shumë raste ka dështuar, pasi e bazon dhe ndërton sistemin e saj në bashkëpunim me vendet e Perëndimit mbi frymën e monopoleve shtetërore të dyshimta, grupeve të përfshira në trafikë të paligjshme dhe në idenë e saj për një botë shumpolare. Duke parë situatën aktuale, për vendet e perëndimit, diplomacia ushtarake do të mbetet e rëndësishme – nese do të ketë probleme – si pjesë e pandarë e NATO-s në ndërtimin e një partneriteti afatgjatë me Rusinë.⁹³

Ky partneritet kërkon besim reciprok, angazhim dy e shumëpalës, si dhe dëshirë për ndryshim dhe progres. Por nuk ndodh gjithmonë kështu. Për shembull, situata aktuale në Siri është shumë e vështirë, kaotike, pa prespektive dhe dëshirë për zgjidhje. Të gjithë kërkojnë të jenë pjesë e realitetit, për mirë ose për keq. Të gjithë flasin për ndryshim rregjimi, humbje jetës, rreziku i emigracionit dhe elementëve terrorist, ekzistenca e ISIS/ISIL dhe rezikun që ajo paraqet. Por në fakt shumë pak është bërë. Rusia dëshiron ta ndihmojë mikun e vjetër Bashar al-Asad, me qëllim sigurimin e prezencës dhe zonave të influencës në lindjen e mesme dhe pellgun e mesdheut.

92 www.defenselink.mil/news/Jan2002/t01162002_t0116fb.html

93 A. Cottey dhe A. Forster, fq. 24

Situata në Siri, ka krijuar një afmosferë mosbesimi dhe mosangazhimi midis perëndimit dhe Rusisë. Elementët e diplomacisë kombëtare dhe ushtarake nuk po japin efektet e pritshme. Marrëveshjet e nënshkurara dhe takimet e zhvilluara nuk kanë dhënë efektet e duhara. Popullsia në terret po vuan te gjitha pasojat. Ndërsa, për komunitetin ndërkombëtare ngelet vetëm të veprojë. Por situata është e vështirë. Kjo mund të çojë në përplasje midis fuqive të mëdha ose NATOs me Rusinë.

2.3 Bashkpunimi ushtarak SHBA – Kinë

Gjatë dy dekadave të fundit zhvillimet në RP të Kinës kanë shkaktuar debate në lidhje me zhvillimet ekonomike, politike dhe ushtarake. Kina ka filluar të konsiderohet si një nga vendet me zhvillimin më të madh ekonomik që ka njohur ndonjëherë bota. Sipas 'Traiding Economics', për vitin 2016 rritja ekonomike prashikohej të ishte deri në 6.7 % e GDP-s.⁹⁴

Ky zhvillim nuk është vetëm në fushën ekonomike por edhe në atë politike. Pjesëmarrja në organizata të ndryshme si OKB-ja, anëtare e përhershme e këshillit të sigurimit, Komiteti i Bashkëpunimit të Shangait (*Shih shtojçën No. 3*), Organizatës Botërore të Tregtisë, ka rritur rolin dhe rëndësinë e Kinës në fushën politike. Bashkëpunimi me SHBA, Koren e Veriut, Japoninë dhe diskutimet në lidhje me çështjen e Taivanit dhe pretendimet në detin e Kinës Jugore, e kanë rritur ndjeshëm rolin dhe rëndësinë e saj si faktor në rajonin Aziatik.

Zhvillimet ekonomike dhe politike nuk kanë lënë jashtë vëmendjes dhe zhvillimet në fushën ushtarake. Forcat e Armatosura të këtij vëndi kanë arritur të testojnë dhe lëshojnë në hapësirë satelitë dhe raketat balistike ndërkontinentale. Kjo tregon për forcimin dhe

94 <http://www.tradingeconomics.com/china/gdp-growth-annual>, gjetur më 29 nëntor 2016.

konsolidimin e komponentit ushtarak. Ndryshimet e vrushme në fushën ekonomike, politike dhe ushtarake i *'detyruan'* në një far mënyre SHBA-t të përcaktonin në politikat e tyre të bashkëpunimit ndërtimin e marrëdhënieve me Kinën. Në vitin 1970, Richard Nixon dhe Henry Kissinger filluan ta shikonin hapjen/afrimin drejt Kinës, si mjet i largimit të SHBA-s nga Vietnami dhe krijimin e një balance strategjike kundër fuqisë globale Sovjetike.⁹⁵ Ky bashkëpunim erdhi si vazhdim i njohjes nga Amerika të RP të Kinës në vitin 1979. Në atë kohë, SHBA-t iniciuan bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes si pjesë të normalizimit me Pekinin.⁹⁶ Në fund të viteve 70 dhe fillimin e viteve 80 një numër civilësh drejtues të administratës së Carter-it dhe Regan-it mbështetën bashkëpunimin në fushën e zbulimit dhe shitjeve të armëve Kinës, si mjet në rritjen e presionit mbi BS. Marrëdhëniet SHBA – Kinë nuk kanë qënë gjithmonë në nivelet e duhura. Për shembull, në përgjigje të veprimeve dhe ngjarjeve të ndodhura në vitin 1989, në shëshin Tiananmen kundër lëvizjes studentore, SHBA-t ndaluan të gjitha format e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, si dhe shitjen e armëve dhe teknologjisë. Kontaktet politike dhe ushtarake u riaktivizuan gradualisht në fillimin e viteve 1990.⁹⁷

Duke analizuar dhe komentuar marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve do të vërejmë se Administrata e Presidentit Clinton në politikën e saj kundrejt RP të Kinës ka reflektuar tensione. Mosmarrëveshjet midis dy vendeve janë; respektimi i të drejtave të njeriut dhe çështja e Taivanit. Problemet dhe zhvillimet në marrëdhëniet midis dy vendeve e orientuan Administratën e Presidentit Clintonit të zhvillonte në mënyrë graduale politikën e *'angazhimit të gjithanshëm'*, e cila kulmoi me takimin e Presidentit Clinton dhe Presidentit Kinez Jiang Zemin në SHBA në vitin 1997. Diplomacia ushtarake e zhvilluar në këtë periudhë nga administrata Clinton, përdori filozofinë e përfshirjes në marrëdhëniet

95 Jame J. Przystup dhe Pihillip C. Saunders, fq 33

96 www.state.gov/r/pa/bgn/2742.htm

97 D. Shambaugh, fq.113

në fushën e mbrojtjes me Kinën, por këto marrëdhënie u zhvilluan me hapa të ngadalshëm dhe me probleme, mosmarrëveshje dhe përçarje.⁹⁸ Këto probleme dhe mosmarrëveshje kanë shoqëruar nivelet më të larta politike dhe ushtarake. 'Sekretari Amerikan i Mbrojtjes William Perry nuk zhvilloi vizitën e planifikuar në Kinë në Tetor të vitit 1994'. Me të njëjtën monedhë ju përgjigj dhe homologu Kinez Gjenerali Chi Haotian, i cili e shtyu vizitën deri në fund të vitit 1996, për arsye të mosmarrëveshjeve në lidhje me Taivanin'.⁹⁹ Por kjo nuk do të ishte i vetmi problem në marrëdhëniet SHBA-Kinë. Diplomacia ushtarake ka vepruar me hope dhe pa ndonjë ndikim të madh deri në fillimin e bombardimeve në ish-Jugosllavinë (Serbi). Bombardimi i Ambasadës Kineze gjatë fushatës së NATO-s, e detyroi 'Kinën të ndalonte çdo bashkëpunim në fushën e mbrojtjes me SHBA-n dhe marrëdhëniet filluan të normalizoheshin vetëm në vitin 2000'.¹⁰⁰

Me ndryshimet e reja politike në SHBA dhe ardhjen e administratës së Presidentit George W. Bush, mosmarrëveshjet në fushën e mbrojtjes u kushtëzuan mbi zbatimin e disa elementëve të rij, si zbatimi i të drejtave të njeriut, kontrollit të armëve kimike dhe biologjike. SHBA-ja e shikon Kinën si një nga konkurentët strategjik në Azi. Marrëdhëniet midis dy vendeve nuk kanë njohur vetëm konflikte por ato kanë njohur edhe periudha bashkëpunimi. Gazeta Ushtria Çlirimtare organ i Ushtrisë Popullore Çlirimtare të Kinës (PLA) përmbledhonte disa nga karakteristikat e diplomacisë ushtarake të Kinës për vitin 2005, ku theksonte se: 'diplomacia ushtarake po bëhet më "aktive" dhe më "pragmatike".¹⁰¹ Në tetor të viti 2005, Sekretari Amerikan i Mbrojtjes Donald Rumsfeld zhvilloi në Kinë vizitën e tij të parë që nga marrja e postit në vitin 2001. Gjatë vizitës dhe takimeve me personalitetet

98 A. Cottey dhe A. Forster, fq. 24-25

99 Carter dhe Perry, fq.94-95

100 D. Shambaugh, fq.101, 107-114.

101 http://www.chinadaily.com.cn/english/doc/2005-12/29/content_507781.htm

Kineze, gazetatat dhe mediat e ndryshme komentonin se 'vizita e Z. Rumsfeld është shumë e rëndësishme me qëllim rritjen e besimit të dyanshëm dhe nivelin e marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes midis Gadishullit të Sino dhe SHBA-ve. Në këto takime të dyja palët ranë dakort në forcimin e bashkpunimit nëpërmjet edukimit në fushën akademike, shkëmbimit të vizitave dypalëshe dhe vizitave të anijeve të flotave respektive detare'.¹⁰²

Megjithatë, gjatë presidencës së Zotit Obama, marrëdhëniet midis SHBA-ve dhe Kinës, kanë njohur ngritje dhe zbriktje. Li thekson se gjatë 8-viteve të administratës Obama, marrëdhëniet midis dy vendeve kanë kaluar nëpër: (1) njohjes personale; (2) situatat e brendëshme në të dy vendet; (3) ndryshimet politike dhe ekonomike në nivel rajonal dhe global dhe (4) faktorë të tjerë.¹⁰³

Në anën tjetër Kina është një fuqi në rritje. Aktualisht është ekonomia e dytë më e madhe në botë. Kjo i ka dhënë Kinës një vend të rëndësishëm në rajonin e Azisë por edhe në botë. Marrëdhëniet midis SHBA-ve dhe Kinës kanë njohur rritje pro edhe mosmarrëveshje. Rritje për sa i përket bashkëpunimit ekonomik, shkëmbimit tregtar, investimeve reciproke dhe transferimit të teknologjisë. Ndërsa, aspiratat për zgjerim në detin e Kinës lindore dhe jugore janë bërë burim konflikti dhe mosmarrëveshje.

Ndërsa presidenti i zgjedhur Donald Trump gjatë fushatës presidenciale ka akuzuar Kinën, për mungesë sinqeriteti në shkëmbimet tregtare. Ai ka akuzuar dhe kritikuar rolin e Kinës në detin e Kinës Jugore dhe përfshirjen e saj në sulmet kibernetikë kundër interesave të SHBA-ve.

102 Karl K. Schonberg, fq. 70

103 Cheng Li, 2016.



Presidenti i Shteteve të Bashkuara (M) Zoti Barak Obama (2009 – 2017) dhe Presidenti i Kinës Xi Jinping, gjatë një takimi në Hangzhou, 03 shtator 2016.¹⁰⁴

Për shembull, sulmet terroriste kundër Amerikës më 11 Shtator 2001 sollën disa përmirësime në marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve. Por le të shikojmë dhe konstatojmë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin SHBA – Kinë në fushën e mbrojtjes që nga viti 1990:¹⁰⁵

- Diskutime në nivelin më të lartë politik, përfshirë vizitat reciproke të Ministrave të Mbrojtjes, Zv/Ministrave të Mbrojtjes dhe zyrtarëve të tjerë të lartë, konsultimet Vjetore për Mbrojtjen, iniciuara në dhjetor 1997 dhe prezantimi i brifingjeve të transparencës midis Forcave të Armatosura të RP të Kinës dhe Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-s.
- Shkëmbimi i vizitave në nivelet e larta ushtarake, përfshirë vizitat e ushtarakëve me grada të larta në instalimet e pavizituara më parë në Kinë.

104 <http://edition.cnn.com/2016/09/02/politics/obama-asia-meetings-xi-erdogan-duterte/> accessed on 29 November 2016.

105 www.defenselink.mil/pubs/easr98/easr98.pdf, ff.6, 30-34 dhe 64-65

- Shkëmbim vizitash të personelit të institucioneve arsimore ushtarake, për shembull shkëmbimet midis dy universiteteve të mbrojtjes të dy vendeve.
- Në vitin 1998 u miratua dhe filloi të funksiononte Marrëveshja e Konsultimeve Ushtarake Detare për të parandaluar incidentet në det, e cila krijoi mundësinë e takimit të grupeve të punës në zbatimin e kësaj marrëveshje.
- Vizita reciproke të anijeve luftarake në vendet respektive.
- Diskutimi i afërimit të ndihmës në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe fatkeqësive natyrore.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për vëzhgimin e stërvitjeve ushtarake.
- Nënshkrimin e marrëveshjes (gjatë vizitës së Presidentit Klinton në vitin 1998) për 'shkatërrimin' e armëve bërthamore.

Duke parë dhe analizuar pikat dhe fushat e diplomacisë ushtarake të ndjekura nga SHBA në marrëdhënie me RP të Kinës do të ndalesha dhe identifikoja disa aspekte dhe elementë kryesore të diplomacisë ushtarake sipas Pekinit.

Ministria e Mbrojtjes e RP të Kinës e ka përqëndruar rolin e diplomacisë ushtarake në mbështetjen e fushatave diplomatike dhe rritjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. Sot Kina zhvillon shkëmbime në të gjitha nivelet përfshirë ato ushtarake dhe civile:¹⁰⁶

Fushat ku përqëndrohet diplomacia ushtarake sipas RP të Kinës.

- Drejtimi i konsultimeve strategjike
- Ndërtimi i dialogut në fushën e mbrojtjes me 20-vende, duke përfshirë SHBA-n dhe Filipinet.
- Pjesëmarrja në forumet rajonale dhe globale, si OKB, dialogu NATO-Kinë¹⁰⁷, ASEAN etj.

106 <http://209.85.129.104/search?q=cache:8GCEPvMwOC4J:chinaabc.showchian.org/chinaa...> 2007-03-28

107 Prof. F. Luccioly, leksione, KLSM 2007 (Ky dialog është i pa institucionalizuar)

- Stërvitjet e përbashkëta
- Bashkëpunimi dypalësh dhe asistenca në ndërtimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura të RP të Kinës.
- Pjesëmarrja dhe kontributi në rastet e fatkeqësive natyrore, si Cunami 2005 etj.
- Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare në fushën e armëkontrollit dhe minave kundër personel dhe kundërtanke.

Duke parë dhe analizuar bashkëpunimin ushtarak në kuadrin e rritjes së efekteve të diplomacisë ushtarake në marrëdhëniet midis dy vendeve shohim se në krahasim me Rusinë, marrëdhëniet midis SHBA dhe Kinës në fushën e mbrojtjes, janë më të pakta në natyrën dhe numrin e aktiviteteve'.¹⁰⁸ Nga informacioni dhe planet e bashkëpunimit midis dy vendeve ka pasur pak shkëmbime në nivelet e zyrtarëve të lartë në fushën e mbrojtjes. Sekretari Amerikan i mbrojtjes William Perry thekson se nuk ka shumë hapësira për të zhvilluar një marrëdhënie të qëndrueshme siç kam bërë në takime të shumëta me Ministrin e Mbrojtjes të Rusisë Pavel Grachev'.¹⁰⁹ Kontaktet midis ushtarakëve Rusë dhe atyre nga vendet anëtare të NATO-s, janë intensifikuar, ndërsa marrëdhëniet dhe kontaktet midis ushtarakëve Kinezë dhe atyre perendimore janë të limituara. Unë do të kujtoja këtu vetëm disa raste sporadike të kontakteve të ushtarakëve kinezë me ata perendimorë. Për shembull, pjesëmarrja e tyre në disa kurse të organizuara nga Universiteti i Krenfieldit në Angli. Në kundërshtim nga kjo, Profesor Luccoli komenton se janë hedhur bazat e takimit në nivele të larta midis lidhshpimit drejtues civil dhe ushtarak të NATO dhe Kinës. Kjo vërtetohet me takimin e mbajtur në muajin Tetor 2007 në Palermo, Itali midis NATO-s dhe Kinës. Ndërsa kontaktet e SHBA-s, NATO-s me Rusinë janë shtrirë në të gjitha nivelet. Këtu bie në sy bashkëpunimi në operacionet paqeruajtëse SFOR dhe KFOR, krijimi i Komitetit

108 A. Cottey dhe A. Forster, fq. 26

109 www.defenselink.mil/pubs/easr98/easr98.pdf.pp.6

NATO – Rusi, bashkëpunimi me NATO-n dhe konkretisht me SHBA-n në luftën kundër terrorizmit, pas ngjarjeve të 11 Shtatorit.

Marrëdhëniet e kufizuara SHBA – Kinë kanë reflektuar një numër problemesh. Në shumë raste marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve janë karakterizuar nga ngritje-zbritje, duke filluar nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve nuk është reflektuar në dokumentat strategjik siç ka ndodhur me Rusinë. Prezenca amerikane në Azi (Filipine, Yzbekistan etj), çështja e Taivanit, roli i Kinës si eksportuese e armëve, problemet dhe konfliktet në detin e Kinës Jugore, kanë ndikuar në zgjerimin dhe intensifikimin e marrëdhënieve. Sistemi komunist i qeverisjes dhe mosdëshira e palës kineze kanë ndikuar në 'mungesën e transparencës dhe reciprocitetit nga qeveria e Pekinit'.¹¹⁰

Duke parë dhe analizuar ecurinë e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes mund të arrijmë në disa konkluzione. *Së pari*, bashkëpunimi me Rusinë në shumë raste nuk i ka kapërcyer ndryshimet e theksuara politike. *Së dyti*, Pekini dhe Uashingtoni e shikojnë njëri-tjetrin si kërcënim dhe kjo në mënyrë të pashmangshme ndikon në marrëdhëniet dypalëshe. *Së treti*, Forcat e Armatosura të RP të Kinës shprehin mungesë dëshire në mundësimin e informacionit në lidhje me politikat e mbrojtjes ose hyrjen në ambjentet ushtarake, organizimin e aktiviteteve dypalëshe dhe shumëpalëshe të cilat kërkojnë një nivel të lartë transparence.

Në kundërshtim me problemet e theksuara më lart, SHBA-ja përpiqet të ftojë dhe përfshijë Forcat e Armatosura të RP të Kinës në disa aktivitete të zhvilluara në dekadën e fundit. Vetë vizitat e Presidentëve Kinez dhe Amerikan në vendet respektive, vizita e Sekretarit mbrojtjes, tregojnë për krijimin e disa hapave konkrete të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. *Se pari*, progresi i bërë nga Kina është i ngadaltë por duhet vlerësuar dhe theksuar publikimi në vitin 1998 të Librit të Bardhë. *Së dyti*, Kina merr pjesë në një numër aktiviteteve të organizuara nga organizata të tilla si Organizata e Bashkëpunimit

110 D. Shanbaught, fq. 110

Rajonal të Shangait, ASEAN-i, stërvitjet trepalëshe Kinë-Indi-Pakistan etj. *Së treti*, pjesëmarrja e Kinës në organizatat si; Ndalimi i Përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë, Kontrolli i Regjimit të Teknologjisë së Raketave, Firmosja e konventës për Armët Kimike, Kontrolli dhe Eksportimi i Teknologjive Ushtarake jashtë territorit të origjinës. *Së fundmi*, “angazhimi i diplomacisë ushtarake Amerikane është përpjekur të ndihmojë parandalimin e problemeve të mësipërme. Në këtë kontekst, diplomacia ushtarake do të mbetet elementi i cili ndihmon dhe mbështet përpjekjet Amerikane në inkurajimin e Kinën drejt partneritetit në vënd të konkurrencës.”¹¹¹

2.4 Përfundime

Ky kapitull pati si qëllim shpjegimin dhe analizimin e diplomacisë ushtarake në vendet anëtare të NATO-s dhe PFP-s si mjet në parandalimin e konflikteve, ndërtimin e besimit dhe krijimin e bashkëpunimit nëpërmjet programeve të ndryshme midis ish-kundërshtarëve. Diplomacia mund të kontribuojë në parandalimin e konflikteve në një numër formash: duke përdorur dhe zhvilluar format e bashkëpunimit midis kombeve, promovimin e transparencës në fushën e mbrojtjes dhe reduktimin e keqkuptimeve, promovimin dhe familjarizimin e ushtarakëve në lidhje me bashkëpunimin dhe sqarimin për rëndësinë e interesave të përbashkëta në fushën e sigurisë, politikës, ekonomisë dhe mbrojtjes. Forcimi dhe konsolidimi i këtyre iniciativave do të kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve midis vendeve, nëse ne ndjekim dhe zbatojmë në aktivitetin tonë porosinë e ish-presidentit të Koresë së Jugut Kim Dae Jung në zhvillimin e “*politikave rrezatuesel ndiçuese*” (sunshine policy), atëherë ne do të fillojmë të kemi rezultate në forcimin e besimit dhe transparencës midis kombeve.”¹¹²

111 A. Cottey dhe A. Forster, fq. 27

112 D. S. Reveron, fq. 84

Gjatë dekadave të fundit, elementi dhe shembulli më i spikatur i diplomacisë ushtarake, si mjet i angazhimeve strategjike ka qënë ndërtimi i marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes me Rusinë dhe Kinën. Vendet Perendimore po vazhdojnë dhe konsolidojnë përdorimin e diplomacisë ushtarake me të dy vendet, si element i rëndësishëm në përpjekjet e tyre në ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe parandalimin e konflikteve.

Përdorimi i diplomacisë ushtarake si mjet në parandalimin e konflikteve nuk është një element i kufizuar i fuqisë së marrëdhënieve midis dy ose më shumë vendeve. Çdo ditë e më shumë vendet po e përdorin diplomacinë ushtarake si mjet në parandalimin e konflikteve. Në *Europë*, vendet e Balltikut duhet të inkurajohen nga NATO dhe BE-ja të përdorin diplomacinë ushtarake në përmirësimin e marrëdhënieve me Rusinë. Në *Lindjen e Mesme*, në shumë raste diplomacia ushtarake ka dështuar të ndërtojë marrëdhëniet dhe parandaloi konfliktet midis Arabëve dhe Izraelitëve. Në *Ballkan*, bashkëpunime në kuadrin rajonal si; US – Adriatic Charter 5 (Shqipëri, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina), SEDM, marrëveshje nga më të ndryshmet dy dhe shumë palëshe, sjellin dhe promovojnë vlerat individuale dhe kolektive të vendeve në fushën e mbrojtjes, krijojnë urat e bashkëpunimit, reduktojnë në maksimum keqkuptimet dhe rrisin sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perendimor.

Rasti i Rusisë dhe Kinës na prezanton Diplomacinë Ushtarake, si element parandalues i konflikteve, i cili varet nga marrëdhëniet politike midis vendeve të interesuara. Diplomacia ushtarake nuk është në gjëndje të kontribuojë vetëm në ato raste, kur midis vendeve ka probleme dhe dallime të theksuara. Suksesi i diplomacisë ushtarake mund të jetë pjesërisht i varur në vlerat e brendëshme të vendit. Në situata dhe kushte të tilla diplomacia ushtarake mund të ndihmojë dhe shpjegojë pse është arritur, për shembull, progresi në marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes ndërmjet NATO-Rusi dhe SHBA-Kinë. Diplomacia ushtarake mund të ndihmojë në reduktimin e keqkuptimeve dhe

mosbesimit edhe në ato raste kur ka qëndrime të ndryshme politike. Në termat afatgjatë, ajo mund të luaj rol akoma më pozitiv në hapjen e rrugëve dhe shmangien e qëndrimeve të ndryshme politike.

Në rastet e Rusisë dhe Kinës, diplomacia ushtarake, duhet të shihet si element me efekte pozitive në termat afatgjata dhe jo si element i cili mund të prodhoi rezultate pozitive dhe të shpejta në kohë. Mosmarrëveshjet, qëndrimet e ndryshme politike dhe konfliktet, në shumë raste është e vështirë t'i zgjidhësh dhe presësh rezultate pozitiv.

Forcave të Armatosura duhen inkurajuar në ndërtimin e strukturave transparente dhe të ndërvepruese me aleatët në rastet e fatkeqësive natyrore dhe luftës kundër terrorizmit. NATO në doktrinat dhe konceptet e veprimit objektivat e mësipërm i konsideron objektiva në termat afatgjata. Ne do të gabonim nëse hartonim një plan aktiviteteve me qëllim arritjen e rezultateve pozitive në termat afat shkurtëra, duke aplikuar elementë të veçantë të diplomacisë ushtarake. Aplikimi i elementëve të diplomacisë ushtarake mund të ndodhë vetëm në ato raste kur elementët e “*vjetër*” në drejtimin e shtetit, janë zëvendësuar nga elementët e “*rinj*” në krye të shtetit.

Si përfundim, në mund të arrijmë në disa konkluzione konkrete se si diplomacia ushtarake mund të përdoret si element në parandalimin e konflikteve. Vendet anëtare të Aleancës dhe rajonit të Ballkanit, duhet t'a vënë theksin tek bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh. Ndërtimi i një bashkëpunimi funksional bazuar në projekte substanciale, mund të mundësojë një bashkëpunim më konkret dhe afatgjatë. Bashkëpunime të tilla mund të rrisin dhe mundësojnë zbatimin e elementëve specifik të diplomacisë ushtarake. Drejtuesit civilë dhe ushtarakë duhet ta mbështesin procesin dhe zbatimin e elementëve të diplomacisë. Në mbyllje, diplomacia ushtarake duhet shikuar si element i cili mund të përfshihet dhe zbatohet në prandalimin e konflikteve, nëse kjo shqyrtohet dhe planizohet, si pjesë përbërëse e strategjive në ndërtimin e formave të bashkëpunimit.

3. Diplomacia Ushtarake në FA të Republikës së Shqipërisë

Diplomacia ushtarake mund të quhet art ose praktikë në ndërtimin dhe forcimin e marrëdhënieve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Ajo për shumë kohë ka qënë pjesë e rëndësishme e diplomacisë ndërkombëtare dhe me ndikim në parashikimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumpalëshe. Për shembull, bashkëpunimi në fushën e arsimit është një nga komponentët kryesore të diplomacisë ushtarake dhe ndihmon në krijimin e marrëdhënieve të ngushta me vende të ndryshme. Ky lloj bashkëpunimi ndikon në forcimin e marrëdhënieve në fushën e sigurisë dhe adreson problemet e përbashkëta në këtë fushë.

Forcat e Armatosura të Shqipërisë gjatë 10-viteve të fundit kanë arritur një përvojë të konsiderueshme në fushën e veprimeve operacionale në BiH, Afganistan, Irak, Gjeorgji, Çad dhe republikën e Afrikës Qëndrore. Përvojat e fituara mund të shfrytëzohen dhe përdoren në aktivitetet e organizuara në fushën e arsimit, me qëllim ndërtimin e marrëdhënieve të ngushta me përfitim reciprok midis ushtarakëve.

Kapitulli në vazhdim do të analizojë dhe komentojë një numër arritjesh dhe aktivitetesh të zhvilluara nga FA të Shqipërisë në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe arsimit. Aktivitete të tilla si, Procesi i Ministerialit të Europës Jug-lindore, SEEBRIG, US – Adriatic Charter 5, Bashkëpunimi i vendeve të Detit Adriatik dhe Jon, arsimimi në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe armë-kontrollit ndihmojnë në

forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe rritjen e besimit. Diskutimi dhe analizimi i prioriteteve strategjike do të analizoi hapat që Shqipëria ka bërë nga njëri samit i NATO-s në tjetrin. Këto stacione do të jenë burime verifikimi për objektivat dhe arritjet e diplomacisë ushtarake, në aspektin e bashkëpunimit dypalësh, shumëpalësh dhe rajonal. Partneriteti me NATO-n dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse do të bëjnë evidentimin e aktorëve të përfshirë në këtë proces dhe kushtet e reja të sigurisë dhe mbrojtjes në të cilën sot vepron diplomacia ushtarake.

3.1 Prioritetet strategjike të diplomacisë ushtarake

Shqipëria ka një histori të gjatë dhe të suksesshme në lidhje me aktivitetet që Forcat e Armatosura kanë zhvilluar dhe pa frikë mund t'i vendosim të gjitha nën ombrellën e diplomacisë ushtarake. Diplomacia ushtarake është përcaktuar nga dokumenti i strategjisë së sigurimit kombëtare, element i sigurisë dhe politikës së mbrojtjes.¹¹³ Ky dokument ka identifikuar qartazi prioritetet strategjike të Shqipërisë. Integrimi i plotë në Strukturat Euro-Atlantike mbetet objektivi kryesor i cili lidhet me garantimin e sigurisë në vend.¹¹⁴ Objektivat e përcaktuara nga FA dhe miratuar nga Parlamenti, janë reflektuar qartazi në programin e qeverisë të Shqipërisë dhe planin afatgjatë të zhvillimit të forcës, theksohet se; integrimi i plotë në strukturat Euro-Atlantike është objektivi parësor i politikës së jashtme të vendit.¹¹⁵

Aktivitetet në fushën e mbrojtjes, objektivat e përcaktuara nga Strategjia e Sigurimit Kombëtarë dhe programi i qeverisë Shqiptare, kanë dhënë

113 SSK, FA të Shqipërisë, fq 4-5

114 Po Aty

115 Programi i zhvillimit të Qeverisë Shqiptare, 2015-2025.

një kontribut pozitiv në ndërtimin e kulturave strategjike integruese të civilëve dhe individëve në uniformë në strukturat Euro-Atlantike. Ky proces i vazhdueshëm dhe transparent përcakton dhe konsolidon bazat e rolit të diplomacisë ushtarake, si pjesë integrale e politikës së jashtme të Shqipërisë, zhvilluar dhe drejtuar nga ushtarakët.

Gjatë 15-viteve të fundit, Forcat e Armatosura kanë zhvilluar një numër të madh aktiviteteve në fushën e mbrojtjes. Në pamje të parë, Shqipëria nga një vend konsumues sigurie është transformuar totalisht në një vend prodhues dhe eksportues i sigurisë dhe diplomacisë në fushën e mbrojtjes, jo vetëm në rajon por dhe më gjërë. Në të gjitha etapat e zhvillimit të vendit dhe rajonit, Shqipëria ka luajtur dhe vazhdon të luaj rol promovues dhe progresiv në krijimin e një klime të favorshme sigurie dhe bashkëpunimi.

Angazhimet dhe kontributi në rritjen e bashkëpunimit dypalëshe dhe shumëpalësh me NATO, shkëmbimi i informacioneve me trupat e Aleancës dhe partnere në Mesdhe, kanë krijuar një bazë dhe kulturë të re rreth diplomacia ushtarake. Në këtë kuadër, studiuesi Bullgar Valeri Ratchev në artikullin e tij analizon se diplomacia për një numër të madhe civilësh, ushtarakësh, diplomatësh krijoi dhe rilindi thënien, se diplomacia po del në vijën e parë të mbrojtjes dhe mbrojtja po mbetet e fundit.¹¹⁶

Rruga e reformave dhe rritja e bashkëpunimit me vendet e tjera të NATO-s, është identifikuar dhe përcaktuar qartazi nëpërmjet *dokumentave kombëtarë*, si Kushtetuta e Republikës, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritimit dhe Planizimi i Sistemit të Integruar. Në nivel institucional, Direktiva e Ministrisë të Mbrojtjes, Strategjia Ushtarake, Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe Udhëzuesi i Planizimit dhe Programimit të SHP, kanë rol themelor dhe të rëndësishëm në zhvillimin dhe konsolidimin e elementëve të diplomacisë ushtarake në proceset e integritimit.

116 V. Ratchev, fq.57.

Pjesmarrja jonë në projektet, programet e bashkëpunimi dhe marrëveshjet e ndryshme, ka mundësuar një numër përfitimesh në fushën e asistencës, menaxhimit dhe planizimit të forcës, mësimin e gjuhës angleze, përmirësimin e teknologjisë ushtarake, trajnimin e personelit ushtarake dhe civil në Forcat e Armatosura. Aktivitetet e ndryshme dhe kontaktet me partnerët janë zhvilluar dhe bazohen në parimet e reciprocitetit dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë. Eksperiencat e akumuluar në fushën e bashkëpunimit, riorganizimit dhe ristrukturimit të Forcave të Armatosura, konsiderohet si një nga sukseset dhe vlerat më pozitive në zhvillimet demokratike në Shqipëri. Eksperiencat dhe përvojat e fituara mund të shërbejnë dhe kontribuojnë në të ardhmen, në konsolidimin dhe rritjen e rolit të diplomacisë ushtarake.

Konfliktet e shkuara rajonale, trafiqet e paligjshme, lufta kundër terrorizmit janë elementë kërcënues të sigurisë rajonale. Në anën tjetër, anëtarësimi i një numëri vendesh nga rajoni në NATO dhe BE, kanë krijuar një mjedis dhe ambjent të favorshëm sigurie për Shqipërinë. Në këtë kontekst, Shqipëria duhet të rishikojë dhe rivlerësojë rolin dhe kontributin që duhet të japë diplomacia ushtarake, si anëtare aktive e NATO-s.

Në planet afatmesme dhe afatgjatë është theksuar së Forcat e Armatosura nuk do të kenë më objekt kryesor vetëm mbrojtjen e integritetit teritorial të vendi por krijimin e një force të vogël dhe të ndërveprueshme me aleatët tanë në NATO, në parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizave. Modernizimi dhe përgatitja e personelit ushtarak dhe civil do të afroji edhe më shumë vendin tonë në plotësimin e objektivave në strukturat Euro-Atlantike.

Në aspektin rajonal, diplomacia ushtarake duhet të luaj rol në forcimin e dialogut dhe rritjen e sigurisë. Sot më shumë se kurrë, ushtarakët mund të luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e paqes dhe dialogut në kundërshtim me krijimin e një klime konfliktuale. Kjo thotë Ratchev

krijon mundësinë e të punuarit së bashku në anashkalimin e pengesave dhe zhvillimin e komunikimit midis politikbërësve, drejtuesve të lartë ushtarak dhe pjesëtarëve të tjerë të forcave të armatosura, me qëllim rritjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit.¹¹⁷ Në kontekstin dhe kuadrin e bashkëpunimit rajonal, ish komandanti i komandës amerikane në pacifik në vitin 1998 Admirali William J. Crower, mbas një eksperience të gjatë do të konkludonte dhe thekson se; të jesh sa më konkret në krijimin e raporteve të drejta, unë thekson komandanti, bëra një hap prapa në përpjekjet e mia dhe u përqëndrova në rajon më një sy më objektiv.¹¹⁸

Bashkëpunimi rajonal dhe integrimi i plotë në strukturat euro-atlantike, garanton vlera fundamentale dhe jetike si liria e të shprehurit, paqa, siguria, demokracia, respektimi i pronës private, ekonomia e tregut, funksionimi i shtetit të se drejtës, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi dhe forcimi i një shoqërie të hapur dhe demokratike dhe forcimi i kontrollit civil mbi forcat e armatosura.¹¹⁹ Ndërtimi dhe studimi i urave të palekundëshme (*sturdy bridge*)¹²⁰ dhe vlerave fundamentale të sistemeve demokratike të bashkëpunimit midis partnereve dhe vendeve të rajonit, promovon paqen, lirinë dhe rrit klimën e mirëbesimit.

Anëtarësimi i plotë i Shqipërisë në NATO ballafaqon vendin me sfidat dhe detyrimet e mjedisit të brendëshëm të Aleancës. Sa efektiv është roli i saj në NATO dhe sa do të ndikoj anëtarësimi në stabilitetin e metejshëm në rajonin e Ballkanit Perendimorë? Cili është roli në procesin e SEDM, US – Adriatic Charter 5, si dhe pjesëmarrja në luftën kundër terrorizmit dhe trafikëve të paligjshme?

Ballafaqimi i Shqipërisë me sfidat dhe detyrimet në fushën e sigurisë

117 Po Aty

118 D. S. Reveron, fq. 73

119 Po Aty, fq 79

120 Po Aty, fq 83

dhe mbrojtjes, kërkon mbështetje dhe vëmendje të strukturave drejtuese dhe opinionit publik. Mbështetja në veprimtarinë e forcave të armatosura përkthehet; mbështetje, negociim dhe ndikim i opinionit publik në proceset integruese në formimin e politikave kombëtare të përfaqësura në strukturat euro-atlantike. Proçesi i integritit të plotë në strukturat e NATO-s, përmbledh pikat e marrëdhënieve ndërkombëtare në raport me diplomacinë kombëtare ... kultivimi/krijimi dhe analizimi nga institucionet qeveritare i opinionit publik, në lidhje me forcat e armatosura, ndërlidhja e interesave të një grupi në një vend të caktuar, me interesat e një grupi në një vend tjetër ... transferimi ndërkombëtar i ideve dhe njohurive,¹²¹ gjatë pjesëmarrjeve të vështira në parandalimin e konflikteve dhe operacive paqeruajtëse.

Anëtarësimi në strukturat euro-atlantike ka disa avantazhe në ballafaqimin me sfidat e reja në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Proçesi i përshtatjes kërkon veprime të shpejta, të guximshme dhe transparente në konsolidimin e strukturave ushtarake, forcimin e mëtejshëm të shtetit të së drejtës, lirive dhe të drejtave të njeriut. Hartimi dhe zhvillimi i objektivave të qartë në bashkëpunimin me NATO, BE dhe SHBA do t'i mundësoi vendit përfitime në konsolidimin e elementëve të lartpërmendur, por në anën tjetër do të krijon probleme sociale, për arsye të ristrukturimit dhe shkurtimit të personelit në strukturat e forcave të armatosura. Strukturat Euro-Atlantike kërkojnë nga ne konsolidimin e strukturave dhe përfshirjen në situata ushtarake konkrete dhe reale. Realiteti dhe ambjenti aktual i sigurisë, duhet shikuar si një mundësi e mirë bashkëpunimi midis BE dhe SHBA-s. Kjo mundësi duhet shfrytëzuar me qëllim krijimin e fushave të bashkëpunimit midis partnerëve në vend të krijimit të balancave.

121 United States Information Agency Alumni Association, "What Is Public Diplomacy?" Washington, D.C., updated September 1, 2002. Online at <http://www.publicdiplomacy.org/1.htm> (as of August 6, 2004).

Shqipëria në NATO zhgjidh një nga problemet dhe dilemat më të mëdha të sigurisë kombëtare, ruajtjen e integritetit teritorial, zvogëlimin e rrezeve, rritjen e rolit dhe rëndësinë e bashkëpunimit dhe krijimin e një ambjenti më të siguritë. Pjesëmarrja në operacionin paqeruajtës në Bosnje – Hercegovinë, Gjeorgji, Afganistan, Irak, Çad dhe republikwn e Afrikës Qëndrore do ta pasuroi dhe zhvilloi më tej kurikulumin e aktiviteteve dhe përvojës në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Eksperiencat e fituara krijojnë kushte proziteve në krijimin, hartimin dhe identifikimin e një pakete, e cila do të bëj identifikimin e aftësive të diplomacisë ushtarake në përmirësimin dhe zhvillimin e përgatitjeve ushtarake dhe rritjen e performancës në Forcat e Armatosura.

Eksperiencat dhe përvojat e fituar do të konsolidojnë dhe zhvillojnë më tej reformat në fushën e mbrojtjes, forcimin e shtetit të së drejtës dhe kontrollit civil mbi atë ushtarak. Pë shembull, përvoja dhe eksperiencia Bullgare mund të na ndihmojnë të krijojmë në Forcat e Armatosura një qendër eksellence me qëllim krijimin e mundësive në rritjen e kontributeve të vendit si anëtare në NATO dhe përpjekjet e përbashkëta në transformimin dhe konsolidimin e reformave në sektorin e sigurisë.¹²²

Diplomacia ushtarake duhet të bazohet në eksperiencat e deritanishme, të institucionalizohet dhe zhvillohet më shumë. Krijimi i diplomacisë ushtarake si një nga misionet kryesore të mbrojtjes do të mundësoi një ndikim pozitiv dhe koherent, në aktivitetet e kohës së paqes. Konsolidimi dhe forcimi i bazave të bashkëpunimit rajonal ndihmon dhe influencon në riformatimin dhe rikonfigurimin e rolit të diplomacisë ushtarake në kohë paqe, reduktimin dhe parandalimin e konflikteve, uljen e tensioneve dhe rritjen e mirëkuptimit dhe mirëbesimit. Kontributi i Shqipërisë në operacionet paqeruajtëse duhet të mbështetet nga formate dhe mënyra të larmishme të bashkëpunimit

122 V. Rachev, fq. 59

në fushën e edukimit dhe trajnimit, si një nga komponentët bazë të rritjes së rolit dhe ndikimit të diplomacisë ushtarake.


3.2 Diplomacia Ushtarake dhe Samitet e NATO-s

Samitet e ndryshme të NATO-s kanë evidentuar progresin e Shqipërisë në ristrukturimin e Forcave të Armatosura por edhe në konsolidimin e elementëve përbërës të diplomacisë ushtarake të kohës së paqes. Ndryshimet demokratike dhe zhvillimet e pas viteve 1990, krijuan mundësi dhe kontakte të reja. Shqipëria në vitin 1994, në Samitin e Brukselit me vullnet të plotë politik u bë anëtare e iniciativës së Partneritetit për Paqe (PfP).¹²³ Kjo ishte iniciativa e parë ku vendi u bë anëtar me të drejta të plotë.

Samiti i Brukselit, 1994

Anëtarësimi i Shqipërisë në PfP solli më pas anëtarësimin në dokumentin e PARP-it, në vitin 1995. Zhvillimet e mëtejshme në fushën e mbrojtjes në vitin 1996, u pasuan nga takimi i ministrave të Mbrojtjes të gjashtë vendeve të rajonit përfshirë, Shqipërinë, SHBA, Italinë, Greqinë, Bullgarinë dhe Turqinë, të cilat vendosën të krijojnë iniciativën e Ministerialit të Mbrojtjes të Europës Jug-lindore (SEDM).

123 Shqipëria bëhet anëtare e PfP më 23 Shkurt 1994, në Samitin e Brukselit.



Samiti i Madridit, 1997

Anëtarësimi i Shqipërisë në PFP dhe SEDM forcuat dhe konsoliduan bazat e Diplomacisë së re Ushtarake. Samiti i Madridit krijoi mundësi të reja dhe rriti më shumë frymën e bashkëpunimit me Aleancën dhe e bëri Shqipërinë anëtare të Këshillit të EAPC-s.

Anëtarësimi i Shqipërisë në EAPC identifikoi një numër detyrash dhe sfidash në përmirësimin e aftësive operacionale dhe rritjen e përfaqësimit të vendit me trupat në operacionet paqeruajtëse të drejtuara nga NATO, OKB dhe kualicione të tjera. Shqipëria morrin në konsideratë rritjen e përfaqësimit me trupave në BiH dhe u bë pjesë e iniciativës rajonale MPFSEE/SEEBRG, në vitin 1998.

Samiti i Uashingtonit, 1999

Samiti i Uashingtonit vuri si detyrë përpara vendeve aspirante, rritjen e përfaqësimit me trupa në operacionet paqeruajtëse dhe përmirësimin e kapaciteteve operacionale. Aleanca në samitin e Uashingtonit

egzaminoi nevojën e zhvillimit të aftësive individuale në përmirësimin e kapaciteteve operacionale të cilat mund të kenë një ndikim të suksesshëm në përballimin e sfidave të së ardhmes.¹²⁴ Qëllimi i këtij samiti ishte zhvillimi i kapaciteteve të përbashkëta vlerësuese në përballimin e veprimeve operacionale. Shqipëria si pjesëmarrëse në këtë samit përcaktoi objektivat dhe detyrat në përmirësimin dhe zhvillimin më tej të aftësive luftarake të trupave dhe kapaciteteve operacionale.

Samiti i Uashingtonit e bëri Shqipërinë anëtare të dokumentit të MAP-it. Pjesëmarrja në këtë dokument dhe statusi i aspirantit i nxiti FA të angazhoheshin më shumë në plotësimin e objektivave dhe detyrave, si pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse dhe rritja e elementëve të ndërveprueshmërisë me aleatët. NATO nga ana e saj premtoi angazhimin dhe afrimin e asistencës në ristrukturimin e forcave të armatosura dhe rritjen e elementëve të sigurisë në vend.¹²⁵

Samiti i Pragës, 2002

Samit i Pragës u bë tribunali dhe forumi i cili prezantoi arritjet dhe përgjegjësitë e vendeve aspirante në rrugën e anëtarësimit në Aleancë. Rritja e prezencës me trupa në operacionet paqeruajtëse ishte një nga sfidat me të cilat po ballafaqohej vendi. Pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse dhe konsolidimi i aftësive operacionale u bënë në këtë samit objekt diskutimi. Shqipëria nëpërmjet këtij tribunali, premtoi dhe garantoj rritjen e kontributeve me trupa dhe kapaciteteve operacionale në interes të paqes dhe sigurisë globale. Përmirësimi i kapaciteteve operacionale dhe rritja e prezencës me trupa në operacionet paqeruajtëse, u arrit në saj të kontributit të ushtarakëve dhe konsensusit politik. Pjesëmarrja dhe angazhimi në operacionet paqeruajtëse, krijoi kushtet e nevojshme për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e besimit tek komponenti ushtarak në forcimin e

124 <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99s069e.htm>

125 www.nato.int

marrëdhënieve dhe sigurisë në rajon. Filozofia e bashkëpunimit dhe dialogut, i çoj vendet e rajonit në nënshkrimin e Kartës së Adriatikut (US – Adriatic Charter 3), midis Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe SHBA-s në Tiranë, në 02 Maj të vitit 2003.

Samiti i Stambollit, 2004

Samiti i Stambollit hodhi bazat e anëtarësimit dhe vlerësoi punën e bërë nga tre vendet anëtare të kartës së Adriatikut në rrugën e integritimit në Aleance. Samiti evidentoi domosdoshmërinë e zhvillimit dhe rritjen e aftësive operacionale në operacionet paqeruajtëse dhe luftës kundër terrorizmit. Vendet e A3, vendosën të rrisin bashkëpunimin dhe morën vendimin, për krijimin e ekipit të përbashkët mjekësor dhe dërgimin me mision në Afganistan, në vitin 2005.

Samiti i Rigës, 2006

Samiti i Rigës evidentoi arritjet dhe konsolidimin e FA të vendeve të A3 në rrugën e rishtrukturimit dhe bashkëpunimit në nivel dypalësh dhe rajonal. Progresi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë do të ndihmonte FA të Shqipërisë në përmirësimin e nivelit të reformave dhe arritjen e standarteve për anëtarësim.

Iniciativat rajonale dhe individuale e kanë ndihmuar Shqipërinë të prezantohet dhe konsolidoi më tej vlerat e bashkëpunimit me vendet e rajonit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Në kuadrin e iniciativës rajonale SEDM-CC & PMSC, Ministria e Mbrojtjes për vitin 2005-07 drejtoi me sukses Sekretariatit e SEDM-it. SEDM-i gjatë kësaj periudhe mundësoi dërgimin e SEEBRIG-u për herë të parë në mision paqeruajtës ISAF, në Afganistan.

Samiti i Bukureshtit, 2008

Samiti i Bukureshtit do të kujtohet gjatë nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, si forumi i cili morri vendimin historik për të ftuar

Shqipërinë në këtë aleancë. Udhëheqësit e vendeve anëtare të Alenacës morrën vendimin e shumëpritur, për të ftuar Shqipërinë dhe Kroacinë t'i bashkohen organizatës së Atlantikut të veriut. Me këtë rast Sekretari i NATO-s Scheffer deklaroi se: *'Vendet të cilat do të bashkohen me ne, duhet të jenë krenare në arritjen e standarteve të NATO-s për anëtarësim. Shumë vite punë e lodhëshme me Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) tani u shpërblye. Duke vlerësuar punën tuaj, Aleanca është e sigurtë se pjesëmarrja juaj do ta forcojë NATO-n.'*¹²⁶



Samiti i Bukureshtit ¹²⁷

Vendimi historik për të ftuar Shqipërinë u arrit falë punës së palodhur dhe profesionalizmit të ushtarakëve, civilëve dhe mbështetjes së qeverisë në rrugën e anëtarësimit. Diplomacia ushtarake dhe ajo kombëtare kanë marrë frytet e punës disavjeçare në propagandimin dhe inkurajimin e vlerave dhe aspiratave të kombit tonë për t'u anëtarësuar në familjen e vendeve të lira dhe sovrane. Anëtarësimi në këtë organizatë do të krijojë mundësi të shumta bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperiencash.

¹²⁶ www.nato.int

¹²⁷ https://www.nato.int/cps/en/natolive/news_7195.htm, gjetur më 09 gusht 2018 (Samiti i Bukureshtit)

Progresi dhe rruga nëpër të cilat kanë kaluar Forcat e Armatosura të Shqipërisë, tregon dhe një herë se elementët e diplomacisë ushtarake janë zhvilluar dhe konsolidur. Sot më shumë se kurrë u del për detyrë ushtarakëve dhe civilëve të zhvillojnë dhe perfeksionojnë rolin dhe rëndësinë e diplomacisë ushtarake në mbështetjen dhe anëtarësimin e plotë të vendit në aleancë.

Samiti i Strasbourg dhe Kehl, 2009

Drejtuesit e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare rideklaruan rëndësinë e aleancës dhe ngazhimin në ruajtjen e vlerave dekomkratike. Ata hodhën idenë e zhvillimit të Konceptit të ri Strategjik të NATO-s, një dokument i cili do të përcaktojë rolin e NATO-s, për një periudhë afatgjatë në mjedisin e ri të sigurisë në shekullin e 21-të. Së fundmi drejtuesit e NATO, uruan mirëseardhjen e Shqipërisë dhe Kroacisë në familjen e madhe euro-atlantike.

Samiti i Lisbonës, 2010

Në samitin e Lisbonës, vendet anëtare të NATO, miratuan konceptin e ri strategjik të NATO-s. I treti dokument që nga rënja e murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjeti. Ky dokument përcakton rolin e ri të NATO-s, në adresimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në mjedisin e ri të sigurisë.

Samiti i Çikagos, 2012

Në samitin e Çikagos, drejtuesit e vendeve dhe qeverive vendosën të vazhdojnë me përkushtim zbatimin e detyrave dhe detyrimeve të përcaktuara nga dokumenti i ri i strategjisë. Një vëmendje ju kushtua rritje së bashkëpunimit midis aleatëve dhe partenerëve në luftën kundër terrorizmit, misionit të NATO-s në Afganista (ISAF) dhe rritjes së bashkëpunimit dhe dialogut për çështje kryesore të sigurisë me Federatën Ruse.

Samiti i Uellsit, 2014

Në samitin e Uellsit, drejtuesit e 28-vendeve, ranë dakort të investojnë më shumë burimeve financiare dhe njerëzore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Çdo vend anëtarë i NATO, duhet të shpenzoje 2% të rritjes së brendëshme ekonomike, në mbrojtjen e vendeve dhe qytetarave tanë. Ndërsa zvogëlimi i buxheteve të mbrojtjes dhe pa sigurinë e nevojshme, theksonte sekretari i përgjithshëm i NATO-s Z. Fogh RASMUSSEN, është e pamundur të ecim përpara.

Samiti i Varshavës, 2016

Samiti sipas sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Z. Jens Stoltenberg, do të ngelet burimi kryesorë i sigurisë për vendet tona dhe stabilitetin për botën mbarë. Në këtë takim NATO vendosi (1) të rrisë prezencën ushtarake me katër batalione në Poloni, Estoni, Leton dhe Lituani, duke filluar nga viti 2017; (2) Alleanca deklaroi rritjen e prezencës ushtarake në kufijtë jug-lindorë; (3) kryetarët e shteteve ranë dakort mbi vendosjen e sistemeve raketore të mbrojtjes balistike, me qëllim forcimin e hapësirës kibernetike në zonën e veprimeve operacionale; (4) liderat politik dhe ushtarak miratuan rritjen e kapaciteteve përgatitëse brenda Irakut; (5) ata njoftuan se misioni i NATO AWACS do të mbledhë dhe mbështesë kualicionin ndërkombëtarë me informacionin e nevojshëm për ISIL; (6) NATO do të zgjerojë prezencën ushtarake në detin Mesdhe; (7) liderat politikë dhe ushtarakë me drejtuesit politik Afganë, vendosën vazhdimin e mbështetjes për misionin, NATO Resolution Support, edhe gjatë vitit 2016 dhe mbështetjen e forcave të armatosura Afgane deri në vitin 2020; (8) më pas liderat biseduan për situatën në Ukrainë, ku vendosën të vazhdojnë me paketën e ndihmës për Forcat e Armatosura; (9) gjithashtu sekretari i përgjithshëm i NATO-s, nënshkroi një deklaratë të përbashkët me presidentin e këshillit Evropian, mbi partneritetin midis NATO-s dhe BE-s.¹²⁸

128 Warsaw Summit Communique, accessed on 26 January 2017.

Samiti i Brukselit, 2018

Samit i radhës i NATO u mbajt në Bruksel, Belgjikë nga data 11 korrik deri më 12 korrik 2018. Në këtë samit, morën pjesë për herë të parë 29-vende anëtare. Mali i Zi është anëtar i ri i aleancës. Gjatë dy ditëve, krerët e shteteve diskutuan një sër çështjes, të cilat kanë lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen.

Sipas sekretarit të NATO zotit Jens Stoltenberg, samiti vuri theksin në: rritjen e gadishmërisë të forcave të armatosura të vendeve anëtare të NATO; rritjen e kapaciteteve në lëvizshmërinë dhe dislokimin e forcave brënda hapësirës Euro-Atlantike; modernizimin e strukturave ushtarake dhe ngritjen e qendrave të reja operationale në adresimin e rreziqeve kibernetike dhe hibride.¹²⁹ Gjithashtu, NATO vendosi të rrisë kontributet në luftën kundër terrorizmit, duke u përqëndruar në: krijimin e një misioni të ri trainimi në Irak; rritjen e mbështetjes për Jordaninë dhe Tunizinë, si dhe krijimin e një qendre operationale në Jug të kufirit të aleancës, e cila do të adresojë të gjitha situatat e krijuara. Ky samit adresoi një sër çështjes dhe problemesh të cilat kanë të bëjnë me: (1) të ardhmen e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në NATO; (2) kërcënimet që vijnë nga Rusia, duke e vënë theksin tek mbështetja e integritetit territorial të Ukrainës, Gjeorgjisë dhe Moldavisë; dhe (3) rritjen e shpenzimeve ushtarake nga vendet anëtare deri në 2% të prodhimit të brendshëm.

Samit i Brukselit ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme të aleancës, ku u adresuan, diskutuan dhe u dakortësuan një sër çështjes të rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Vendet anëtare treguan edhe një herë, vendosmërinë dhe unitetin në adresimin e rreziqeve në mjedisin e ri të sigurisë.

129 www.nato.int/cps/en/natohq/opinions_156738.htm 'Press conference by NATO Secretary General Jens Stoltenberg at the conclusions of the Brussels Summit', gjetur më datë 13 gusht 2018.

3.3 Objektivat dhe angazhimet e diplomacisë ushtarake

3.3.1 Objektivat

Shqipëria në rrugën e konsolidimit dhe ristrukturimit të Forcave të Armatosura dhe anëtarësimi në NATO, ka përcaktuar një numër objektivsh në lidhje me aktivitetet e zhvilluara në kuadrin e PfP-s, MAP-it, PARP-it dhe IPP-s (*para marrjes së ftesë për anëtarësim në samitin e NATO-s në Bukuresht*).

- *Objektivat e MAP-it*¹³⁰

Kriteret dhe qëllimi kryesorë i pjesëmarrjes të Shqipërinë në MAP ishte qenia sa më aktive në kadrin e aktiviteteve të PfP. Pjesëmarrja në aktivitetet për partneritet për paqen ishte vendi, ku Shqipëria ballafaqohej me partnerët dhe prezantonte aftësitë operationale dhe ndërveprueshmërinë me trupa dhe personel. Në anën tjetër, Shqipëria përfitonte si vend anëtar i procesit të MAP-it, nga ekspertiza dhe konsulenca politike dhe ushtarake e ekspertëve të Aleancës.

Shqipëria kontribon me mjete dhe personel në operationet paqeruajtëse (p.sh. ne jemi/ishim pjesëmarrës në operationet paqeruajtëse ne Bosnje – Hercegovina, Irak, Afganistan, Çad dhe republikën e Afrikës Qëndrore), si dhe ka marrë përsipër përgjegjësitë dhe është në gjëndje të përballojë rreziqet në kuadrin e aleances dhe të ketë bashkëpunim rreal me partnerët në terrën.

- *Objektivat e PARP-it*¹³¹

Diplomacia ushtarake është zhvilluar dhe konsoliduar me tej edhe nëpërmjet zbatimit të objektivave të përcaktuara nga dokumenti i PARP-t. Objektivat e përcaktuara në këtë dokument, na detyronin të

130 MAP “Membership Action Plan” Plani i Veprimit për Anëtarësim.

131 PARP – Proçesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit

zhvillonim sistemet e planizimit në linjë me planizimin e NATO-s dhe të siguronim transparencën e nevojshme në procesin e planizimit dhe buxhetimit. Dokumenti i PARP-it kerkonte nga forcat e armatosura rritjen dhe pjesëmarrjen me trupa në Operacionet Paqeruajtëse (PSO), konsolidimin dhe perfeksionimin e aftësive operacionale dhe ndërveprueshmërinë me vendet anetare të aleancës dhe ato partnere.

- *Objektivat e IPP*¹³²

Diplomacia Ushtarake është elementi kryesor dhe dallues në zhvillimet dhe organizimin e aktiviteteve të IPP-s. Mbështetja e objektivave të transformimit të Forcave të Armatosura dhe zbatimi i tyre kontribuojnë në forcimin dhe identifikimin e rolit të diplomacisë ushtarake. Rritja e aftësive operacionale dhe bashkëvepruese në trajnimet e ndryshme dhe stërvitjet e përbashkëta në kuadrin e IPP-s, ndikon në organizimin dhe konsolidimin e njësisë tona në kuadrin e PFP-s dhe SEDM-it. Ky program (IPP) mundësonte arsimimin, shkëmbimin e përvojës dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në kuadrin e stërvitjeve komando shtabi dhe stërvitjeve në terrën. Zhvillimi i marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes është në interes të zhvillimit dhe konsolidimit të filozofisë të diplomacisë ushtarake të kohës së paqes.

3.3.2 Angazhimet dhe arritjet kryesore

Shqipëria gjatë viteve të fundit ka përcaktuar si objektiv parësor përsheptimin e procesit të transformimit dhe konsolidimit të Forcave të Armatosura. Plotësimi i objektivave të vëna nga NATO, kërkon nga FA përgatitjen e një batalion këmbësorie, i paisur dhe trajnuar sipas standarteve të kërkuara dhe i ndërveprueshëm me forcat aleate. Veprimet luftarake dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse kërkojnë mbështetje financiare dhe legjislative. Plotësimi i objektivave operacionale, mbështetja financiare dhe përmirësimi i legjislacionit do

132 IPP "Individual Partnership Goals", Objektivat Individuale të Partneritetit.

të ndihmojnë në konsolidimin e Forcave të Armatosura dhe vlerësojnë më shumë rolin e diplomacisë ushtarake në procesin e anëtarësimit të plotë në Aleancë.

Diplomacia ushtarake ka një kontribut të rëndësishëm në angazhimin dhe plotësimin e objektivave kombëtare, rritjen dhe forcimin e marrëdhënieve me partnerët dhe krijimin e metodologjive efikase në parashikimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe. Në këtë kuadër, FA të Shqipërisë kanë zhvilluar një numër hapash në konsolidimin dhe forcimin e ritmit të diplomacisë ushtarake si:

1. Krijimi dhe konsolidimi i strukturave të përbashkëta të forcave (*Tokësore, Detare dhe Ajrore*) dhe konceptit të forcave të bashkuara (*Joint Concept*) në veprimet luftarake dhe bashkëveprimet me aleatët.
2. Rishikimi i dokumentit të strategjisë kombëtare (*Dokumenti i Strategjisë Kombëtare është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë*).
3. Kalimi nga një forcë e bazuar në shërbimin e detyrueshëm, në një forcë plotësisht profesioniste (*Objektivi u arrit në vitin 2010*).
4. Modernizimi i forcës dhe rritja e aftësive për dislokim në rajonin e krizave. (*Plani i Zhvillimit të Forcës 2015-2025*). Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2015.
5. Rritja e aftësive dislokuese, ndërveprueshmëria dhe mbështetja.
6. Rritja e aftësive pjesëmarrëse në operacionet paqeruajtëse me përfshirjen e të gjitha llojeve të armëve dhe specialiteteve. (*Joint Exercises and Training*)
7. Zbatimi i programit OCC.
8. Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në operacionet paqeruajtëse drejtuar nga NATO. (*Shqipëria merr pjesë në operacionin paqeruajtës Resoluton Support në Afganistan të drejtuar nga NATO dhe në ALTHEA, Bosnje – Hercegovinë të drejtuar nga BE-ja*).

9. Përgatitja e personelit i cili do të shërbejnë në strukturat dhe komandat e NATO-s.
10. Krijimi dhe zbatimi i standarteve të planizimit, programit të buxhetit dhe prokurimeve.
11. Shkatërrimi i municioneve dhe armëve të tepërta. *(Në këtë fushë Shqipëria është një nga vendet e parë në botë dhe rajon, përse i përket shkatërrimit të armëve të lehta dhe municioneve të tepërta, si dhe vendi i parë në botë pa armë dhe lëndë kimike).*

Ndryshimet e ndodhura pas vitit 1990, krijuan hapësira dhe mundësi të reja bashkëpunimi, midis vendeve të Ballkanit Perendimor në fushën e mbrojtjes, ekonomisë dhe politikës. Rajoni i Ballkanit ka prodhuar në shekuj konflikte dhe mosmarrëveshje të shumta. Shembulli i ish-Jugosllavisë dhe konflikti ndër-etnik në këtë vend, nxorri në pah një numër problemesh dhe mosmarrëveshjes të trashëguara nga e kaluara.

Ndryshimet e reja politike vunë përpara qeverisë dhe vendit dy sfida kryesore. Së pari, konsolidimin dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe përballimin me sukses të tranzicionit demokratik dhe rreziqeve politike me të cilat vendi mund të ndeshet gjatë këtij procesi. Së dyti, krijimi i mundësive të barabarta në prezantimin dhe zbatimin e ekonomisë së tregut. Plotësimi i këtyre objektivave dhe standarteve kërkonte konsolidimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Me pak fjalë kërkon rregulla të reja. Zbatimi i këtyre kriterëve mundësoi dhe rriti frymën e bashkëpunimit dhe sigurinë në rajon. Anëtarësimet e fundit në rajonin e Ballkanit në NATO dhe BE, kanë krijuar mundësi unike në rritjen e sigurisë, zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë dhe plotësimin e objektivave afatmesme dhe afatgjata në strukturat Euro-Atlantike.

3.4 Institucioni i atasheut ushtarak

Shpërbërja e BS dhe lufta kundër terrorizmit e kanë rritur rolin dhe rëndësinë e atasheut ushtarak. Ky insitucion ka qënë plotësisht i përfshirë në një numër aktivitetet të zhvilluara në fushën e mbrojtjes në mbështetje të vendimarrësve dhe komandantëve ushtarake. Harta politike e dy dekadave të fundit ka ndryshuar rrënjësisht dhe ka rritur rëndësinë e diplomatit ushtarak jashtë vendit.¹³³ Nga viti 1945 numri i vendeve anëtare të OKB-s ka ndryshuar nga 51 shtete sovranë sot afërsisht në 200. 25 vjet më parë, nga ish-BS dolën një numër i madhë shtetesh të pavarura. Këto shtete filluan të prezantonin indetitetin e tyre të veçantë kombëtare dhe kulturore, e cila u shoqërua me rizbulimin e gjuhëve amëtare të ndrydhura nga politika e terrorit e ndërmarr nga Sovjetikët.

Fragmentimi i vendeve të dala nga Lufta e Ftohtë dhe rritja e numrit të shteteve me demokraci të brishtë e vunë qeverinë dhe forcat e armatosura Shqiptare përpara sfidave të reja. Ndryshimet globale dhe rajonale krijuan dhe hodhën bazat e diplomacisë ushtarake e cila i ka fillesat e saj pas vitit 1990. Në mbështetje të misionit diplomatik Ministria e Mbrojtjes hapi zyrën e atasheut ushtarak në një numër vendesh të NATO-s dhe partnere. Forcat e armatosura të Shqipërisë kanë atashe ushtarakë në SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Itali, Belgjikë, Austri, Greqi, Turqi, Maqedoni, Kroaci, Kosovw, Mali i Zi etj. Atasheu ushtarak thotë Kapiteni i Rangut të Parë Astrit Alia (ish-Atashe në Itali) është ushtaraku i forcave të armatosura, i cili shërben në një ambasad në vend të huaj, si përfaqësues i Ministrisë të Mbrojtjes dhe gëzon imunitet diplomatik.¹³⁴ Atasheu ushtarak përzgjidhet nga forcat e armatosura dhe është përgjegjës për të gjitha aspektet të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e mbrojtjes. Ai shërben si pikë lidhëse midis institucionit të mbrojtjes të vendit që përfaqëson dhe institucionit

133 Timoty C. Shea, Transformin Military Diplomacy, JFQ, fq. 49

134 Astrit Alia, Diplomacia Ushtarake, Gazeta Ushtria fq.10

të mbrojtjes të vendit ku ai shërben. Por cila është zanafilla e fillimit dhe identifikimit të institucionit të atasheut ushtarake? Në përgjigje të kësaj pyetje, atasheu ushtarak është shfaqur në shekullin e 17-t në luftën 30-vjeçare të zhvilluar nga Duka Richelieu, i cili dërgoi jashtë vendit oficerë për t'u lidhur me fuqitë aleate, me qëllim monitorimin e zhvillimeve ushtarake dhe mbledhjen e informacionit inteligjent.¹³⁵

Zhvillimet dhe lufrat e shumta në shekullin 18 dhe 19 i detyruan vendet e përfshira në luftime të institucionalizonin pozicionin e atasheut ushtarak. Vendet si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermani, Itali, Turqia, Rusia krijuan institucionin kombëtarë të atasheut ushtarak, i cili siguronte ndërlidhjen dhe kordinimin me aleatët të përfshirë në konflikt. Fillimet e shekullit të 20 hodhën bazat dhe konsoliduan më tej rolin dhe pozicionin e atasheut ushtarake. Një numër i madhe vendesh, gjatë luftës së ftohtë, e përdorën atasheun ushtarak jo vetëm si element ndërlidhës midis vendeve dhe forcave të armatosura, por edhe si mbledhës i informacioneve inteligjente.



Trainim¹³⁶

135 Po Aty

136 Atashtet ushtarak gjatë një trainimi, Revista JFQ

Ndryshimet demokratike dhe rënia e perdes së hekurt midis perendimit dhe lindjes përcaktuan një pozicion të ri në rolin dhe detyrat e atasheut ushtarake. Në lidhje me këtë Kap.Rang.I-rë Aliaj¹³⁷ ka rradhitur një numër detyrash dhe rolesh të atasheut ushtarak mbështetur në eksperiencën dhe përvojën si atashe ushtarak i forcave të armatosura të Shqipërisë në Itali.

1. Atasheu ushtarak është avokat i interesave ushtarake dhe sigurisë.
2. Përfaqëson autoritetet ushtarake të vendit të tij dhe është ndërlidhës me institucionet ushtarake të vendi ku vepron.
3. Ndikon në forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e mbrojtjes.
4. Vepron si këshilltar ushtarak dhe sigurisë për ambasadorin dhe personelin e ambasadës të vendi që përfaqëson.
5. Vëzhgon dhe analizon situatën e sigurisë dhe mbrojtjes të vendit mikpritës dhe informon autoritetet e vendit të tij.
6. Mbikqyr dhe inicion bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes në kuadrin dypalësh dhe shumpalësh me NATO dhe vendet partnere.
7. Promovon vlerat demokratike, reformat në fushën e mbrojtjes dhe industrinë ushtarake të vendit që përfaqëson.
8. Luan rol ndërlidhës me institucionet e vendit mikpritës në ndihmën dhe mbështetjen e kapërcimit të situatave emergjente në të cilat kalon vendi i tij

Duke parë dhe komentuar rolin e atasheut ushtarak del në pah roli i tij si element dhe hallkë kryesore në zixhirin dhe procesin e zhvillimit dhe zbatimit të diplomacisë ushtarake. Forcat ushtarake amerikane e konsiderojnë rolin dhe rëndësinë e institucionit të atasheut ushtarake, si promotor në rritjen e marrëdhënieve dypalëshe me vendin mikpritës dhe rritjen e besimit.¹³⁸ Përkufizimi se roli i atasheut ushtarak nuk

137 Po Aty

138 Timothy C. Shea, fq. 49

është gjë tjetër veç protokoll, alkol dhe kolesterol (*More than protocol, alcohol and cholesterol*)¹³⁹ nuk është i vërtet për institucionin e tij. Termi atashe ka një kuptim të saktë dhe preciz në përdorimin diplomatik. Ushtaraku i cili dërgohet jashtë vendit nuk është vetëm atashe, ai/ajo duhet të pajiset me status dhe imunitet të plotë diplomatik. Që nga fillimi, atasheu ushtarak në pikpamjen ndërkombëtare ka qënë diçka hibride në botën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ai/ajo ka qënë pjesërisht diplomat, pjesërisht ushtarak, pjesërisht zbulues dhe siç thotë Lordi George Curzon jo plotësisht i mirëpritur.¹⁴⁰ Atashtetë ushtarak në të shkuarën janë konsideruar si syte dhe veshët e kombit jashtë vendit para se të zhvilloheshin dhe përfeksionoheshin teknologjitë e zhvilluara, si ndjekja e situatave me satelitë dhe fotografimi nga lartë. Sot shumë vende të rajonit dhe NATO-s, duke përfshirë dhe forcat e armatosura të Shqipërisë, i japin institucionit të atasheut ushtarak rëndësi strategjike dhe dërgojnë jashtë vendit ushtarakët më të mirë. Ata në shumë raste funksionojnë si një pjesë e madhe e diplomacisë ushtarake publike jashtë vendit.

3.5 Bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh

Fillimet e viteve 1990, kanë evidentuar ndryshime të mëdha në natyrën dhe procesin e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes. Historikisht asistenca dhe bashkëpunimi ushtarak kanë qënë pjesë e politikës së vërtetë ndërkombëtare dhe politikës së fuqive të mëdha, të përcaktuara në hapësira shumë të ngushta sipas interesave të vendeve.

Sot diplomacia ushtarake përmbledh një numër aktiviteteve që në të shkuarën janë paraqitur si bashkëpunim ose asistencë ushtarake (*Shiko Tabela No. 1*). Disa nga elementët e përdorura më parë nga forcat e armatosura nuk janë aktivitete të reja. Për shembull emërimi zyrtar i Atasheve Ushtarak/Mbrojtjes daton që nga shekulli i XIX-të në

139 Po Aty, fq. 50

140 B.I.Spector dhe I.W. Zartman, fq. 172-174

Diplomacinë Europiane.¹⁴¹ Shumë aktivitete të cilat sot përshkruhen si pjesë e diplomacisë ushtarake janë praktikuar nga NATO, Traktati i Warsawës dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë para viteve 1990.

Tabela No. 1

Aktivitetet e Diplomacisë Ushtarake
• Takimet e nivele të larta të zyrtarëve civilë dhe ushtarak të mbrojtjes.
• Emërimi i Atasheve Ushtarakë/Mbrojtjes në vendet e huaja.
• Trajnimi i personelit civil dhe ushtarak jashtë vendit.
• Asistenca dhe këshillimi në fushën e kontrollit demokratik mbi forcat e armatosura, drejtimi i mbrojtjes dhe teknologjisë ushtarake.
• Shkëmbimi i vizitave të personelit ushtarak, civil dhe anijeve luftarake detare.
• Caktimi i misioneve civilo-ushtarake të asistencës (p.sh. SAIC, CUBIC, DIE, Misioni i Asistencës i Turqisë etj).
• Dislokimin e trupave mbrenda dhe jashtë vendit. (Pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse dhe stërvitje e përbashkëta)
• Ndihma dhe asistenca ushtarake
• Stërvitje dypalëshe dhe shumpalëshe, brenda dhe jashtë vendit.
• Pjesëmarrja në Traktatin e Qiejve të Hapur.
• Inspektimet e Armë-Kontrollit.
• Bisedimet e Shtabit (Staff Talks) – Diskutime formale midis forcave të armatosura
• Institucioni i Atasheut Ushtarake, përfaqësuesve në komandant e NATO-s, OSBE dhe ndërlidhësit ushtarak.

141 E.S. Williams, fq. 20-21

Gjatë dekadës së fundit bashkëpunimi ushtarak është përdorur si element afatgjatë i politikave në mbështetje të forcave të armatosura dhe sigurisë në rajon, por ai është përdorur edhe si element në zgjerimin e bashkëpunimit dhe plotësimin e objektivave të politikës së sigurimit.

Forcat e Armatosura të Shqipërisë e kanë zgjeruar fushën dhe gamën e bashkëpunimit ushtarak. Shqipëria sot ka nënshkruar një numër marrëveshjes dypalëshe dhe shumëpalëshe me vendet e rajonit. Siç e kemi theksuar dhe më parë, Shqipëria është anëtare e iniciative të ndryshme rajonale dhe më gjërë (për shembull; Iniciativa e Detit Mesdhe, Iniciativa e Detit të Zi etj). Marrëveshjet e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, janë pasqyruar në Tabelën No. 2.

Tabela No. 2

No	Aktivitet në FA të Shqipërisë	Sasia
1.	Marrëveshje/MoU	25
2.	Programe bashkëpunimi vejetor dypalësh	27
3.	Marrëveshje teknike	17
4.	Vizita të niveleve të larta, jashtë vendit	30
5.	Vizita të nivele të larta, brënda vendit	20
6.	Atashetë ushtarak	10
7.	Ekipe ekspertësh	Më shumë se 160
8.	Përfaqësues në komandat e NATO-s	35

Marrëveshjet dhe bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes kontribuojnë në ndërtimin e urave të bashkëpunimit, besimit dhe sigurisë në rajon dhe më gjërë. Diplomacia ushtarake është bërë element dallues në vendet e demokracive liberale dhe vendeve të mirëqeverisura. Sfidat me të cilat ballafaqohen Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë të bazuara mbi disa rekomandime të cilat e vënë theksin në rritjen e bashkëpunimit në fushën e arsimimit, mbrojtjes, sigurisë, armë-kontrollit, stërvitjet e përbashkëta, shkëmbimin e përvojës etj.

3.6 Bashkëpunimi Rajonal

Vijat e ndarjes në rajonin e Ballkanit kanë sjellë një numër pasojash si në aspektin ushtarak dhe doktrinar. Politika të tilla konfliktuale dhe ndarëse kanë krijuar barriera dhe qëndrime të ndryshme në lidhje me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Në krahasim me vendet e tjera të Europës, vendet e rajonit në disa raste kanë treguar dhe vazhdojnë të tregojnë qëndrime të ndryshme në fushën politike dhe ushtarake. Në raste të tilla, forcat e armatosura kanë luajtur rol të rëndësishëm në krijimin e urave të bashkëpunimit dhe miqësisë midis vendeve. Procesi i SEDM-it dhe Karta e Adriatikut (US – Adriatic Charter 5) vërtetojnë se vendet e Ballkanit kanë potenciale dhe dëshirën në rritjen e bashkëpunimit dhe mirëkuptimin.

3.6.1 SEDM (Ministeriali i Mbrojtjes të Europës Jug-Lindore)

Zhvillimet dhe bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes i ka fillesat me vizitat në nivel Ministri, Zv/Ministri, Shef Shtabi, Zv/Shef Shtabi dhe funksionarëve të tjerë civil dhe ushtarak në vitin 1992 në Turqi, Itali, Greqi, SHBA etj. Në kontekstin e forcimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, u mbledhën në Mars 1996 në Tiranë, Shqipëri, ministrat e mbrojtjes të Shqipërisë, SHBA, Bullgarisë, Turqisë, Greqisë dhe Italisë me qëllim zgjerimin e bashkëpunimit. Ministrat ranë dakort që të firmosnin marrëveshjen e krijimit të Ministerialit të Europës Jug-Lindore (SEDM), me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe transparencës midis partnerëve në rajon.

Kjo iniciative u ideua si pjesë e programeve të partneritetit për paqe (PfP). Më pas takimi i radhës u zhvillua në Sofje, Bullgari më 03 Tetor 1997, ku morrën pjesë vendet e rajonit të cilat aspironin të bëheshin anëtare të NATO-s, përfaqësues nga SHBA, Greqia, Turqia dhe Italia, si dhe përfaqësues nga Shtabi i NATO-s, OSBE-ja dhe BE-ja. Në kuadrin e kësaj iniciative më 22 Maj 1998, në Tiranë u zhvillua takimi i Zv/ Ministrave të Mbrojtjes nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Maqedonia,

Rumania dhe Turqia, ku nënshkruan një letër mirëkuptimi me qëllim krijimin e një force shumëkombëshe të Europës Jug-Lindore (SEE). Më pas më 26 Shtator 1998 në Shkup u arrit marrëveshja për krijimin e kësaj force me pjesëmarrjen e Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë, Greqisë, Turqisë, Rumanisë dhe Italisë. Kjo ishte një nga iniciativat më të rëndësishme në rajon, pas asaj të nënshkruar në Tiranë në vitin 1996. Marrëveshja e miratur ishte e hapur për pjesëmarrje nga vendet e NATO-s dhe ato Partnere. Kjo forcë prej 2000-ushtarakësh ishte miratuar të mbështeste operacionet paqeruajtëse në kuadrin e NATO-s, BE-s, OKB-s dhe OSBE-s. Rritja e kontakteve dhe bashkëpunimit në kuadrin e kësaj iniciative, u mundësoi vendeve anëtare të plotësonin standartet dhe kriteret e anëtarësimit në NATO. Krijimi i Iniciativës MPFSEE/SEEBRIG nuk kishte si qëllim krijimin e një “klubi rajonal” ose “të një organizate rajonale”, por kishte si qëllim konsolidimin e demokracisë dhe sigurisë në rajonin e Europës Jug-Lindore, si dhe krijimin e kualicioneve me bazë pjesëmarrjen e gjërë në garantimin e sigurisë dhe zvogëlimin kërcënimeve të ndryshme. Brigada Shumëkombëshe e Europës Jug-Lindore u dislokua për herë të parë në Plovdiv, Bullgari nga viti 1999-2003.

Disa iniciativa të tjera rajonale në kuadrin e diplomacisë ushtarake janë si më poshte:

Brigada Shumëkombëshe e Europës Jug-lindore (MPFSEE/SEEBRIG). Në bazë të marrëveshjes të firmosur më 26 Shtator 1998 në Shkup, u krijua SEEBRIG-u (Brigada e Europës Juglindore) me pjesëmarrjen e Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë, Italisë, Maqedonisë, Rumanisë dhe Turqisë. Kjo eksperiencë tregoi rritjen e angazhimit të vendeve në lidhje me problemet e sigurisë dhe bashkëpunimit. Më pas Slovenia, SHBA dhe Kroacia morrën statusin e vëzhguesit të Iniciativës MPFSEE. Në dokumentat dhe materialet e publikuara MPFSEE-ja bazon aktivitetin e saj në:¹⁴²

142 K.Xharo etj...fq.27-27

- MPFSEE nuk vepron kundër një vendi të tretë dhe as nuk bëhet pjesë e ndonjë iniciative tjetër ushtarake kundër një vendi ose grup vendesh.
- Është e hapur për çdo vend anëtar i NATO-s ose Pfp-s për të marrë pjesë në të.
- Mbështet programet në kuadrin e Pfp me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit rajonal, si dhe promovon bashkëpunimin me OKB-n, NATO-n, OSBE-n dhe BE-n.
- Zhvillon konsultime politike dhe ushtarake dhe merr vendime në takime të rregullta të Ministrave të Jashtëm, Ministrave të Mbrojtjes, Shefave të Shtabit, Zv/Shefave të Shtabit, në takime të rregullta dy herë në vit të Komitetit të Drejtimit Politiko-Ushtarake (PMSC).

Mbas përfundimit të dislokimit në Plovdiv, SEEBRIG-u u zhvendos në Konstanca, Rumani për periudhën 2003-2007. Periudha e dislokimit të SEEBRIG-ut në Rumani, konçidon me marrjen nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë të kryesimit të Sekretariatit të SEDM-it, për periudhën 2005-2007. Gjatë punës dy-vjeçare, Sekretariati Shqiptar i SEDM-it ka arritur disa rezultate historinë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë:¹⁴³

1. Anëtarësimi i Ukrainës me të drejta të plota në procesin e SEDM-it, gjatë takimit të Ministrave të Mbrojtjes, zhvilluar në Uashington 2005.
2. Dërgimi dhe pjesëmarrja e Shtabit të SEEBRIG-ut, për herë të parë që nga krijimi i tij, në operacionin paqeruajtës ISAF, Kabul, Afganistan, për një periudhë 6-mujore 2006.
3. Pranimi i Bosnje – Hercegovinës, Gjeorgjisë, Malit të Zi dhe Serbisë, me statusin e vëzhguesit në procesin e SEDM-it në takimin e Ministrave të Mbrojtjes në Tiranë, 27 Shtator 2006.

143 Ç.Toci, fq.148

Këto janë sukseset më të rëndësishme të arritura nga procesi i SEDM-it që nga koha e krijimit të tij. Këto arritje tregojnë ndryshimet dhe progresin e arritur nga vendet e rajonit të Ballkanit. Vendet të cilat dikur quheshin “*vende armike*” sot janë ulur në një auditor, ku bisedojnë për rritjen e bashkëpunimit, forcimin e sigurisë, stabilitetit dhe besimit reciprok, i cili do t’u mundësoi vendeve të rajonit integrimin e tyre të plotë në strukturat Euro-Atlantike.

Në kuadrin e procesit të SEDM-it zhvillohen një numër projektesh si; IMIHO, CBSC, SEEDIRET, SEESIM dhe SEEMEC.

Ndërlidhja e spitaleve ushtarake (IMIHO/SIMIHO): Në kuadrin e procesit të SEDM-it Greqia propozoi lidhjen e spitaleve ushtarake nëpërmjet projektit të Bashkëpunimit Satelitor të Spitaleve Ushtarake (SIMIHO). Ky projekt u miratua në takimin vjetor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të SEDM-it në Tetor 2000, Selanik, Greqi. Qëllimi i propozimit Grek ishte lidhja e spitaleve ushtarake me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe mundësimin me kosto të ulët të lidhjeve të specializura për qendrat shëndetësore të kërkimeve dhe spitaleve kudo në Europë – duke përfshirë çdo spital që mund t’i shërbejë SEEBRIG-ut, nëse do të dislokohet në operacionet paqeruajtëse. Shqipëria është bërë pjesë e këtij projekti në vitin 2006.

CBSC-ja: Pas ngjarjeve të 11 Shtatorit vendet e zhvilluara filluan t’i kushtonin gjithnjë e më shumë vëmendje luftës kundër terrorizmit dhe pasojave të tij. Në këtë kontekst, vendet anëtarë të procesit të SEDM-it propozuan të krijonin një projekt i cili do të mundësonte dialogun dhe shkëmbimin e informacionit në nivel ekspertësh dhe më lart, në lidhje me parandalimin e sulmeve terroriste dhe veprimeve të ndryshme kriminale.

Ministrat e Mbrojtjes të Europës Jug-Lindore në takimin e tyre vjetor të zhvilluar në Antalia, Turqi në vitin 2001, vendosën krijimin e disa grupeve pune, që do të kishin si qëllim, studimin dhe hartimin e alternativave politike dhe institucionale, për sa i përket “Mbrojtjes/

Mbështetjes Ushtarake në kuadrin e parandalimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, sigurimit të kufijve dhe luftës kundër terrorizmit (CBSC).¹⁴⁴ Kjo nismë gjeti menjëherë mbështetjen e vendeve anëtare të SEDM-it dhe organizatave të tjera si NATO, BE, OSBE dhe OKB.

Për herë të parë kryesimin e këtij projekti e morri Rumania për periudhën 2001-2002, e pasuar më pas nga Greqia për periudhën 2002-2003, Kroacia nga viti 2003 deri më 01 Janar 2007. Aktualisht projekti kryesohet nga Bullgaria. Shqipëria është pjesë aktive e këtij projekti që nga krijimi i tij.

Industria Ushtarake, Fusha e Kërkimeve dhe Teknologjisë (SEEDIRET): Ky projekt lindi si nevojë dhe domosdoshmëri në rritjen e bashkëpunimit të vendeve të rajonit në fushën e industrisë, kërkimeve dhe teknologjisë ushtarake. Ky projekt u miratua në takimin e 5-të Zv/Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore në Bukuresht, Rumani më datë 18 Tetor 2002.¹⁴⁵ Qëllimi i këtij projekti është promovimi dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare të SEDM-it për problemet e industrisë, kërkimeve dhe teknologjisë ushtarake. Shqipëria ka kryesuar këtë projekt me sukses që nga viti 2007.

Rrjeti i Simulimit për Europën Juglindore (SEESIM): Ky projekt u propozua nga pala amerikane dhe u miratua nga Ministriat e Mbrojtjes të SEDM-it, në Tetor 2000. Qëllimi i këtij projekti ishte promovimi i bashkëpunimit, koordinimit dhe ndërveprimit të vendeve të SEDM-it dhe SEEBRIG-ut në raste stërvitjesh dhe fatkeqësish natyrore nëpërmjet përdorimit efektiv të modulimit dhe simulimit kompjuterik. Shqipëria është pjesë aktive e projektit dhe stërvitjeve të cilat zhvillohen një herë në dy vjet.

144 K. Xharo etj. fq 43

145 Ç. Toci, fq. 142

Projekti në fushën e arsimit dhe trainimit ushtarak SEEMEC: Projekti i SEEMEC-ut u propozua nga pala Shqiptare në takimin e SEDM-CC në 15 Mars 2007. Miratimi i këtij projekti u bë me procedurë të heshtur nga vendet anëtare të SEDM-it. Qëllimi i tij është krijimi i mundësive të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e arsimit dhe trainimit ushtarak. Në këtë iniciativë marrin pjesë të gjitha vendet anëtare dhe vëshguese të procesit të SEDM-it. Shqipëria ka kryesuar projektin e SEEMEC-ut, për vite me rradhë.

Projektet dhe programet në fushën e arsimit u mundësojnë ushtarakëve nga vende të ndryshme të avancojnë dhe përmirësohen në fushën e shkencave ushtarake dhe sigurisë. Iniciativa të tilla rajonale kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit midis ushtarakëve, rrisin besimin, krijojnë mundësi në shkëmbimin e përvojave dhe ndihmojnë vendet e paintegruara të integrohen sa më shpejt në strukturat Euro-Atlantike.

3.6.2 US – Adriatik Charter 3/5 (Karta e Adriatikut)

Iniciativa e Kartës së Adriatikut erdhi si domosdoshmëri dhe mbështetje e palës Amerikane në rrugën e integritit në NATO. Në këtë iniciativë bëjnë pjesë Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia (anëtarësuar në vitin 2003), Bosnja dhe Hercegovian dhe Mali i Zi (anëtarësuar në vitin 2010), ndërsa Kosova dhe Serbia kanë statusin e vëzhguesit. Karta e Adriatikut u nënshkrua në Tiranë, në 2 Maj 2003 në praninë e ministrave të jashtëm të tre vendeve dhe SHBA-s.

Karta e Adriatikut që nga koha e krijimit ka zhvilluar një numër aktivitete. Për shembull, projekti i përbashkët i ekipit të mjekëve mori jetë në vitin 2006, me pjesëmarrjen në operacionin paqeruajtës në Afganistan në përbërje të kontigjenti Çek. Çdo vit në bazë të një plan-kalendari zhvillohen takimet e Shefave të Shtabit dhe ekspertëve.

3.7 Edukimi dhe trajnimi jashtë vendit

Që nga viti 1990 Shqipëria ka qënë dhe është një nga vendet që ka përfutur më shumë nga asistenca në fushën e edukimit dhe trainimit jashtë vendit: (*Shih Tabela No. 3*)

Trajnimet jashtë vendit

Vendet	1992-2000	2001-2004	2005	2006	2007	2008	Totali
SHBA	50	7	2	3	3	2	67
Angli	5	10	4	2	2	1	24
Kanada		8	4	4	4		20
Gjermani	22	10	4	3	3	7	49
Itali	14	14	6	6	6	7	53
Francë	4	4					8
Turqi	120	85	14	14	14	6	253
Greqi	28	18	9	9	9	9	82
Q.Marshall	28	20	4	4	4	4	64
Të tjerë	19	4	2				25
Totali	229	180 (606)	49 (308)	45 (474)	45 (363)	36	632 (2016)

Pas vitit 2009, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, vazhdojnë të marrin pjesë në stërvitjet e përbashkëta, dërgojnë personel ushtarak dhe civil për t'u arsimuar në vendet e tjera anëtare të NATO-s.

Aktualisht Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë vendosur marrëdhënie në fushën e trajnimit dhe arsimimit me 27-vende, ku vlen të përmenden, SHBA (*Programi IMET, Qendra Marshall dhe Shkolla e NATO-s Oberamergau*), Italia, Gjermania, Turqia, Greqia, Mbretëria e Bashkuar, Holanda, Austria etj. Brenda këtyre marrëveshjeve kanë përfutur një numër i madhe ushtarakësh dhe civilësh në fushat si: mjekësi, inxhinjeri elektronikë, infomatikë, farmaci, juridik, shkencat politike, pedagogji, si dhe kurse dhe

kualifikime pasuniversitare të cilat përfshijnë të gjitha llojet e gradave dhe pozicioneve në FA të Shqipërisë.

Arsimimi dhe kualifikimi në FA, ka si qëllim rritjen e nivelit profesional dhe kapaciteteve operacionale të personelit në përmbushjen e standarteve të NATO-s. Në këtë kontekst, dokumenti i politikave arsimore ka si objekt rritjen e cilësisë në arsimimin e vazhdueshëm të personelit, me qëllimi formimin e ushtarakëve dhe civilëve me kapacitetet e nevojshme.

Në Republikën e Shqipërisë oficerët, n/oficerët dhe civilët arsimohen dhe trajnohen në Akademinë e Forcave të Armatosura, Shkollat e Trupës dhe Akademinë e N/Oficerëve.

Arsimimi përbën pjesën kryesore të përgatitjes intelektuale të ushtarakëve dhe civilëve. Ndërsa pjesëmarrja dhe organizimi i stërvitjeve në nivele të ndryshme, garanton rritjen e kapaciteteve operacionale dhe ndërveprueshmërisë me aleatët tanë. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe SHPFA organizojnë dhe zhvillojnë, stërvitje Komando Shtabi (CPX) në qendrën e simulimeve me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga vendet anëtare të NATO dhe ato partnere.

Arsimimi dhe trajnimi ndikojnë në rritjen e kapaciteteve por edhe në forcimin e mirëkuptimit dhe dialogut midis ushtarakëve dhe civilëve nga vendet e rajonit. Nën moton e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, Akademia e Mbrojtjes e Austrisë organizoi në Tiranë (24 – 29 Shkurt 08), kursin me teme “Politika e Mbrojtjes dhe Sigurisë Europiane”, me pjesëmarrjen e Shqipërisë, Gjermanisë, Bosnje-Hercegovinës, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Hungaria, Kroacia dhe Sllovenia. Në tetor 2016, AFA dhe qendra për Studime Globale në Romë, organizuan seminarin me temë terrorizmi në Ballkan, me pjesëmarrjen e AFA, Qendra e Studimeve Globale Roma, Qendra Marshal dhe Universiteti Evropian i Tiranës.

3.8. Armë kontrolli, parandalimi i armëve të dëmtimit në masë, ndërtimi i mirëbesimit dhe sigurisë në rajon dhe më gjërë.

Armë-kontrolli luan një rol të rëndësishëm në sigurinë e vendit tonë. Shqipëria është pjesë e një numër marrëveshjes në fushën e armë kontrollit të cilat kanë kontribuar në mënyrë intensive në reduktimin e tensioneve dhe parandalimin e armëve të dëmtimit në masë, armëve kimike dhe bakteriologjike. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve dhe konventave, Shqipëria po zhvillon më tej frymën e bashkëpunimit dhe rritjen e stabilitetit në rajon.

Reduktimi i rreziqeve: Kontributi i Shqipërisë në procesin e armë-kontrollit. Shqipëria ka një rekord impresionues në mbështetjen e dhënë në proceset e çarmatimit dhe parandalimit të armëve të dëmtimit në masë. Shqipëria nuk posedon armë të dëmtimit në masë dhe armë kimike. Vendi ka nënshkruar të gjitha marrëveshjet që kanë të bëjnë me procesin e çarmatimit dhe parandalimit të armëve të dëmtimit në masë. Shqipëria bën pjesë në marrëveshjen Wassenaar, për kontrollin e eksportit për armët konvencionale dhe teknologjisë.

Forcat e Amratosura i kanë dhënë rëndësi përfshirjes dhe kontributit në reduktimin e rreziqeve dhe forcimin e sigurisë. Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm në arritjen e standarteve në parandalimin e armëve të dëmtimit në masë, si kusht kryesorë për tu anëtarësuar në strukturat Euro-Atlantike. Përgjegjshmëria dhe angazhimi i Shqipërisë në procesin e çarmatimit, shkatërrimit të armëve të lehta, armëve kimike dhe parandalimit të armëve të dëmtimit në masë, është për t'u marrë në konsideratë dhe lavdëruar në krahasim me shumë vende të rajonit. Në termat afatgjatë, kjo politikë është përqëndruar në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit ndërkombëtare, promovimin e bashkëpunimit ndërshtetëror dhe pjesëmarrja në luftën kundër terrorizmit.

Zhvillimet pozitive janë arritur nëpërmjet dy rrugëve: (1) angazhimin e vendin në parandalimin e armëve të dëmtimit në masë, armëve të vogla dhe minave kundër personel dhe kundër tanke; (2) anëtarësimi i vendit në marrëveshjet e eksport-importit dhe hartimin e politikave kombëtare në kontrollin e tregëtisë së jashtme në fushën e armatimeve dhe teknologjisë, duke rrespektuar embargot dhe sanksionet ndërkombëtare.



Stërvitje 'Forcat Tokësore', Kukës, Shqipëri 06 maj 2013.

Shqipëria rreshtohet krenare përgjatë 66-vendeve anëtare të Konferencës së Çarmatimit të Gjenevës, i cili është i vetmi forum që merret me negociimin në fushën shumpalëshe të çarmatimit. Aktualisht, Shqipëria është vendi i parë në rajon dhe pse jo në botë me numrin më të madh të armëve të lehta dhe të rënda të shkatërruara.

Fusha e marrëveshjeve: Shqipëria në fushën e armë-kontrollit ka nënshkruar një numër marrëveshjesh me Konferencën e Gjenevës, OSBE-n dhe është anëtare e Konventës për Parandalimin e Armëve

Kimike, Konventës së Otawes për Parandalimin dhe Transferimin e Prodhimeve dhe Minave Anti-Pesonel, Marrëveshjes për Shkatërrimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SALW), marrëveshjes së qiejve të hapur (*Open Sky Treaty*) etj. Me iniciativën dhe ndihmën e diplomacisë ushtarake, Shqipëria është përfshirë në aktivitete speciale në mbështetje të marrëveshjes së qiejve të hapur 1992. Marrëveshja e qiejve të hapur do të fillojë zbatimin, atëherë kur të gjitha shtetet pjesëmarrëse do të bien dakort të lejojnë avionët të fluturojnë dhe fotografojnë territorin e tyre. Kjo do t'i bënte aktivitetet e tyre ushtarake më të hapura dhe transparente dhe monitorimin e armatimeve konform marrëveshjeve dhe traktateve.¹⁴⁶ Për shembull, stërvitjet e përbashkëta organizuara ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Gjeorgjisë, janë zhvilluar si pjesë e “Diplomacisë Ushtarake” dhe kanë luajtur një rol në inkurajimin e tyre në lidhje me respektimin e marrëveshjeve dhe konventave për armë-kontrollin. Në rastin e Shqipërisë, ndihmesa dhe kontributi i Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë dhe SHBA ka qënë vendimtarë në shkatërrimin e armëve të lehta dhe municioneve të tepërta. Ky proces ka kontribuar në forcimin dhe rolin e elementëve të diplomacisë ushtarake dhe rritjen e sigurisë dhe besimit në rajon.

3.9 Partneriteti me NATO-n dhe kontributet e FA-ve

Partneriteti me NATO dhe kontributi në operacionet paqeruajtëse është i domosdoshëm në konsolidimin e Forcave të Armatosura në fushën e mbrojtjes, bashkëveprimi dhe shkëmbimit të informacionit. Zhvillimi i këtyre elementëve arrihen duke zbatuar dhe zhvilluar komponentët e diplomacisë ushtarake si; vizitat e ndërsjellta në nivelet strategjike, operacionale dhe taktike dhe pjesmarrja me trupa në operacionet paqeruajtëse.

146 Defence Diplomacy, fq. 8

3.9.1 Partneriteti me NATO-n

Diplomacia ushtarake në proceset e integritimit ndihmon ristrukturimin dhe rrit bashkëpunimin me partnerët, nëpërmjet zhvillimit të seancave dhe konsultimeve me Aleancën, në kuadrin e dokumentave të MAP-it dhe PARP-it.

Vizitat e zyrtarëve të lartë civilë dhe ushtarakë janë një tregues i zhvillimit të elementëve të diplomacisë ushtarake në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Shqipëria në marrëdhëniet me NATO-n ka zhvilluar 190 (2011) aktivitete të IP/PfP-s, ka marrë pjesë në 10-stervitje (2010) të përbashkëta me të gjitha llojeve të forcave nën drejtimin e NATO-s dhe PfP-s. Pë shembull, në stërvitjen Cooperative Lancer/Longbow morrën pjesë 24 vende, përfshirë vendin mikpritës Shqipërinë, 11000 trupa dhe vëzhgues të ndryshëm nga vendet anëtare të NATO-s, PfP-s dhe Dialogut të Vendeve të Mesdheut.



147

147 Foto:Shtohen radhët e forcave speciale Shqiptare, <http://www.mod.gov.al/index.php/newsroom-2/3274-shtohen-radhet-e-forcave-speciale-shqiptare>, gjetur më 09 gusht 2018.

FA për vitin 2007, në frymën e diplomacisë ushtarake kanë organizuar 10-aktivitete në nivele të ndryshme operationale dhe strategjike. Këto aktivitete janë zhvilluar në bashkëpunim me Komandën e Bashkuar të NATO-s në Napoli (JFC Napoli). MM duke parë rëndësinë e këtij bashkëpunim dhe afërsinë gjeografike, kishte emëruar pranë kësaj komande një kordinator i cili kordinonte dhe bashkërendonte punën ndërmjet dy insiticioneve ushtarake. Ndërsa, në maj 2017, Shqipëria në bashkëpunim me SHBA-të dhe NATO-n do të organizojë stërvitjen LogEx Maj 2017.

3.9.2 Kontributi në Operacionet Paqeruajtëse (PSO)

Ndryshimet demokratike dhe zhvillimet e pas viteve 1990 sollën ndryshime në fushat politike, ushtarake dhe ekonomike në rajonin e Ballkanit. Në këtë periudhë diplomacia ushtarake shërbeu si element i rëndësishëm në inkurajimin dhe forcimin e proceseve integruese të vendit në strukturat euro-atlantike. Ky integrim u bë pjesë e rëndësishme në marrëdhëniet me vendet e rajonit dhe NATO-n. Era e ndryshimeve dhe konsolidimit të sistemit të shtetit të së drejtes nuk la jashtë ndikimit të saj dhe Shqipërinë. Nën “*presionin*” e ndryshimeve, Shqipëria morri hapa konkrete në mbështetje të paqes dhe sigurisë në rajon. Në vitin 1994, menjëherë pas firmosjes së kartës së anëtarësimit në PFP, Shqipëria dërgoi trupat për herë të parë, në misionin paqeruajtës SFOR në Bosnje – Hercegovinë e cili vazhdon edhe sot nën emërtimin Althea, drejtuar nga BE.

Pjesëmarrja në Bosnje nuk është i vetmi kontribut. Në kuadrin e Kartës së Adriatikut në vitin 2006 u krijua ekipi i përbashkët mjekësor i cili ka marr pjesë në operacionin paqeruajtës ISAF në Afganistan (2014). Pjesëmarrjeve të mesipërme i bashkangjiten dhe kontributet e forcave të armatosura në Kabul dhe Herat në përberje të forcave Turke dhe Italiane dhe në Kandahar në përbërje të forcave Amerikane (2014).

Eksperiencat e fituara në operacionet e ndryshme të paqes i kanë ndihmuar forcat e armatosura të konsolidohen dhe zhvillojnë më tej elementët dhe rolin e diplomacisë ushtarake. Përvoja e fituar po ndihmon në rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e elementëve të ndërveprueshmërisë të trupave tona në operacionin ‘Resolution Support’ në Afganistan.



148


Aktualisht Shqipëria ka jashtë teritorit të saj 300-trupa ushtarake të cilë shërbejnë anembanë globit, në shërbim të paqes, sigurisë dhe mirëkuptimit. Ky numër ndër vite ka kapur shifrat e 8000 (*afërsisht*) – ushtarakëve të cilët kanë kontribuar në misione të ndryshme jashtë vendit.

Deri më tani, nga diskutimet dhe analizat e bëra diplomacia ushtarake është e përqëndruar në; rritjen e bashkëpunimit në kuadrin e Kartës së Adriatikut A5, aktiviteteve të Pfp në kuadrin rajonal, marrëdhëniet dypalëshe dhe shumëpalëshe, rritja e aktiviteteve të bashkëpunimit me NATO-n etj. (*Shih fig No.3*)¹⁴⁹

148 Kursi i Oficerit të Ri, 2016 Foto Kol. Dr Ç. TOCI

149 A. Gjunksi, prezantim i pa publikuar

DIPLOMACIA USHTARAKE DHE RRUGA E INTEGRIMIT NË NATO



3.10 Aktorët e Diplomacisë Ushtarake në procesin e Integrimit

Në rrugën e procesit të integrimit janë përfshirë një numër aktorësh dhe institucionesh të ndryshme në fushën e diplomacisë ushtarake. Këta elementë në periudha dhe momente të caktuara, luajnë rol kryesor në transmetimin e mesazheve dhe prezantimin e imazhit të forcave të armatosura tek partnerët dhe aleatët tanë.

Diplomacia ushtarake në nivelet e larta përfshin udhëheqjen e lartë civile dhe ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes. Këto nivele ndiqen nga nivelet e tjera në hierarkinë civile dhe ushtarake të MM dhe SHPFA, përfaqësuesit e Shqipërisë në komandat e NATO, Atashetë ushtarak dhe përfaqësuesit në SHAPE/Mons, JFC Brunnsen, Komponenti tokësor Izmir, JFC Napoli, Shkolla e NATO-s Oberammergau etj.

Elementët e mësipërm në terminologjinë e diplomacisë ushtarake, njihen si komponentët përbërës të diplomacisë ushtarake në terren.

Rritja e rëndësisë dhe rolit të diplomacisë ushtarake në plotësimin e detyrave në fushën e mbrojtjes, ka përfshirë një numër aktorësh dhe drejtuesisht në nivelet të tjera të hierarkisë ushtarake. Drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm dhe ato të Ministrisë së Mbrojtjes, së bashku me njësitë tona pjesëmarrëse në operacionet paqeruajtëse në Bosnje, Afganista dhe në Republikën e Afrikës Qëndrore, luajnë rol kryesor në prezantimin dhe konsolidimin e imazhit të forcave të armatosura në kuadrin e bashkëpunimit me vendet anëtare të NATO-s dhe partnere.

Në procesin e zhvillimit dhe prezantimit të imazhit të FA janë përfshirë edhe institucionet qëndrore të vendit. Institucioni i Parlamentit, Presidentit dhe Qeverija, janë pjesa kryesore me ndikim në zhvillimin e elementëve të diplomacisë ushtarake në nivelet strategjike, në integrimin e plotë të vendit në strukturat euro-atlantike. Vizitat e kryeministrit dhe presidentit në Bruksel janë pjesë e aktiviteteve të diplomacisë ushtarake dhe kombëtare, të cilat ndikojnë në transmetimin e mesazheve, publikimin e imazhit dhe rritjen e bashkëpunimit me partnerët.

Ristrukturimi dhe konsolidimi i forcave të armatosura, transparenca e procesit dhe kontaktet me publikun, ndikojnë në ecurinë e reformave dhe efikasitetin e diplomacisë ushtarake. Transparenca dhe marrëdhëniet e ngushta të FA me publikun shqiptar kanë mundësuar, mbështetjen e proceseve transformuese dhe realizimin e objektivave të përcaktuara nga NATO. Sondazhet e zhvilluar nga Ambasada Amerikane në Tiranë dhe Instituti për Zhvillim Demokratik, kanë dalë në përfundimin se 90 % e opinionit publik shqiptar ishte në favor të anëtarësimit në NATO.¹⁵⁰ Exit polls dhe sondazhet e zhvilluar në Mal të Zi dhe Kroaci, në vitin 2009, tregojnë se vetëm 24% e opinionit

150 Top Channel, Kronika e lajmeve (4 prill 08)

publik malazez ¹⁵¹dhe 52 % e opinionit publik kroat mbështesin integrimin në Aleancë. ¹⁵²

Aktorët e brendëshëm të diplomacisë ushtarake dhe opinionit publik, ndiqen dhe plotësohen nga përfshirja dhe aktiviteti i aktorëve të jashtëm. Atashetë e huaj të akredituar në Shqipëri, Shtabi i NATO-s Tiranë (qershor 2010), Ekspertët e DIE-s (2012), publikimet e ndryshme për vendin dhe Forcat e Armatosura dhe vizitat e ndërsjellta, pasqyrojnë dhe “eksportojnë” imazhin e forcave të armatosura. Pasqyrimi dhe evidentimi i aktiviteteve të forcave të armatosura nga aktorët e huaj, ndihmojnë dhe testojnë ristrukturimin dhe zhvillimin e standarteve të anëtarësimit dhe zhvillimin e shtetit të së drejtës.

Pjesëmarrja në operacionet në mbrojtje të paqes ndikon në forcimin dhe konsolidimin e elementëve të diplomacisë ushtarake në marrëdhëniet me kolegët dhe ushtarakët e vendeve të tjera, për shembull, në Irak, Afganistan, BiH, republikën e Afrikës Qendrore dhe komandat e NATO-s. Diplomacia ushtarake në situata të tilla mundëson transmetimin e profesionalizmit, rrit bashkëpunimin dhe efikasitetin e strukturave të FA. Pjesëmarrje të tilla u mundësojnë ushtarakëve të njihen më njëri tjetrin, të pëfitojnë nga përvoja reciproke dhe të angazhohen sëbashku në realizimin e detyrave dhe pjesëmarrjet në operacionet luftarake.

3.11 Diplomacia ushtarake në kushtet e reja të sigurisë dhe mbrojtjes

Në situatën dhe mjedisin e krijuar, diplomacia ushtarake është e përfshirë në bashkëpunimin rajonal si element i rëndësishëm në forcimin dhe garantimin e një ambjenti të sigurtë. Në këtë këndvështrim Shqipëria ka treguar dëshirë dhe vullnet në zhvillimin dhe realizimin e disa

151 Takimi i KLSM me Perfaqësuesit e MM, Mali i Zi, Podgorice, 23 tetor 07.

152 Gazeta “Agon”, fq.5

projekteve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë shembuj konkret bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si; SEDM-it, MPFSEE/SEEBRIG, US – Adriatic Charter 5, marrëveshjet dypalëshe, shumëpalëshe etj.

Ndryshimet e fundit në mjedisin e sigurisë dhe angazhimi i Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit dhe anëtarësimi në NATO dhe BE ka ndryshuar rrënjësisht realitetin në rajonin e Ballkanit Perendimor, në kontekstin e diplomacisë ushtarake në lidhje me qëllimin, principet e zhvillimit, mbështetjes dhe procedurave të bashkëpunimit. Pa treguar dhe mbivlerësuar rolin e diplomacisë ushtarake, kushtet e reja të sigurisë në shumë raste, nuk janë në gjendje të riformulojnë të gjitha funksionet e diplomacisë ushtarake dhe qëllimin e zhvillimit të elementëve të rinj, të cilat reflektojnë momentet e reja të ambjentit të sigurisë dhe axhendën e mbrojtjes.

Ndryshime të mëdha kanë ndodhur në atmosferën e formimit dhe zbatimit të diplomacisë ushtarake, konkretisht në transferimin e aspekteve të njohura (*transfer of know-how*)¹⁵³ të prezantuar nga organizata jo-qeveritare me reputacion (NGO) – në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar – në lidhje me reformimin e kuadrit të sektorit të sigurisë. Përfshirja e organizatave të fuqishme në vend dhe rajon, në shumë raste do të ndikojë pozitivisht në forcimin dhe zbatimin e elementëve të diplomacisë ushtarake dhe rritjen e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perendimor. Këto organizata mund të ndihmojnë, në kontekstin e diplomacisë ushtarake, për të bashkëpunuar në fushën e mbrojtjes. Konkretisht, qeveria Serbe në shumë raste ka shprehur mungese dëshire në bashkëpunimin me vendet e rajonit dhe NATO-n. Serbia ka deklaruar politikisht se nuk e ka në axhendën e saj anëtarësimin në NATO.

Të gjithë e dimë se rajoni i Ballkanit që në kohët e hershme ka qënë arenë e ndarjes së zonave të influencës midis Perendimit dhe Lindjes.

153 V. Rachev, fq.75

Sot aspiratat dhe dëshira e vendeve për t'u e anëtarësuar në NATO dhe BE kanë filluar të shtohen në numër dhe zgjerohen në hapësirë, duke filluar nga Deti Adriatik në Detin e Zi, dhe së fundmi në Kaukaz dhe Detin Kaspik. Po të hedhim një vështrim këto rajone kanë qënë arenë e përleshjeve të dy blloqeve rivale në të shkuarën. Po t'i shikojmë në termat gjeo-politike dhe gjeo-strategjike, këto zona shumë shpejt janë përfshirë në një zonë të vetme gjeopolitike atë të luftës kundër terrorizmit.

Anëtarësimi në NATO në vitin 2009 dhe hapja e negociatave për anëtarësim në BE, për Shqipërinë zgjidhin përfundimisht problemin klasik të sigurisë kombëtare në dy drejtime – parandalimin e kërcënimeve të brendëshme dhe të jashtme, si dhe zgjerimin e zhvillimeve ekonomike, sociale dhe kulturore. Por anëtarësimi në strukturat Euro-Atlantike nuk do të thotë për Shqipërinë se *“historia mbaroi me kaq”*, për të ka filluar një histori e re, me mundësi të panumërta dhe një hapësirë të pa imagjinueshme bashkëpunimi. Integrimi në organizatat Euro-Atlantike kënë rritur vëmëndjen e Shqipërisë në zbatimin dhe zhvillimin e diplomacisë ushtarake bazuar në eksperiencat e akumuluar, formimin e një koncepti të ri, si dhe instrumentalizimin e mëtejshëm të saj. Anëtarësimi në NATO dhe në BE e kanë transformuar Shqipërinë nga një vend i cili përfitonte nga mundësitë e trajnimit, edukimit dhe asistencë, në një vend që prodhon dhe eksporton kapacite akademike në fushat e mësipërme. Kjo mund të ilustruhet shumë mirë me KLSM, në fushën e studimeve të mbrojtjes dhe sigurisë (SCSDS).

Zhvillimet dhe analizat e mësipërme përcaktojnë se qëllimi i diplomacisë ushtarake është mbështetja, drejtimi dhe zhvillimi i formave të bashkëpunimit nëpërmjet dialogut dhe bashkëpunimit. Ndërsa momenti tjetër i rëndësishëm është përmirësimi i mënyrave dhe formave të mendimit të vendeve partnere në krijimin e ideve të reja, në rritjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe shkëmbimin

e eksperiencës midis vendeve të rajonit. Ndërtimi i mirëkuptimit të dyanshëm, bashkëpunimit në fushën e armë-kontrollit, dimilitarizimi i vendeve të rajonit dhe ndërtimi i besimit janë iniciativa të cilat duhen vlerësuar individualisht dhe kolektivisht. Format dhe mënyrat e reja të bashkëpunimit ndihmojnë në ndërtimin e planeve afatgjata dhe transparente në parandalimin e konflikteve dhe rritjen e besimit. Për shembull, në rastin e Shqipërisë ka një numër faktorësh që influencojnë në diplomacinë ushtarake si; dokumenti i ri i miratuar i Strategjisë së Sigurimit Kombëtar (2015), Planifikimi i Forcës (2015-2025), anëtarësimi në NATO-s, reformat në fushën e mbrojtjes dhe pjesëmarrja me trupa në luftën kundër terrorizmit; krijojnë hapësira dhe mundësi bashkëpunimi të cilat mund të përfshijnë vende nga rajonet e – Ballkanit – Iniciativës së Detit Adriatik dhe Detit Jon – Detit të Mesdheut – Kaukazit – Dialogut me vendet e Mesdheut, në fushat politike, ekonomike dhe të sigurisë, kontrollin e armëve të lehta dhe ato bërthamore dhe mundëson transferimin e njohurive (*transfer of know-how*) në zbatimin e reformave në fushën e sigurisë.

Sot fokusi i NATO-s është përqëndruar në zhvillimin e forcave të dislokueshme dhe profesioniste të mirëpërgatitura, të mirëpaisura me mundësi transportimi strategjik në zonat e veprimit dhe me aftësi të zhvilluara të mbështetjes logjistike përgjatë gjithë kohës së veprimit. Këto nuk janë të lehta dhe të lira për t'u realizuar. Vendet e rajonit, duke përfshirë dhe Shqipërinë, nuk janë akoma në gjendje të kenë mundësi dhe paisje të transportit strategjik të trupave në çdo rajon dhe vend krizash. Realizimi i këtyre iniciativave kërkon mbështetje financiare, bashkëpunim midis partnerëve dhe zhvillim strategjik të forcave me qëllim arritjen e objektivave të së ardhmes. Sot më shumë se kurrë nevojiten trupa profesionistësh, të paisur mirë dhe të ndërveprueshëm me aleatët në luftën kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar. Shkëmbimi i informacioneve, ndërlidhjet e sigurta të komunikimit, ngritja e sistemeve të shpejta në kundërpërgjigje të veprimeve të armikut, marrja e vendimeve në kohën e duhur, krijimi i procedurave

të njëjta në fushën e trajnimit dhe edukimit dhe paisja e personelit, janë kërkesat më të domosdoshme për arritjen e suksesit.

3.12 Përfundime

Historia na ka treguar se shtetet kanë luftuar me njëri tjetrin duke mbyllur çdo lloj rruge komunikimi dhe duke mos pasur asnjë lloj kontakti ushtarak – me – ushtarak. Është shumë e rëndësishme për Shqipërinë të zhvillojë marrëdhënie të ngushta me vendet e rajonit, rritjen e besimit dhe sigurisë. Thënia që *“zbatimi i politikave të jashtme/ diplomacisë është pronë/lekskluziv e diplomatëve dhe përdorimi i forcës është pronë e ushtarakëve”* nuk është më e vërtetë. Nuk mund të ketë në një vend politik të jashtme pa kontributin e forcave të armatosura. Në pamjen e përgjithshme të sistemit kushtetues dhe kontrollit civil, Shqipëria do të vazhdoi të kontribuojë në zhvillimin dhe formulimin e politikave të jashtme. Diplomacia ushtarake duhet të zhvillohet si një nga pikat kryesore dhe të vazhdueshme në procesin e arritjes së paqes në mbështetje të objektivave të politikës së jashtme dhe sigurisë me qëllim krijimin e një ambjenti paqësor, ndërtimin e besimit të dyanshëm dhe të shumanshëm, zhvillimin e bashkëpunimit dhe rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perendimor.

REKOMANDIME DHE PËRFUNDIME

Qeveritë e vendeve perendimore e kanë trajtuar dhe përdorin Diplomacinë ushtarake në situata të tilla si; parandalimi i konflikteve, promovimi demokratik i marrëdhënieve civilo-ushtarake, rritja e bashkëpunimit rajonal dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse. Për shembull, SHBA-ja pas Luftës së Dytë Botërore, luajti rrol të rëndësishëm në ndërtimin demokratik të Gjermanisë dhe Japonisë. Këto dy shembuj nuk janë të vetmit, ku elementët e diplomacisë ushtarake kanë dhënë rezultate në reduktimin e krizave, konflikteve dhe mosmarrëveshjeve. Promovimi i vlerave demokratike u bë themeli i politikës së jashtme të vendeve të Europës Perendimore pas viteve 1990.

Kapitulli do të shqyrtojë disa rekomandime të cilat mund të ndihmojnë Forcat e Armatosura. Konsolidimi i FA dhe rritja e bashkëpunimit përmirësohen nëpërmjet zhvillimit të elementëve të diplomacisë ushtarake në parandalimin e konflikteve, promovimin e marrëdhënieve demokratike civilo ushtarake dhe rritjen e kapaciteve dhe aftësive luftarake në operacionet paqeruajtëse. Rekomandimet e trajtuara do të ndihmojnë në hartimin dhe formulimin e konkluzioneve përfundimtare të cilat do të lidhen me rolin dhe rëndësinë e zbatimit të artit të diplomacisë ushtarake.

Rekomandime

Analizat dhe komentet rreth aktivitetit të përditshëm të Frocave të Armatosura do të mundësojnë formulimin dhe diskutimin e rekomandive në lidhje me efektin e diplomacisë ushtarake, në parandalimin e konflikteve, promovimin e marrëdhënieve demokratike civilo-ushtarake dhe rritjen e aftësive paqeruajtëse.

Parandalimi i konflikteve

Zhvillimet dhe dinamika e veprimeve në fushën e sigurisë, politikës, ekonomisë dhe luftës kundër terrorizmit i ka ndërgjegjësuar vendet perendimore dhe demokratike në botë, për rolin dhe efektet e diplomacisë ushtarake në forcimin e dialogut, rritjen e besimit dhe parandalimin e konflikteve. Ky proces ka gjetur përdorim të gjërë dhe ka dhënë efekte në ndërtimin e formave të bashkëpunimit dhe parandalimit të konflikteve ndërmjet ish armiqve dhe kudërshtarëve. Vendet e konsoliduara dhe ne veçanti vendet në zhvillim, ku përfshihet dhe Shqipëria, u rekomandohet t'a përdorin diplomacinë ushtarake në fushat që do të prezantohen më poshtë:

- *Në krijimin e urave të bashkëpunimit:* Në fushën e bashkëpunimit diplomacisë ushtarake ndikon në afrimin e vendeve dhe bashkëpunimin e tyre në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, rritjen dhe forcimin e besimit dhe angazhimit në përballimin e sfidave dhe kalimin e pengesave të përbashkëta në rrugën e integritetit në strukturat Euro-Atlantike.
- *Bashkëpunimi ushtarak:* Bashkëpunimi mund të përdoret shumë mirë, si mjet në krijimin e bazave themelore të transparencës në fushën e mbrojtjes, për shembull në lidhje me qëllimet/objektivat e vendeve dhe aftësive ushtarake. Diskutimet midis ushtarakëve të të gjitha niveleve mbi

doktrinën ushtarake dhe politikat e mbrojtjes, mund të përdoren nga vendet e vençanta si elemente të transparencës në përdorimin e forcave të armatosura. Përdorimi i të gjitha formave të bashkëpunimit është rezultativ në ndërtimin e besimit, forcimin e bashkëpunimit dhe reduktimin e rreziqeve të cilat kanë të bëjë me sigurinë.

- *Ndryshimi i mentalitetit/mëndjes të bashkëpunimit midis ushtarakëve:* Sot shumë vende Perendimore dhe Ballkanike e përdorin diplomacinë ushtarake me qëllim prezantimin dhe shpjegimin e objektivave dhe mundësive ushtarake, duke e vënë theksin tek qëllimet e përbashkëta dhe sfidat që ndeshin sot ushtarakët në mbarë botën. Një nga sfida me të cilën ballafaqohen forcat e armatosura dhe diplomacia ushtarake, është lufta kundër terrorizmit dhe shkëmbimi i informacionit. Shembujt e bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit dhe shkëmbimit të informacionit janë mishëruar më së miri në pjesëmarrjet e FA të Shqipërisë në misionet ISAF, KFOR, Kualicioni i Lirisë në Irak dhe NATO Resolution Support.
- *Mbështetja e reformave në fushën e mbrojtjes:* Diplomacia ushtarake mund të përdoret në mbështetje të fushave konkrete, si afrimi i asistencës në reformimin e forcave të armatosura dhe shkëmbimi i pervojës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Këtu mund të përmendim asistencën e dhënë nga qeveria Amerikane në ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, nëpërmjet kompanisë konsulente SAIC dhe CUBIC. Bashkëpunime të tilla nuk janë vetëm kontribut në reformimin dhe ristrukturimin e Forcave të Armatosura dhe arritjen e standareve të NATO-s, por ato ndihmojnë në ndryshimin e mentalitetit dhe mënyrën e përdorimit të forcave, në mbrojtjen e vendit dhe bashkëpunimin me partnerët.

Forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes është element i rëndësishëm në ndërtimin e besimit dhe forcimin e sigurisë. Rritja e mirëkuptimit dhe besimit midis partnerëve, i bën ata të ndjehen më mirë dhe të besojnë në të ardhmen e përbashkët. Diplomacia ushtarake do të mbetet edhe për shumë kohë, një element i rëndësishëm në duart e Forcave të Armatosura.

Promovimi i Marrëdhënieve Demokratike Civilo-Ushtarake

Përdorimi i diplomacisë ushtarake në promovimin e marrëdhënieve demokratike civilo-ushtarake do t'i ndihmojë Forcat e Armatosura të jenë sa më transparente dhe të besueshme. Në kundërshtim me filozofinë e bashkëpunimit, shumë vende të drejtuara nga udhëheqës autokratë, përpiqen të tregojnë dhe shesin së janë duke zbatuar vlerat demokratike të bazuara në filozofinë e marrëdhënieve civilo-ushtarake. Në kontrast me këtë, promovimin i vlerave demokratike të marrëdhënieve civilo-ushtarake në vendet në tanzicion, ndikon në konsolidimin e sistemit demokratik dhe zhvillimin e diplomacisë ushtarake. Filozofia e mirëkuptimit dhe besimit, ndihmon ushtarakët dhe civilët të promovojnë vlerat demokratike, dialogun, transparencën, besueshmërinë e reformave dhe praktikimin e praktikave më të mira në zhvillimin e institucioneve kombëtare demokratike. Këto procese mund të përfshijnë grupe konstruktive – siç mund të jenë ushtarakët – të cilët mund të kundërshtojnë ose të jenë të kujdesshëm në lidhje me reformat demokratike.

Diplomacia ushtarake mund t'i ndihmojë Forcat e Armatosura, për shembull të Shqipërisë, në promovimin e vlerave demokratike nëpërmjet marrëdhënieve civilo-ushtarake në një numër fushash:¹⁵⁴

154 A Cottey dhe A Forster, fq. 33

- *Ushtrimi i Kontrollit Civil mbi Forcat e Armatosura*: Sfidat kryesore në këtë fushë janë depolitizimi i Ushtarakëve, alternimi i principeve të kontrollit civil demokratik i bazuar në dokumentin e kushtetutës, krijimi i një zinxhiri komandimi i cili reflekton principet e mësipërme, reformimin dhe krijimin e institucioneve të kontrollit si: (këshilli i sigurimit kombëtarë, ministria e mbrojtjes, komisioni parlamentar i sigurisë etj).
- *Kontrolli Civil mbi Diplomacinë Ushtarake*: FA duhet të marrin në konsiderate reformimin dhe civilizimin e institucioneve, të cilat merrën me drejtimin e diplomacisë ushtarake (praktikisht ministria e mbrojtjes), zhvillimi i sistemeve të drejtimit dhe kontrollin e buxhetit të mbrojtjes dhe prokurimeve, si dhe përgatitjen dhe arsimimin e kadetëve dhe punonjësve civil në Forcat e Armatosura.
- *Legjislacioni/Kuvendi/Palamenti*: Kuvendi i Republikës si institucion ligjvënës ndikon në përcaktimin e marrëdhënieve midis tij dhe Forcave të Armatosura në hartimin e politikës së mbrojtjes, krijimi i komisionit të jashtëm, komitetit të sigurisë dhe mbrojtjes, garantimin e rolit të Kuvendit në miratimin e ligjeve, emërimeve dhe buxhetit të mbrojtjes. Gjithashtu, Kuvendi duhet të ketë akses në marrjen e informacionit nga Forcat e Armatosura, me qëllim garantimin e transparencës dhe mirëdrejtimin e reformave në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- *Zbatimi i Ligjit, të Drejtat e Njeriut dhe Sistemi Juridik*: Forcat e Armatosura duhet dhe kanë për detyrë zbatimin e ligjit dhe hartimin e legjislacionit të nevojshëm në bazë të principeve demokratike dhe strukturave Euro-Atlantike, respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe nxjerrjen para përgjegjësisë të dhunuesve të ligjit dhe rregullave brënda saj dhe në marrëdhënie me civilët në terrën.
- *Angazhimi i Shoqërisë Civile*: Forcave të Armatosura u nevojitet ndërtimin e një sistemi, i cili të përfshijë transparencën dhe

lirinë e informimit në lidhje me forcat e armatosura dhe buxhetin e mbrojtjes, inkurajimin e institucioneve kërkimore të pavarura, grupeve kërkimore në fushën e mbrojtjes, si dhe inkurajimin e medias së lirë dhe të pavarur të përqëndrohet dhe analizojnë problemet e mbrojtjes dhe sigurisë.

Si përfundim, diplomacia ushtarake mund të afrojë mbështetje dhe ekspertizë për reformat nëpërmjet modeleve dhe praktikave më të mira, këshillave dhe mbështetjes materiale, afrimin dhe përgatitjen e personelit ushtarak dhe civil, si dhe promovimin e vlerave demokratike në një shoqëri demokratike në zhvillim.

Rritja e aftësive paqeruajtëse

Ndryshimet demokratike dhe rënia e perdes së hekurt midis Perëndimit dhe Lindjes, ka krijuar një situatë pozitive për diplomacinë ushtarake në nxitjen dhe mbështetjen e vendeve partnerë me qëllim rritjen e aftësive operacionale dhe ndërveprueshmërisë me aleancën. Ky bashkëpunim në vetvetë nuk përbën element të ri, por ai prezanton një formë të re bashkëpunimit në fushën e asistencës ushtarake. Bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe operacioneve në Froat e Armatosura, duhet të bazohen në një numër dimensionesh dhe vlerash:¹⁵⁵

- NATO dhe PFP janë pikat kyçe në zhvillimin e koncepteve të përbashkëta dhe doktrinëve operacionale, si baza të bashkëpunimit në fushën e Operacioneve Paqeruajtëse. Zbatimi i koncepteve dhe doktrinëve operacionale, nëpërmjet parimeve të diplomacisë ushtarake, mund t'i ndihmojë vendet të punojnë dhe bashkëpunojnë së bashku, para dhe gjatë operacioneve paqeruajtëse, siç ka ndodhur për shembull me Shqipërinë në Bosnje, Irak, Afganistan, Çad dhe republikën

e Afrikës Qëndrore. Pjesmarrja dhe kontributi në operacionet paqeruajtëse nuk mund t'i eleminojë diferencat dhe ndryshimet midis vendeve. Në këtë kontekst vendet si Shqipëria anëtare e NATO-s, duhet të kenë dokumenta dhe koncepte të veprimeve operacionale të njëjta me ato të aleancës. Bashkëpunimi dhe koordinimi midis Shqipërisë dhe vendeve anëtare në aleancë, mund të zgjidhe problemin e performancës operacionale dhe nivelin teknik, në përgjigje të situatave të kërkuara.

- *Zyra e Koordinimit për Partneritetin për Paqe*: Nëpërmjet kësaj zyre vendet partnere mund të përfitojnë përvoja nga pjesëmarrja në stërvitjet e përbashkëta me vendet anëtare të NATO-s. Pjesëmarrja në këto aktivitete krijon mundësi njohjeje dhe familjarizimi me procedurat e punës në operacione paqeruajtëse. Elementë të tillë ndihmojnë vendet partnere të avancojnë në krijimin e standarteve dhe punën me shtabe dhe të jenë në gjendje të rrisin aftësitë ushtarake në operacionet paqeruajtëse.
- *Zhvillimi i aftësive kombëtare gjatë pjesëmarrjeve në operacionet paqeruajtëse*: NATO në vitin 1999 krijoi Programin e Edukimit dhe Qëndrat e Trainimit të PfP (vendet afrojnë përgatitje dhe mbështetje vendeve partnere nëpërmjet ekspertizës dhe asistencës së NATO-s).¹⁵⁶ Aktualisht janë krijuar pesë qendra të trajnimit të PfP-s në Turqi, Ukrain, Zvicër, Rumani dhe Suedi. Nëpërmjet këtyre qendrave vendet kanë mundësi të përfitojnë asistencë teorike dhe praktike në përmirësimin e kapacitetet operacionale dhe ndërveprueshmërisë me aleatët në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.
- *Zgjerimi i NATO-s*: Zgjerimi i NATO-s me shtete nga Europa Qëndrore, Lindore dhe Jug-lindore ka ndikim pozitiv në përmirësimin dhe rritjen e aftësive luftarakë të vendit në operacionet paqeruajtëse. Aleanca e ka bërë të qartë

156 Komunikata e Samitit të Uashingtonit, fq.99

domosdoshmërinë dhe përmirësimin e aftësive ushtarake në operacione paqeruajtëse, si kriter bazë për anëtarësim. Në këtë kuadër, vendet partnere kanë prezantuar në dokumentin e PARP-it dhe MAP-it, hapat e ndërmarra në zhvillimin e reformave dhe konsolidimin e komponenteve operacional, arsimore dhe teknike. Asistenca teknike dhe konsultimet me vende aleate, kanë ndihmuar vendet përkatëse të rrisin kapacitetet operationale, ndërveprueshmërinë midis forcave të armatosura dhe cilësinë luftarake (pjesëmarrja në operacionet e mbrojtjes të paqes).

Pjesëmarrja e vendit në operacionet paqeruajtëse dhe rritja e kontakteve dy dhe shumë palëshe, ndikon në rritjen e aftësive luftarake dhe kapaciteteve operationale.

Përfundime

Gjatë 25-viteve të fundit, në Frocat e Armatosura kanë ndodhur ndryshime të shumta në lidhje me rolin dhe rëndësinë e diplomacisë ushtarake, në përmirësimin e mjedisit të sigurisë dhe rritjen e besimit midis partnerëve. Historikisht diplomacia ushtarake – bashkëpunimi dhe asistenca ushtarake – kanë qenë përdorur për qëllime të vërteta politike në forcimin e rolit të aleatëve në ballafaqimin kundër armikut të përbashkët. Pas viteve 1990, diplomacia ushtarake ndryshoi në formë dhe përmbajtje, duke u përshtatur dhe ndihmuar vendet perendimore në marrëdhënie me vendet e Europës Lindore dhe Jug-lindore. Arti dhe filozofia e trajtuar dhe ideuar nga diplomacia ushtarake përfshiu bashkëpunimin ushtarak me ish-kundërshtarët/armiqtë, si pjesë e domosdoshme në përmirësimin e marrëdhënieve, rritjen e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe shumëpalësh në fushën e mbrojtjes, si kriter i domosdoshëm në parandalimin e konflikteve, mbështetjen e demokratizimit të marrëdhënieve civilo-ushtarake dhe

reformat në sektorin e sigurisë, si dhe mbështetjen e dhënë vendeve të cilat bëjnë përpjekje në rindërtimin e Forcave të Armatosura pas konflikteve ose tranzicioneve politike.

Në këtë libër është trajtuar dhe diskutuar për modelin e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe asistencës në ndryshimin e imazhit të diplomacisë ushtarake të “vjetër” dhe krijimin e një imazhi tjetër për diplomacinë ushtarake të “re”. Dy janë pikat të cilat bëjnë dallimin e diplomacisë ushtarake të vjetër nga e reja: diplomacia ushtarake e re është e përfshirë direkt në promovimin e bashkëpunimit midis vendeve, në kundërshtim me idenë e atakimit të armiqve të jashtëm. Së dyti, diplomacia ushtarake është e qëndrueshme në politikën e qeverisë, si promovimi i marrëdhënieve demokratike civilo-ushtarake, mirëqeverjsja e sektorit të sigurisë dhe respektimi i të drejtave të njeriut.

Diplomacia Ushtarake e zbatuar nga vendet perendimore, ka rikrijuar programet e bashkëpunimit dhe asistencës ushtarake. Vendet anëtare të Aleancës po i venë theksion çdo ditë e më shumë bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes më shumë sot se sa në të shkuarën, duke përfshirë kundërshtarët e djeshëm dhe vendet në tranzicion. Qëllimi i diplomacisë në këto kushte është mbështetja dhe kthimi i kundërshtarëve në vende partnere dhe influencimin e ndryshimeve të brëndëshme në drejtimin e duhur. Aktivitetet e ndërmarra në vendet anëtare të Aleancës kanë ndryshuar në formë dhe përmbajtje. Qëllimi i tyre është promovimi i kontrollit demokratik civil mbi forcat e armatosura dhe transmetimi i vlerave liberale demokratike. Këto vlera sot po bëhen gjithnjë e më shumë qëndra dhe qëllimi i diplomacisë ushtarake të përdorur nga vendet anëtare të Aleancës. Përmbajtja, qëllimi dhe roli i diplomacisë ushtarake ndryshon rrënjësisht nga qëllimi dhe roli në të shkuarën.

Diplomacia ushtarake e re në disa raste zhvillohet dhe vepron krahpërkrak me të vjetrën. Kjo në jo pak raste ka sjellë tension dhe konflikte. Për shumë vite, në vende dhe rajone të ndryshme të globit diplomacia ushtarake është përdorur si element kryesor i politikës në

mbështetje të objektivave kombëtare kundër vendit/ve armik/e. Vendet Perendimore janë arkitektët dhe përdoruesit e parë të diplomacisë ushtarake, në mbështetje të aleatëve kundër armiqve të përbashkët, në kundërshtim në disa raste me nivelin e ulët dhe të dobët të zbatimit të vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit, në politikën dhe mënyrën e përdorimit të diplomacisë ushtarake nga vendet perendimorë, pati një ndryshim të madh drejt bashkëpunimit dhe asistencës ushtarake me vendet, ku sundonin rregjimet totalitare dhe zbatimi i lirive dhe të drejtave të njeriut nuk zbatohet sipas standarteve të vendeve perendimore.

Ndryshimet e ndodhura pas 11 shtatorit në lidhje me formën dhe identifikimin e kundërshtarit, i detyruan vendet e Alencës të ripërcaktonin rolin dhe ndikimin e diplomacisë ushtarake me vendet aleate dhe partnere. Në këto momente ju vu theksi rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit me aleatët dhe partnerët në fushën e mbrojtjes, në pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse dhe luftës kundër terrorizmit. Situata të tilla si lufta kundër terrorizmit dhe krimet të organizuar, i vuri vendet në pozita bashkëpunimi në luftën kundër armikut të përbashkët dhe luajti rol të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit.

Qëllim tjetër i diplomacisë ushtarake, ku edhe Shqipëria ka përfituar, është forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me vendet e Aleancës dhe rajonit. Iniciativa të tilla dypalëshe, shumëpalëshe, SEDM, A5 (US – Adriatic Charter 5), nisma e bashkëpunimit të Detit të Zi etj, ndihmojnë në forcimin dhe rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe promovimin e vlerave demokratike. Diplomacia ushtarake në rajonin e Ballkanit Perendimor mund të luaj rol të rëndësishëm në adresimin e disa problemeve të cilat janë serioze, si rrespektimi i sovranitetit, të drejtave të njeriut, zbatimi i vlerave të demokracive liberale dhe shkëmbimi i informacionit në lidhje me terrorizmin, trafiqet e paligjshme dhe kalimin ilegal të kufijve. Diplomacia ushtarakë afron mundësi më të mira dhe ndikimin pozitiv

afatgjatë në fushën e stabilitetit dhe sigurisë brenda vendit dhe midis vendeve. Marrëveshjet dypalëshe, për shembull Shqipëri – Maqedoni, Shqipëri – Kroaci, Shqipëri – Turqi ose shumëpalëshe Shqipëri – Maqedoni – Greqi, Shqipëri - Maqedoni – Bullgari etj, ndihmojnë vendet në rritjen e besimit, sigurisë, dialogut, transparencës, promovimin e vlerave demokratike dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në termat afatgjatë.

Element tjetër i rëndësishëm është mbështetja që diplomacia ushtarake jep në përballimin e sfidave të zhvillimeve të brendëshme, rajonale dhe pas konfliktuale. Kjo mund të ndikoi në forcimin dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe forcimin e marrëdhënieve midis komuniteteve dhe etnive të ndryshme. Për shembull, konsolidimi i shtetit dhe demokracisë në Bosnje – Hercegovine dhe përcaktimi i statusit përfundimtar të Kosovës (*shpallja e pavarësisë – shkurt 2008*) do të zgjidhin përfundimisht krizat dhe japë fund konflikteve të lindura nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Zgjidhja e problemeve do të krijoj kushte dhe ambjent të përshtatshëm në zhvillimin dhe konsolidimin e demokracive dhe rrespektimin e të drejtave të njeriut në vendet e Ballkanit Perendimor, në përballimin e sfidave të brendëshme në lidhje me zhvillimin dhe sfidave të jashtme të integritit në strukturat Euro-Atlantike. Diplomacia ushtarake mund t'i ndihmojë vendet në krijimin e filozofive dhe doktrinaeve të reja në fushën e bashkëpunimit, në krijimin e strategjisë të sigurimit kombëtare dhe strategjisë ushtarake, ristrukturimin dhe konsolidimin e forcave të armatosura në shoqëritë demokratike. Vendet demokratike në tranzicion mund të pëfitojnë nga roli i diplomacisë ushtarake në momente dhe etapa të ndryshme të zhvillimeve rajonale, në përballimin e përbashkët të sfidave të tranzicionit. Diplomacia ushtarake mund të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve demokratike civilo-ushtarake, afrimin dhe promovimin e vlerave demokratike me qëllim arritjen dhe plotësimin e standarteve për anëtarësim në NATO dhe BE.

Objektiv tjetër i diplomacisë ushtarake është angazhimi strategjik në prandalimin e konflikteve me kundërshtarët në rajon dhe më gjërë. Në nivel global angazhimet e NATO-s dhe SHBA-s në bashkëpunimin me Rusinë dhe Kinën janë shëmbujt konkret ku diplomacia ushtarake mund të përfshihet dhe japë rezultate positive në parandalimin e konflikteve dhe forcimin e dialogut. Në nivelin rajonal, Shqipëria e shikon angazhimin e diplomacisë ushtarake në të njëjtin këndvështrim, si vendet aleate në rritjen dhe inkurajimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes nëpërmjet iniciativave rajonale, NATO-s, PfP-s dhe më gjëra. Përdorimi dhe angazhimi i diplomacisë ushtarake për qëllime strategjike dhe parandalimin e konflikteve është pjesë e rëndësishme e politikës kombëtare në kontekstin e marrëdhënieve dhe duhet parë si një proces pozitiv afatgjatë.

Diplomacia ushtarake është përfshirë në një numër ndryshimesh politike, dilemash dhe sfidash në vendet e Aleancës dhe rajonit të Ballkanit Perëndimorë. Zgjerimi dhe përdorimi i diplomacisë ushtarake në ndjekjen dhe zbatimin e objektivave të reja është bërë objekt diskutimi. Disa ekspertë theksojnë se diplomacia ushtarake po përqëndrohet më shumë në bashkëpunimin dhe angazhimet ushtarake të “buta” e cila bën rolin e saj naiv dhe jo realist. Ndërsa disa analistë të tjerë thonë që zbatimi dhe përdorimi i diplomacisë ushtarake ka një ndikim të madh të ushtarakëve mbi politikën e jashtme, militarizon politikën dhe forcon marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes me rregjimet totalitare dhe vendet të cilat kanë probleme me zbatimin e të drejtave të njeriut. Këto ndikime janë elementare dhe mund të kalohen me mirëkuptim, transparencë dhe dialog midis palëve. Forcimi i bashkëpunimit, promovimi i vlerave demokratike dhe parandalimi i konflikteve janë elementët kryesore ku mund të kontribuojë diplomacia ushtarake, si mbështetëse dhe pjesë përbërëse e politikës kombëtare.

Shqipëria dhe vendet e rajonit duhet ta shikojnë diplomacinë ushtarake si instrument politik afatgjatë, e cila mund të japë rezultate pas disa

vitesh ose dhe dekadash. Forcat e Armatosura janë komplekse, të mëdha në strukturë, organizata të cilat përfshijnë kultura dhe mentalitete nga më të ndryshme të transhëguara që nga lufta e ftohtë. Për shembull, konsolidimi i kontrollit demokratik në forcat e armatosura dhe rritja e aftësive ushtarake dhe pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse, kërkon kontribut dhe angazhim maksimal në ndryshimin e strukturës, kulturës organizative, edukimit/tranimit dhe paisjeve. Ndryshimet e gjeneratave janë të nevojshme, por ne mund të mos i shohim kontributet e diplomacisë ushtarake edhe kur oficerët/ushtarakët e rinj të kenë lëvizur në detyra dhe grada më të larta. Shqipëria dhe forcat e saj ushtarake nuk duhet të shqetësohen në lidhje me rezultatet afatshkurtëra të diplomacisë ushtarake, por ata duhet të jenë optimist për ndikimin dhe rezultatet e saj në termat afat-gjata.

Nga pikpamja Amerikane, diplomacia ushtarake adreson ose lidhet me një numër problemesh si; ndarja botërore e përgjegjësive, bashkëpunimi dhe ndarjet e fuqisë punëtore. SHBA si e vetmja superfuqi botërore është në udhëheqje të diplomacisë ushtarake. Vendet e tjera ku përfshihet edhe Shqipëria kanë dhënë dhe japin një kontribut të çmuar në këtë fushë.

Në kudërshtim me rolin dhe rëndësinë e diplomacisë ushtarake, për shembull Shqipëria ka bërë shumë pak në analizimin dhe rolin e saj në lidhje me aktivitetin dhe vlerat e bashkëpunimit dhe asitencës ushtarake. Diplomacia ushtarake duhet shikuar si mbështetëse e aspiratave dhe arritjes së objektivave madhore kombëtare. Ne duhet të krijojmë procedura dhe mekanizma për zhvillimin dhe efektivitetin e aktiviteteve të diplomacisë ushtarake dhe duhet të ndërmarrim analiza në lidhje me mësimet e nxjerra (*lessons learned*) nga bashkëpunimi me vendet anëtare të Aleancës dhe rajonit.

Si përfundim, koncepti i diplomacisë ushtarake mbështet idenë se forcat e armatosura dhe strukturat e saj kanë potencialet e nevojshme për të kontribuar në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, jo vetëm

me angazhimin tyre në luftën kundër armikut, por duke ndihmuar në promovimin e bashkëpunimit dhe krijimin e një ambjenti të sigurtë. Diplomacia ushtarake është element tradicional në lidhje me rolin dhe angazhimin e forcave të armatosura ose instrument shtesë në politikën e jashtme dhe sigurisë. Në mjedisin aktual, NATO-ja dhe SHBA-ja po mundohen të bashkëpunojnë me Rusinë dhe Kinë në ndërtimin e një ambjenti të sigurtë pas Luftës së Ftohtë. Në këtë rrugë po ecën edhe Shqipëria në konsolidimin dhe krijimin e një ambjenti sa më të sigurtë bashkëpunimi në rajon dhe më gjërë. Shqipëria sot më shumë se kurrë është promovuese dhe eksportuese e vlerave të sigurisë dhe besimit. Ky rol po forcohet dhe konsolidohet çdo ditë e më shumë. Ndërtimi i shtetit të së drejtës dhe respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, i ndihmon Forcat e Armatosura të ristrukturohen, përmirësohen dhe ndryshojnë kulturën e të vepruarit dhe arrijnë standartet e kerkuara. Diplomacia ushtarake ka potenciale dhe mund të kontribojë në terma afat-gjata në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Politika kombëtare dhe diplomacia ushtarake nuk janë dy elementë të ndryshëm por janë një pjesë e vetme e cila ndihmon vendin dhe vlerëson rolin e ushtarakëve, se ata mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtare në mbështetje të politikës së jashtme të vendit.

LITERATURA

Libra

1. *Strategjia e Sigurimit dhe Politikës së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë* (2000), SHBU Tiranë, ff. 21.
2. *Strategjia e Sigurimit Kombëtarë të Mbretërisë së Bashkuar* (UK), Botim i MM të MB (UK) (1999), ff. 18.
3. Jean Claud Faveyrial (2004) “*Histoire de l’Albanie (Historia e ‘me e vjetër’ e Shqipërisë*”, Plejad, Tirana.
4. Reed J. Fendrick (2002) “*Diplomacy as an instrument of national poëer/Doplomacia si instrument i fuqisë kombëtare*”, Apocryphal (cituar në këtë kapitull), Kapitulli i 13, ff 179.
5. Ambrose Bierce, *The Devil’s Dictionary (Fjalori i djallit)*, i disponueshëm në faqen e internetit www.alcyone.com/max/lit/devils/d.html. gjetur më 13 Qershor 2007.
6. Neët Gingrich, “Rouge State Department/Departamenti i Shtetit të Kuq”, Politika e Jashtëme (Korrik-Gusht 2003) i disponueshëm tek www.foreignpolicy.com/story/story.php?storyID=137427&PHPSESSID=7580d7d9d1e0995fbc68fbeb56d, gjetur më 13 qershor 2007.
7. Strategic Defense Revieë (Strategjia e Mbrojtjes) 1998, *Modern Forces for the Modern World: Fact Sheets, Defense Diplomacy* (Forcat Moderne për një botë Moderne: Fakte, Diplomacia ushtarake), It is disarmament of mind (Çarmatosja e mendjes), London.
8. Philips, T.R. *Roots of Strategy: The 5 Greatest Military Classics of All Times* (Rrënjet e Strategjisë: Pesë Klasikët e

- Mëdhenj Ushtarakë gjatë gjithë kohrave), ed. J.R. Phillips, (Mechanicsburg:Stackpole Book), ff 339.
9. Clausewitz, Carl von . *On War* (Mbi Luftën), shënimet e 10 Korrik 1827 ed nga Michael Howard dhe Peter Paret (1974), Princeton: Princeton University Press, ff.69. Commander-in-Chief refers to the military commander rather than the President, as is the case in United State Government terminology (Komandanti në detyrë i referohet komandantëve ushtarak sesa Presidentit, si në rastin e terminologjisë të Qeverisë të Shteteve të Bashkuara).
 10. Andreë Cottey dhe Anthony Forster, “*Reshaping Defence Diplomacy: New Roles for Military Cooperation and Assistance/Riformatimi i Diplomacisë Ushtarake: Rolet e reja në bashkëpunimin ushtarak dhe asistencën*”, Oxford University Press, Neë York, 2004.
 11. D. S. Reveron, “*Ushtarakët dhe politika e jashtëme e SHBA-s*”, ff.74.
 12. C.V.Causewitz (2005), “*Military Theory/Teoria Ushtarake*”, BDCOL Estonia.
 13. Marybeth Peterson Ulrich, *Democratizing Communist Militaries: The Case of the Czech and Russian Armed Forces/Demokratizimi i ushtrive komuniste: Rasti i Forcave të Armatosura të Çekisë dhe Rusisë*, Ann Arbor, MI: The University of Michigan Press, 1999, ff.52.
 14. David Shambaugh, ‘*Sino-American Strategic Relations: From Partners to Competitors/Marrëdhëniet Strategjike Kineo-Amerikane: Nga Partnerë në Konkurrentë*’, Survival/Mbijetesa, vol. 42, no. 1, Pranverë 2000, ff. 113.
 15. Carter dhe Perry, *Preventive Defence/Mbrojtja Parandaluese*, ff.94-94 dhe 100.
 16. D. Shambaugh, ‘*Sino-American Strategic Relations/Marrëdhëniet Strategjike Kinezo-Amerikane*’, ff.101,107 dhe 114.

17. D. Shambaugh, 'Sino-American Strategic Relations/Marrëdhëniet Strategjike Kinezo-Amerikane', ff.107 dhe 110.
18. Programi i Zhvillimit të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë për vitet, 2005-2009.
19. Valeri Ratchev, 'Defence Diplomacy:the Bulgarian Experience/ Diplomacia Ushtarake: Eksperienca Bullgarë', G.S. Rakovski Defense and Staff College, Sofia, Botuar dhe referuar në: Edited by: Timothy Edmunds dhe Marjan Malešić; *Defense Transformation in Europe: Evolving Military Roles/ Transformimet në fushën e mbrojtjes në Europë: Përfshirja dhe roli i ushtarakëve*, IOS Press, The NATO programme for security through science, 2004, ff.57.
20. Derek S. Reversion (2005), *American's Viceroy: The Military and U.S. Foreign Policy*, Palgrave Macmillan, ff.73 dhe 84.
21. Bertram I. Spector dhe I. William Zartman (2003), *Post Agreement Negotiation: Getting it Done and International Regimes/Negociatat pas Marrëveshjes: Realizimi dhe Regjimi Ndërkombëtarë*, Washington DC, United States Institute of Peace Press, ff. 172-174.
22. John Leench (2004), *Asymmetries of Conflict: War without Death/Aismetritë e Konfliktit: Lufta pa të Vrarë*, Frank Cass, London, ff.47-48.
23. Pouqueville, François Charles Hugues Laurent, *Voyage en Moree, a Constantinple, en Albanie et dans plusieurs autres parties de l'Empire othoman pendant les annees 1798, 1799, 1800 e 1801. Comprenant la description de ce pays, leurs productions, les moeurs, les usages, les maladies – l'etat actuel de la Grece, et ce qu'elle fut dans l'antiquite*. 3 vol. (Marchand, Paris 1805), ff. 542,287, 344.
(Pukëvili, - *Udhëtim në More, në Konstandinopoj, në Shqipëri dhe në shumë pjesë të tjera të Perandorisë Osmane, gjatë viteve 1798,1799,1800 dhe 1801. Duke përfshirë përshkrimin e këtyre*

- vendëve, prodhimet e tyre, ritet, zakonet, sëmundjet – gjendjen aktuale të Greqisë dhe çka ishte ajo në lashtësi. Vëll 3).*
24. Sabri Godo (1993), *Ali Pash Tepelena*, SHB 'A. Z. Çajupi', Tirana.
 25. M. Sabry (2002, *Mehmet Aliu: Dhëlptra dhe Luani i Lindjes*, SHB, UEGEN, Tirana, Shqiperi.
 26. Bernard Lewis (2004), *The emergence of modern Turkey (Lindja e Turqisë Moderne)*, Second edition, Oxford University Press.
 27. F.Adcock–D.Mosley, *Diplomacy in Ancient Greece (Diplomacia në Greqinë e Lashtë)*, Thomes dhe Hudson, 1975, fq. 152, We will explore some means of non-oral communication in a subsequent section.
 28. Thucedides, 2.1
 29. D. Hamel, *Athinian Generals: Military Authority in the Classical Period*, (*Gjeneralët Athinotë: Autoriteti Ushtarak ne Periudhën Klasike*), 1998, fq. 40.
 30. Plutarch, Kimon, 14
 31. Historia e Shqiperise, botim i vitit 1989, Tirane, Shqiperi.
 32. Seyan Brown (2003) '*The Ilusion of Controll: Force and Foreign Policy in the 21st century*', the Brookings Intitutions, Washington D.C. USA. (*Iluzioni i Kontrollit: Forca dhe Politika e Jashtme në shekullin e 21-t*)
 33. Donald C. F. Daniel dhe Bradd C. Hayes, '*Coercive inducement and Containment of Interantional Crises*' (U.S. Institute of Peace Press, 1999); Robert J. Art dhe Patric M. Cronin, eds., *The United States and Coercive Diplomacy after the Cold War* (U.S. Institute of Peace Press, 2003).
 34. Daniel Bayman and Matthew Waxman, *The Dinamics of Coercion: American Foreign Policy and the Limits of Military Might* (Cambridge University Press, 2002). Other pertinent RAND studies are Benjamin S. Lambeth, *NATO's Air War for Kosovo: A Strategic and Operational Assessment* (RAND,

- 2001); Stephen T. Hosmer, *The Conflict over Kosovo: Why Milosevic Decided to Settle When He Did* (RAND, 2001); and John Matsumura and others, *Preparing for Future Warfare with Advanced Capabilities* (RAND, 2002).
35. Barry M. Blechman and Tamara Corman, 'Defining Moment: The Threat and Use of Force in American Foreign Policy,' in Caraley, ed., *The New American Interventionism*, pp. 9-38.
 36. Ivo H. Daalder and Michael E. O'HANLON, *Winning Ugly: NATO's War to Save Kosovo* (Brookings, 2000).
 37. Prof.Dr. Stavri Naçi, 'Pashallëku i Shkodrës', 1964.

Shkrime/Artikuj

1. Alice Hills (2000), "Defense diplomacy and security sector reforms/Diplomacia ushtarake dhe reformat në sektorin e sigurisë"; Contemporary security policy/ Politika aktuale e sigurimit, Vol. 21, Nr. 1 Prill, A Frank Class Journal ISSN 1352-3260.
2. Gupta, Narendra, (2002) "It Pays to be Coercive. The Indian Express" (Na duhet të jemi koherent), 04 Shkurt, India.
4. Somon Szykman, "The Art of Diplomacy in The Art of War/Arti i Diplomacisë në Artin e Luftës", 2005.
5. Peterson Ulrich, *Democratizing Communist Militaries/ Demokratizimi i Ushtrive Komuniste*, ff. 165-66.
6. Alexander A. Belkin dhe James H. Brusstar, 'A Military in Charge of Itself: Civilian Control is a Russian Myth/Ushtaraku i angazhuar me vetveten: Kontrolli civil është miti Rus', Strategjik Forum/Formi Strategjik, No. 59, Washington DC: National Defense University, Institute for National Strategic Studies, Tetor 1995, ff.215-32.
7. Prof. Fabricio Luccioly, leksion me KLSM-07, Akademia e Mbrojtjes e Shqipërisë, 'The New Security Dimensions and the Interantional Organizations: the NATO/Dimensionet e reja të

- sigurisë dhe organizatat ndërkombëtare: NATO*, Tiranë, 8 Tetor 2007.
8. Astrit Gjunkshi, *'Defense Diplomacy for Membership to NATO/ Diplomacia Ushtarake për Anëtarësimin në NATO'*, prezantuar me KLSM-07 në Ministrinë e Mbrojtjes, tetor 2007. (**Material i papublikuar**)
 9. E.S.Williams, *Cold War, Hot Seat: A Eastern Defence Attache in the Soviet Union/Lufta e Ftohtë, Një Karrige e Vështirë: Një Atashe Ushtarak Perendimorë në Bashkimin Sovjetik*, (London: Robert Hale: 2000), ff.20-21.
 10. Kritaq Xharo et al, SEDM: *Shqipëria suksesshëm në rrugën e kryesimit*, QSHBPU, Tiranë 2007, ff 27-28.
 11. Çlirim TOCI, *Ministeriali i Europës Jug-lindore – Vështrim Analitik: Procesi i SEDM-it dhe Iniciativa MPFSEE*, (Artikull në librin: SEDM: *Shqipëria suksesshëm në rrugën e kryesimit*, QSHBPU, Tiranë 2007. ff.148.
 12. *Washington Summit Communique*, Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington DC, on 24 April 1999, Press Release NAC-S-(99)64, 24 Aprill 1999 (*Komunikatë e Samitit të Uashintronit*).
 13. Karl K. Schonberg 2002, *The Generals' Diplomacy: US Military Influence in the Treaty Process, 1992-2000/Diplomacia e Gjeneralëve: Influenca Ushtarake e SHBA-s ne hartimin e traktateve*, Seton Hall Journal of Diplomacy and International Relation/Revista e Diplomacisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ff. 70.
 14. Jame J. Przysup dhe Phillips C. Saunders (2006), *Visions of Order: Japan and China in US. Strategy/Vizionet e Shtetit: Japonia dhe Kina në Strategjinë e SHBA-s*, Strategic Forum, Qershor 2006, i disponueshën në www.ndeu.edu/inss, ff. 33.

Revista/Gazeta

1. Ministry of Defense (Ministria e Mbrojtjes), United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar “*Defence Diplomacy*“ (*Diplomacia Ushtarake*), 1999, London, UK.
2. Diskutime të ndryshme të zhvilluara në Shtabin e NATO, Bruksel, Belgjik, 1999.
3. Dmitri Trenin, ‘Russia – NATO Relations: Time to pick up the pieces/Marrëdhëniet Rusi – NATO: Koha për të parrë pjesën’, NATO Review, vol. 48, no. 1, Pranver/Verë 2000, ff.21.
4. Ian Traynor, ‘*Russia Raises Nuclear Threat/Rritja e Kërcënimit Nuklear Rus*’, The Guardian, 14 Janar 2000.
5. Timoty C.Shea (2004), *Transforming Military Diplomacy/ Transformimi i Diplomacisë Ushtarake*, JFQ, ff.49.
6. Kap.Rang.I Astrit Aliaj (2007), *Diplomacia Ushtarake*, Gazeta Ushtria, no. 40, 5 tetor 2007, ff.10.
7. Kap.Rang.I Astrit Aliaj (2007), *Diplomacia Ushtarake*, Gazeta Ushtria, no. 41, 12 tetor 2007, ff.15.
8. *Integrimi në NATO dhe mbështetja e opinionit publik*, Gazeta Agon, no. 143, 12 shkurt 2008, Tiranë, ff.5.

Burime/materiale nga interneti

1. www.mfa.gov.al/english/misoni, *The mission of the Ministry of Foreign Affairs (Misioni i Ministrisë të Punëve të Jashtme)*, gjetur më datë 28 mars 2007.
2. Miehs, Cristian Mihail, “Topical Military Diplomacy“ (Tema e Diplomacisë Ushtarake), gjetur tek <http://www.presamil.ro/VA/2001/3-4/leng.htm>.
3. ‘Major Milestones in NATO-Russia Relations: A Chronology of Important Events’, www.nato.int/docu/basic/txt/fndact-c.htm; Dauglas L. Clarke, ‘Uncomfortable Partners’, transition, 1995, ff 27-31.

4. <http://www.nato.int/docu/nato-russia/nato-russia2007-epdf>
5. www.defenselink.mil/news/Jan2002/t0116fb.html. (Brifin për Vizitat e Rosisë, shkrimi më 16 Janar 2002, nga Departamenti i Mbrojtjes të SHBA-s.
6. www.state.gov/r/pa/bgn/2742.htm (Shkrim nga Carter dhe Monsy 'Mbrojtja Parandaluese/Preventive Defence', ff.93.
7. http://www.chinadaily.com.cn/english/doc/2005-12/29/content_507781.htm
8. www.defenselink.mil/pubs/easr98/easr98.pdf, pp.6, 30-34 dhe 64-65, *Military to military Exchanges with the people's Liberation Army*, Deputy Secretary of Defense, Washington DC, 8 Qershor 2001.
9. <http://209.85.129.104/search?q=cache:8GCEPvMöOC4J:chinaabc.showchian.org/chinaa...2007-03-28>.
10. www.defenselink.mil/pubs/easr98/easr98.pdf, pp6
11. <http://www.answers.com/topic/diplomacy>
12. <http://www.globalpolicy.org/soecon/develop/oda/2006/04aidtobias.pdf>
13. United States Information Agency Alumni Association, "What Is Public Diplomacy?" Washington, D.C., updated September 1, 2002. online at <http://www.publicdiplomacy.org/1.htm> (as of August 6, 2004).
14. www.nato.int/docu/update/2008/04-april/e0403h.html
15. <https://orientalizmi.wordpress.com/2012/01/15/bushatllinjte-historia-e-nje-fisi-qe-nuk-ju-binden-asnjerrregjimi>, "Bushatllinjte – Historia e një fisi që nuk ju bind asnjë rregjimi", Anila Bushi, 15/01/2012. Gjetur me datë 07 nëntor 2016.
16. <https://www.brookings.edu/opinions/assessing-u-s-china-relations-under-the-obama-administration/> accessed on 9 December 2016. (*Cheng Li: Assessing U.S.-China relations under the Obama Administration, August 30, 2016*).

SHPJEGIMI I SHKURTIMEVE

A3 – Vendet anëtare të kartës së Adriatikut (Shqipëri-Kroaci-Maqedoni)

AMBO – Albanian-Macedonian-Bullgarian Oil

ASEAN – Association of Southeast Asian Nations (Organizata e Vendeve të Azisë Jug-lindore)

Althea – Emri i misionit paqeruajtës drejtuar nga BE në Bosnje – Hercegovinë

AWACS – Airborn Worning and Control System

BS – Bashkimi Sovjetik

BE – Bashkimi Evropian

CSBM – Krijimi i Një Mjedisit Sigurie Kofidencial dhe të Sigurtë

CUBIC – Emri i misionit të asistencës amerikane pranë MM

CBSC – Counter – Prolifetaron, Border Security and Counter Terrorism (Parandalimi dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, sigurimit të kufijve dhe luftës kundër terrorizmit)

CPX – Command Exercise Post (Stërvitje Komando-Shtabi)

DIE – Misioni i ekspertëve Italian në Shqipëri

EAPC – Euro-Atlantic Partnership Council

FA – Forcat e Armatosura

GFK - Institucion për testimin e opinioneve publike/zgjedhjeve.

GDP – Gross Domestic Production (Rritja e Produktit Bruto në Vend)

IMET – International Military Education and Training (Programi i Trainimit dhe Edukimit të Ushtarakëve të Huaj)

IPP – Individual Partner Program (Programi Individual i Partneritetit)

IMIHO – Interconnection of Military Hospitals (Ndërlidhja e Spitaleve Ushtarake)

ISAF – International Security Assistance Force (Forca e Asistencës Ndërkombëtare për Sigurinë)

JFC – Joint Force Command (Komanda e Forcave të Bashkuara)

KNER – Ish organizatë e bashkëpunimit ekonomik të vendeve të Europës Lindore dhe Jug-lindore

KFOR – Kosovo Force (Forca Mbrojtëse e Kosovës)

KGB – Committee for Security State (Organizata e Sigurimit të Shtetit të Ish BS)

MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme

MAP – Membership Action Plan (Plani i Veprimit për Anëtarësim)

MM – Ministria e Mbrojtjes

NATO – North Atlantic Treaty Organization

NGO – Non Governmental Organization (Organizata Jo-Qeveritare)

OCC – Operation Coordinated Cell

OSBE – Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

PfP – Partnership for Peace (Partneriteti për Paqe)

PK – Partia Komuniste

PARP – Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit

PLA – Peoples Liberation Army (Ushtria Popullore Çlirimtare)

PMSC – Political Military Steering Committee (Komiteti i Drejtimit Politik-Ushtarak)

RP e Kinës – Republika Popullore

SAIC – Ish kompani konsulence amerikane pranë MM

SEEDIRET – Southeast European Defense Industries, Research and Technology (Industria Ushtarake, Fusha e Kërkimeve dhe Teknologjisë)

SEESIM – Southeast European Simulation Network (Rrjeti i Simulimit për Europën Jug-lindore).

SEEMEC – Southeast Military Education and Cooperation (Projekti në Fushën e Arsimit dhe Trajnimit për Europën Jug-lindore)

SALW – Small Arms and Light Wapons

SDR – Strategic Defense Revieë (Dokumenti i Rishikuar i Strategjisë)

SADC – Bashkësia e Zhvillimit të Vendeve të Afrikano - Jugore

SEDM/MPFSEE – Southeast Defense Ministeria (Ministeriali i Europës Jug-lindore)

SEEBRIG – Southeast European Brigade (Brigada e Europës Jug-lindore)

SCSDS – Senior Course on Security and Defense Studies (Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen)

SFOR – Stabilisation Force in Bosnia –Herzegovina (Forca Stabilizuese në Bosnje –Hercegovinë)

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

SHFA – Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

UU – Universiteti Ushtarak

WMD – Wopans of Mass Destruciton (Armët e Dëmtimit në Masë)

LISTA E FIGURAVE

Figura No. 1 Diplomacia ushtarake (Sipas B.S. Sacharn)a	37
Figura No. 2 Diplomacia ushtarake dhe samitet e NATO-s.....	80
Figura No. 3 Diplomacia ushtarak në rrugën e integritit në NATO	111

LISTA E TABELAVE

Tabela No. 1 Aktivitetet e diplomacisë ushtarake	95
Tabela No. 2 Aktivitetet në FA të Shqipërisë	96
Tabela No. 3 Trajnimet jashtë vendit.....	103

SHTOJCAT

Vendet e Baltikut¹⁵⁷




157 <https://legacy.lib.utexas.edu/maps/commonwealth/balticstates.jpg>, marre me date 23 korrik 2018

Vendet e NATO-s, Pfp, Dialogu i vendeve të Mesdheut dhe Iniciativa e bashkëpunimit të Stambollit



Forumi i bashkëpunimit të vendeve të Shangait¹⁵⁸



158 <https://yourfreetemplates.com/shanghai-cooperation-organization-templates/> gjetur më datë 13 gusht 2018

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Toci, Çlirim

Arti i diplomacisë ushtarake dhe mjedisi i ri i
sigurisë / Çlirim Toci. – Tiranë : Pegi, 2018

148 f. ; 14,5 X 21 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-233-13-4

1.Forca të armatosura 2.Siguria kombëtare
3.Bashkëpunimi ndërkombëtar 4.Diplomacia

355 .02(496.5:4/9)

327.7(496.5:4/9)